3rj0n1xx -Mundësoi Librin-



OSHO

Asgjë më hyjnore se jeta nuk ka

Copëza të arta

Prizren, 2011

Këtë libër e përkrahu moralisht
dhe materialisht:
Niazi Basha

Shqipëroi:
Hasan Hamëzbala

Boton:
~hhb~
Tel: 044 216 038

3rj0n1xx -Mundësoi Librin-



“Po patë njëherë dritën e synimit tuaj,
të Vërtetën e Amshuar, ajo do t’ju udhëzojë siç
fanar i detit udhëzon lundrën kah bregu i errësuar.”

Krishnamurti

1

Jeto tërësisht, jeto bujshëm, dhe ashtu çdo çast yti do të jetë i artë dhe e tërë jeta jote do të bëhet vargan çastesh të arta.

Personi që jeton kështu kurrë edhe nuk vdes, sepse ka fituar prekjen magjike: Çfarëdo që ai prekë në ar shndërrohet.

2

E vetmja përgjegjësi e vërtetë është ajo që buron nga mundësitë e tua individuale, inteligjenca jote, vetëdija jote – dhe vepron në harmoni me to.

3

Duke ardhur në botë ti nuk ke lindur si pemë, por ke lindur vetëm si farë. Prandaj duhet të rritesh gjithnjë deri në atë pikë ku ke për të lulëzuar dhe ai lulëzim do të jetë përmbushja jote, kuptimi yt.

Ky lulëzim nuk ka asnjë lidhje me

pushtetin, me paranë, me politikën. Ai ka lidhje vetëm me ty; ai është përparimi yt individual.

Prandaj, bëju kremtja e vetvetes!

4

Gjakimi për utopi në esencë është gjakimi për harmoni, si te individi, ashtu edhe te bashkësia. Harmonia kurrë nuk ka ekzistuar, gjithmonë ka ekzistuar vetëm kaosi.

Shoqëria pandërprerë është e ndarë në kultura të ndryshme, religjione të ndryshme, kombe të ndryshme – dhe të gjitha ato dallime bazohen mbi mashtrimet.

Por këto dallime tregojnë se njeriu është i ndarë përbrenda vetes. Ato janë projeksione të konflikteve të tij të brendshme personale. Njeriu nuk është unik përbrenda vetes dhe kjo është arsyeja pse nuk mund të krijojë bashkësi unike, njerëzim unik në botën e jashtme.

Shkaku nuk ndodhet jashtë. Jashtësia është vetëm shprehje e brendësisë së njeriut.

5

Askush nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme individit.

Dhe kjo është shkaktari themelor i të gjitha problemeve.

Por për atë se individi duket aq i imët, kurse shoqëria aq e madhe, njerëzit mendojnë se, po e ndryshuan bashkësinë, atëherë edhe individi do të ndryshohet.

Por kjo është marrëzi – sepse "shoqëria" është vetëm fjalë; në realitet ekziston vetëm individi, shoqëria nuk ekziston. Atë që quajmë "shoqëri" është vetëm fjalë pa substancë dhe aty nuk ka se çfarë të ndryshohet. Ti mund ta ndryshosh vetëm individin, more sado i imët të duket ai. Dhe kështu përnjëherë do ta kuptosh shkencën me të cilën ndryshon njeriu – ajo vepron në çdo individ, more kudo qoftë ai.

Po ndjej se do të vijë dita kur do të jetojmë në shoqërinë harmonike, dhe ajo do të jetë më e mirë se të gjitha idetë të cilat utopia i ka krijuar gjatë mija viteve.

Dhe atëherë realiteti do të jetë shumë më i bukur.

6

Shoqëria është e rregulluar ashtu që t'i pengojë njeriut të mendojë ndonjëherë mbi mundësitë e veta personale. Dhe e tërë vuajtja rrjedh prej asaj se njeriu nuk bëhet ai që vërtet është. Ti vetëm ji ai që je dhe atëherë nuk do

të ketë vuajtje, as vrazhdësi, as parehati lidhur me atë se a janë të tjerët më të mirë se ti apo jo.

Nëse do që bari të jetë më i gjelbër, nuk është e nevojshme që ta shikosh nga ana tjetër e rrethojës; bëj që bari të jetë më i gjelbër nga ana jote e rrethojës. Kjo vërtet është e thjeshtë të bëhet.

Njeriu vetëm duhet të jetë i rrënjosur në mundësitë e veta personale, more çfarëdo qofshin ato. Dhe çdo gjë atëherë do të jetë më e bukur, sado që kjo të duket e pabesueshme.

7

Ti kurrë nuk je krejtësisht i kënaqur me atë që je, as me atë që ta ofron realiteti, dhe shkaku i kësaj je i parehatuar. Kishe për të qenë më i kënaqur me vetveten po ta kuptoje natyrën tënde të vërtetë. Kjo është arsyeja pse nuk mund t'i zhvillosh të gjitha mundësitë e tua.

Ti po provon të jesh ai që të tjerët po kërkojnë prej teje, por kjo nuk mundet me të kënaqë. Duke qenë se kjo është kështu, është e logjikshme të thuash: "Duhet të ekzistojë diçka më shuamë se krejt kjo". Mandej nisesh tutje dhe vështron botën rreth vetes.

Por çfarë sheh? Sheh se njerëzit kryesisht

po shfaqen me maskat në fytyrë të cilat qeshin, duke u dukur bajagi të lumtura, kurse të gjithë në të vërtetë shtirën se janë dikush tjetër. Ti gjithashtu shfaqesh me maskën tënde dhe ata mendojnë se je më i lumtur se ata; ti, megjithatë, mendon se ata janë më të lumtur se ti. Bari duket më i gjelbër në anën tjetër të rrethojës. Të tjerët shohin luadhin tënd dhe ai iu duket më i gjelbër se i tyri. Ai vërtet duket më i gjelbër, më i bukur, më i mirë. Por kjo është vetëm iluzion të cilin e krijon distanca.

Kur ofrohesh më pranë, ti atëherë vëren se ajo nuk është ashtu siç është dukur. Por njerëzit qëndrojnë në distancë nga njëri-tjetri. Madje edhe miqtë e dashnorët qëndrojnë në distancë; afërsia së tepërmi e madhe do të ishte e rrezikshme, se gjërat do të shiheshin ashtu siç janë.

Ti atëherë do të vije re se gabimisht je i orientuar që nga lindja dhe se krejt ajo që deri tash ke bërë në të vërtetë është e mjerë. Prandaj sheh njerëzit që kanë plot para dhe mendon se paratë sigurisht ofrojnë lumturi. I shikon ata njerëz dhe të bëhet se vërtetë janë të lumtur. Pastaj lëshohesh në garën për para. Dikush të duket më i shëndetshëm se ti – dhe ti atëherë vrapon pas shëndetit. Kurdo që dikush tjetër të duket se është më i suk-

sesshëm se ti – ti e imiton. Por ata janë gjithnjë vetëm të tjerë, por jo ti.

8

Ta jetosh atë do të thotë të kesh sens për humor, të kesh kualitet të pamatshëm të dashurisë, të kesh gëzim.

Unë jam absolutisht kundër çdo qëndrimi jetësor negativ; madje edhe zotnderimi mund të jetë qëndrim jetësor negativ. Për të ndërtuar qëndrim jetësor pozitiv duhet patjetër të kesh gëzim, sens për humor, dashuri dhe respekt – të gjitha së bashku.

Zotnderimi i vetëm i vërtetë është nderimi i jetës, sepse asgjë më hyjnore se vetë jeta nuk ka.

9

Njeriu është i lindur me thesar të madh shpirtëror, por ai gjithashtu është i lindur edhe me trashëgimi të plotë animale. Megjithatë, ndonjëherë na shkon për dore që ta heqim anash trashëgiminë animale dhe të krijojmë hapësirë që thesari shpirtëror të vijë në vetëdijen tonë dhe atëherë ta ndajmë me të tjerët. Kjo po ashtu është një nga kualitetet e çdo thesari: Sa më shumë e ndan, aq më tepër e ke.

10

10

Shumë probleme tonat ekzistojnë shkaku se kurrë nuk merremi me to, shkaku se kurrë me sytë tanë nuk i vështrojmë ashtu siç vërtet janë.

11

Jepjau jetën gjërave të bukura. Mos ua jep jetën gjërave të shëmtuara. Ti nuk ke shumë kohë, shumë energji për t'i derdhur. Jetë aq e pakët, burim aq i pakët energjie – thjesht është marrëzi t'i derdhësh në vuajtje, pikëllim, urrejtje, xhelozi.

Përdori për dashuri, për vepra kreative, për miqësi, për meditim. Bëj diçka me energjinë tënde të të ngrisë në nivel më të lartë. Dhe sa më lart që ke për t'u ngjitur, burimet e tua të energjisë do të jenë më të mëdha.

Çdo gjë është në duart e tua.

12

Asnjë njeri nuk është ujdhesë. Këtë duhet mbajtur mend si një nga të vërtetat themelore të jetës. Unë e theksoj këtë sepse ekziston prirja që kjo e vërtetë të harrohet.

Të gjithë ne jemi pjesë e një force jetësore –

pjesë e një ekzistence oqeanike. Thënë esencialisht, po qe se të gjithë ne, thellë në rrënjët tona, jemi NJË, mundësia për dashuri do të ekzistojë. Po qe se nuk jemi, mundësia për dashuri nuk do të ekzistojë.

13

Njeriu akoma posedon shumë instinkte shtazore, siç është hidhërimi, urrejtja, xhelozia, posesiviteti, dinakëria. Krejt kjo është thellësisht e rrënjosur në ndërdijen e tij dhe duhet gjithsesi të jetë e mënjanuar.

E tërë puna e alkimisë shpirtërore merret me këtë se si të shkëputemi me të kaluarën animale.

Nëse nuk shkëputet me të kaluarën animale, njeriu do të mbetet në dysh i ndarë. E kaluara animale dhe humanizmi njerëzor nuk mund të ekzistojnë së bashku – shkaku se humanizmi është kualitet plotësisht i kundërt me animalitetin. Prandaj, çfarëdo që njeriu bën kthehet në hipokrizi.

Kur në pyetje janë trajtat formale të sjelljes, njeriu ndjek idealin e humanitetit – dashurinë, të vërtetën, lirinë, shpirtmadhësinë, përdëllimin. Por, edhe përkundër kësaj, ai mbetet vetëm gënjeshtar i pabindur, dhe bisha e fshehur në të mund të shfaqet në çdo moment; çfarëdo

incidenti mund ta provokojë. Por, pa marrë parasysh se a shfaqet bisha apo jo, vetëdija më e thellë është e ndarë.

Vetëdija kështu e përçarë prodhon ankthin dhe pyetjen: si individi mund ta krijojë harmoninë me tërësinë?

E njëjta pyetje vlen edhe për bashkësinë: si mund ta ndërtojmë shoqërinë harmonike – në të cilën nuk do të ketë luftë, nuk do të ketë konflikt, nuk do të ketë klasa, e as ndasi në raca, kasta, religjione, kombe?

Në vend se të mendojmë mbi revolucionin dhe transformimin e shoqërisë, domethënë të strukturave të saj, do të duhej më shumë të mendonim mbi meditimin dhe transformimin e individit.

Kjo është mënyra e vetme e mundshme që, një ditë, t'i eliminojmë gjithë ndasitë në shoqëri. Por së pari duhet të eliminohen ndasitë në individin – atëherë edhe ndasitë në shoqëri do të zhduken vetvetiu.

14

Nuk ekziston kurrfarë kutie me etiketën në të cilën do të shkruante "E VËRTETA", e të cilën ti një ditë do të mund ta gjeje, ta shihje përmbajtjen e saj dhe të thoshe: "Super, e gjeta të vërtetën!"

Jo, kuti e tillë vërtet nuk ekziston.

15

Është e qartë arsyeja se përse njerëzit flasin mbi të vërtetën, e mbesin të jetojnë në botën e gënjeshtrës. Në zemrat e tyre ekziston gjakimi i sinqertë për të vërtetën; ata turpërohen para vetvetes shkaku se nuk jetojnë në të vërtetën, por vetëm flasin mbi të. Por ato janë vetëm fjalë. Të jetosh në përputhje me të vërtetën është së tepërmi rrezik dhe ata i frikohen rrezikut.

E njëjta vlen edhe kur liria është në pyetje. Çdo njeri e do të lirinë – së paku flet shumë për të – por askush realisht nuk është i lirë. Dhe askush vërtet nuk dëshiron të jetë i lirë, sepse liria bart me vete përgjegjësi; ajo nuk vjen vetëm. Nga ana tjetër, të jesh i varur është e thjeshtë; atëherë përgjegjësia nuk është tek ti, ajo është në personin prej të cilit je i varur.

Kështu njerëzit krijojnë mënyrë skizofrenike të jetës. Ata flasin mbi të vërtetën, flasin mbi lirinë – kurse jetojnë në gënjeshtra, jetojnë në robëri... në trajta të ndryshme të robërisë, pasi që cilado trajtë e robërisë është liri nga ndonjë përgjegjësi.

Njeriu i cili me të vërtetë dëshiron të jetë i

lirë merr mbi vete përgjegjësi të madhe. Ai nuk mund ta hedhë përgjegjësinë e vet në askënd tjetër. Çfarëdo që të bëjë, sido që të jetë, ai është përgjegjës.

16

Njeriu vërtet jo i dhunshëm është ai i cili nuk vret askënd dhe nuk e lëndon askënd, sepse ai është kundër vrasjeve dhe kundër lëndimeve. Por, po qe se dikush do të provojë ta lëndojë atë, ai edhe atëherë do të jetë kundër lëndimit. Po qe se dikush do të provojë ta vrasë, ai do të jetë kundër vrasjes: ai këtë nuk do të mund ta lejojë.

Ai kurrë nuk do të shkaktojë kurrfarë dhune, por po qe se dhuna do të shkaktohet kundër tij, ai atëherë do të luftojë me dhëmbë e me thonj. Vetëm ashtu njerëzit jo të dhunshëm mund të mbeten të pavarur; në të kundërtën ata do të jenë robër, dhe skamnorë, dhe viktima të përhershme plaçkitësish.

17

Që të jesh i pavarur ofroji vetes krejt atë që është e nevojshme për t'u ndjerë i përmbushur, krejt atë që është e nevojshme që jeta jote të jetë e kuptimshme, që të jetë me domethënie. Pikërisht ajo që do të jesh

autonom dhe do të zhvillohesh në harmoni me natyrën tënde, ka për të sjellë përmbushjen e fatit tënd.

18

Ji në ndryshim dhe përparim të përhershëm. Kurrë mos pusho së ndryshuari dhe kurrë mos pusho që të jesh i paparashikueshëm: vetëm atëherë jeta jote mund të jetë gëzim.

Në atë çast që bëhesh i parashikueshëm, do të jesh makinë.

Makina është e parashikueshme. Ajo ka qenë e njëjta dje, e njëjta është sot dhe e njëjta do të jetë nesër. Ajo është e pandryshueshme. Epërsia e vetme njerëzore mbi makinën qëndron në atë se mund të ndryshohet në çdo moment.

Atë qitë që do të pushosh së ndryshuari, në një mënyrë subtile do të jesh i vdekur.

19

Vërë në rrezik të gjitha. Ji kumarxhi!

Rreziko të gjitha, se çasti tjetër nuk është i sigurt. Pse atëherë të brengosesh? Pse të mërzitesh?

Jeto rrezikshëm, jeto dehurish. Jeto pa

frikë, jeto pa fajësi. Jeto pa frikë nga ferri dhe pa gjakim për parajsën.

Vetëm JETO!

20

Çdo gabim është rast për të mësuar. Vetëm mos përsërit të njëjtat gabime gjithnjë nga fillimi – ajo veçse është kokëtrashësi. Por bëj sa më shumë që të mundesh gabime të reja – mos iu frikëso kësaj – kjo është e vetmja mënyrë që të mësosh.

21

Religjioziteti thjesht do të thotë shtytje për të përparuar, shtytje që nxit farën të shprehet gjer në mundësitë e veta ekstreme; që të shpërthejë në mijëra lule dhe ta lirojë aromën e cila ka qenë në të. Ajo aromë – është religjioziteti.

22

Çdo njeri është aq fatkeq saqë, një çast, provon të gjejë ndonjë arsye me të cilën do t'ia arsyetonte vetes se përse është fatkeq. Shoqëria na ofron strategji të mirë për këtë: Gjykimin.

Natyrshëm, ti së pari e gjykon vetveten lidhur me çdo gjë. As njeri nuk është i përsosur, dhe asnjë njeri asnjëherë nuk do të jetë i përsosur – sepse përsosmëria nuk ekziston – gjykimi i tillë është gjithnjë i mundur. Ti je i papërsosur dhe ekzistojnë situata në të cilat tregohet papërsosmëria jote. Për këtë arsye je i hidhëruar. I hidhëruar je në veten dhe i hidhëruar je në gjithë botën. Shtron pyetjen: pse unë nuk jam i përsosur? Atëherë një ide të bie ndër mend - që papërsosmërinë ta gjesh tek të gjithë njerëzit.

E atëherë dëshiron ta hapësh zemrën tënde – kjo është e natyrshme, sepse gjithnjë derisa nuk hap zemrën tënde, në jetën tënde nuk ka për të hyrë gëzimi, jeta jote do të jetë gati se e vdekur. Por ti nuk mund ta bësh këtë menjëherë. Më parë duhet patjetër të heqësh gjithë mashtrimet e tua që në rrënjë.

Gjëja e parë në këtë rrugë është që të pushosh së gjykuari vetveten. Hidhe gjykimin, fillo ta pranosh vetveten me të gjitha papërsosmëritë e tua, me të gjitha gabimet, me të gjitha manitë dhe dobësitë. Mos kërko nga vetvetja që të jesh i përsosur. Ajo thjesht është kërkim i diçkahi të pamundur, prandaj ndjehesh i frustruar.

Ndërkaq, ti para së gjithash je qenie njerëzore.

23

Vetëm vështroji shtazët, vështroji zogjtë; asnjë prej tyre nuk është e brengosur, asnjë nuk është e mërzitur, asnjë e frustruar. Vallë, a ke parë ndonjëherë buall që të ketë fërshëllyer nga zemërimi? Ai me të njëjtën kënaqësi të përsosur do ta hajë barin e njëjtë për çdo ditë. Ai sikur të ishte i përndritur! Tek ai nuk ka tendosje, por vetëm harmoni të përsosur me natyrën, me vetveten, me çdo gjë që ekziston.

Buajt nuk krijojnë parti të cilat do ta revolucionarizonin botën, e cila do t'i transformonte buajt në super-buaj, e cila do t'i bënte ata religjiozë, të moralshëm. Dhe asnjë shtazë nuk u jep rëndësi ideve të njeriut.

Përkundrazi, ato do të duhej të qeshin me të:

"Çfarë po ndodh me ty? Përse nuk mund të jesh vetëm ai që je? Pse duhet të jesh diçka tjetër?"

Prandaj, më e rëndësishmja prej të gjithave është – ta pranosh vetveten plotësisht ashtu siç je.

24

Mos e gjyko sensualitetin.

Ai ka qenë i gjykuar nga e gjithë bota,

dhe prej atij gjykimi energjia e cila ka mundur të lulëzojë nga sensualiteti, është kthyer në perversion, xhelozi, hidhërim, urrejtje – në mënyrë jetese e cila është e thatë, pa lëng.

Sensualiteti është një nga gjërat më të çmuara të njerëzimit. Ai është ndjesia jote. Ai është vetëdijshmëria jote. Ai është vetëdijshmëria jote që rrjedh nëpër ty.

25

Që nga kohët më të lashta prindërit ruajnë idenë se fëmijët janë pronë e tyre dhe se duhet të jenë vetëm kopja besnike e tyre. Kopja nuk është gjë dhe aq e bukur dhe ekzistenca nuk beson në kopjen – ajo i gëzohet vetëm origjinalit.

Ti duhet t'u ndihmosh fëmijëve të tu të rriten të pavarur. Duhet t'u ndihmosh që mos me të imituar. Kjo është detyra e vërtetë e prindërve – t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre që të mos rrëshqasin në imitim. Fëmijët janë imitues natyrorë dhe që ata do të imitonin nëse jo prindërit e tyre, pasi që këta janë njerëzit më të afërm në rrethin e tyre.

Gjithnjë deri sot prindërit për së tepërmi janë kënaqur me atë që fëmijët po u ngjajnë atyre me sjellje. Babai është ndjerë krenar që

djali aq shumë po i ngjan. Dhe ashtu e ka shpërdoruar jetën e djalit; babait të tillë djali nuk i duhet, ai i mjafton vetvetes.

Shkaku i këtij koncepti të gabueshëm të krenarisë që fëmijët po na imitojnë, ne krijojnë shoqërinë e imititatorëve.

26

Dëgjueshmërisë nuk i duhet inteligjenca. Të gjitha makinat janë të dëgjueshme, kurrë askush nuk ka dëgjuar për makinat e padëgjueshme.

Dëgjueshmëria është e thjeshtë. Ajo nuk ndez në ty çfarëdo qoftë ndjenje të përgjegjësisë. Ajo nuk kërkon reaksion, veçse kërkon që ti ta bësh vetëm atë që të është thënë. Përgjegjësia është groposur me ardhjen e rendit (shoqëror). Në mënyrën e caktuar ti je tepër i lirë, sepse nuk mund të jesh i gjykuar për veprimet e tua.

27

Religjioziteti nuk është ajo në çfarë duhet të besosh, por ajo të cilën do të duhej ta jetosh, ajo që do të duhej shijuar... Mosbesimi në mendjen tënde, veçse është lulëzim i tërë qenies sate.

28

Mendja nuk mund e të mos sjell gjykime morale. Nëse ushtron dhunë mbi mendjen në këtë kuptim, do ta bllokosh inteligjencën dhe atëherë mendja nuk do të mund të jetë e lirë.

Të përmbajturit nga gjykimi moral nuk është diçka që është në domenin e mendjes. Vetëm njeriu që arrin andej mendjes mund të jetë i lirë nga kjo; në rastet tjera ajo që shfaqet në mendjen tënde ajo është fakt, qëndrim i vlefshëm, ajo është shfaqje reale.

Çfarëdo qëndrimi që mendja cakton, çfarëdo vendimi që sjellë do të jetë i ndotur me kushtëzimet e saj, me parabindjet e saj – kjo në të vërtetë është ajo që e ndërton gjykimin moral.

Për shembull, e sheh një hajn. Sheh se diçka ka vjedhur – ajo është fakt që nuk vihet në pyetje – dhe krijon gjykimin mbi atë se ai gjithsesi është hajn, se hajnia është diçka e keqe. Kur e emërton ndonjë njeri hajn, mendja jote thotë: "Ke të drejtë, gjykimi yt është i vlefshëm".

Por përse hajni përgjithësisht është i keq? Dhe ç'është e keqja? Pse ai ka qenë i shtrënguar të vjedhë? Ai moment i hajnisë është i veçuar nga të gjitha momentet tjera; në bazë të një momenti të veçuar ti po krijon gjykimin

mbi personalitetin e përgjithshëm. Po e quan hajdut edhe pse ai posedon edhe shumë veti tjera, dhe jo vetëm atë.

Ai mund të jetë piktor i mirë, mund të jetë zdrukthëtar i mirë, këngëtar i mirë, valltar i mirë – në të vërtetë, një mijë e një kualitete mund ta stolisin atë njeri. Në tërësinë e vet njeriu është i madh, hajnia është vetëm një pjesëz e tij.

Në bazë të një pjese të ndarë, ti nuk mund të krijosh gjykim mbi tërësinë e personit. Ti nuk e njeh atë person në plotëninë e vet, por ti gjithashtu nuk e njeh as atë veprim të veçuar, nën çfarë rrethanash ka ndodhur. Ndoshta në rrethana të tilla vjedhja nuk është diçka e keqe. Ndoshta edhe ti në rrethana të tilla kishe për të vjedhur. Shkaku se çdo veprim është produkt i rrethanave relative.

Po e shikove botën rreth vetes, do të shohësh se njerëzit ndodhen në rrethana të llojllojshme, e gjithashtu edhe idetë e tyre mbi të mirën dhe të keqen, korrekten dhe jokorrekten.

Për të parën herë ti do të jesh në mundësinë që të kuptosh se mendja jote është gjithashtu vetëm pjesëz e rrethanave të caktuara njerëzore. Ajo nuk reprezenton kurrfarë të vërtete; ajo reprezenton vetëm rrethana të caktuara.

Dhe çfarëdo të pashë me mendje të tillë, ajo është vetëm gjykim moral.

29

Ekzistenca është një, por manifestohet në miliona mënyra. Esenca që në atë mënyrë manifestohet është e njëjta. Një pe hyjnor zgjatet nëpër të gjitha trajtat e krijimit.

30

Paraja është fenomen i çuditshëm.

Nëse nuk ke para, ajo është gjë e thjeshtë – nuk ke dhe pikë – aty probleme nuk ekzistojnë. Por nëse ke, atëherë me siguri problemet ekzistojnë!

Një nga problemet më të mëdha që krijon paraja është ai që kurrë nuk di se a je i dëshirueshëm ti apo është e dëshirueshme paraja jote. Atëherë e ke vështirë ta paramendosh se dikush të do ty e jo paranë tënde. Kurse jeta mund të jetë aq e thjeshtë.

Ndërkaq, ajo që ka shkaktuar kënaqësinë e madhe, si për shembull paraja, mundet përnjëherë të kthehet në vuajtje të madhe. Por kjo nuk është produkt i parasë, veç i mendjes.

Paraja është e dobishme, të poseduarit e parasë nuk duhet të shkaktojë as ndjesi

mëkati, as ndjesi fajësie.

31

Ja, një mënyrë sesi mendja e prodhon vuajtjen.

Ti ke para dhe kënaqesh me to. Dhe kështu ndokush të do, këtë ti nuk e vë në pyetje, sepse ti atëherë atë person do ta vije në situatë tejet të pakëndshme; nëse ai thotë se të do ty, ti ende nuk do t'i besosh, e po qe se thotë se e do paranë tënde, atëherë romanca juaj në atë çast ka përfunduar. Kurse thellë në vete ti dyshon se ai është me ty vetëm për atë se do paranë tënde – e jo ty.

Por nuk ka asgjë të keqe në këtë; ato para janë të tuat, pikërisht siç është jotja hunda e jote, siç janë të tutë sytë e tu, siç janë të tuat flokët e tua. Dhe ai person të do në tërësinë tënde. Paraja jote është gjithashtu pjesë jotja. Mos e ndaj këtë nga të tjerat dhe nuk do të ketë probleme.

Provo ta jetosh jetën sa më thjesht dhe sa më me pak probleme – dhe do të jetë krejt në rregull.

32

Ta njohësh gjithë botën nuk është asgjë në

krahasim me njohjen e të fshehtave më të thella të jetës tënde.

33

Thënë esencialisht, ideja e krahasimit është plotësisht e gabuar.

Çdo person është unik sepse askush tjetër nuk është si ai. Krahasimi do të mund të ishte i drejtë vetëm po qe se gjithë personat ndërmjet veti do të ishin të njëjtë – por kjo nuk është kështu. Madje as binjakët nuk janë plotësisht të njëjtë. Nuk është e mundur të gjesh person që do të ishte identik me ty. Së këndejmi, të krahasosh njerëzit unikatë do të thotë të krijosh probleme të gjithmbarshme.

34

Një nga gjërat më të vështira, por edhe më e rëndësishmja në jetë është ajo që të mos e ndajmë jetën në gjëra të mira dhe idiotike, që të mos e ndajmë fare. Të gjitha ato gjëra janë pjesë e së njëjtës tërësi.

E nevojshme është të kemi vetëm pak ndjesi për humor. Për mua, ndjesia për humor është shumë e rëndësishme që njeriu të jetë tërësor.

Çfarë ka të keqe në gjërat e vogla, idiotike?

Pse nuk mund të qeshësh dhe të kënaqesh me to? Tërë kohën ti vetëm gjykon mbi atë se çfarë është mirë, e çfarë keq. Tërë kohën ti vetëm rri në karrigen e gjyqtarit – dhe ajo të bën aq serioz.

Lulja është e bukur, por ç'duhet gjembi? Ai është pjesë e pandashme në ekzistencën e lules. Lulja nuk mund të ekzistojë pa gjembin, ai e mbron. Gjembi ka rëndësinë e vet, qëllimin e vet, kuptimin e vet.

Ndërkaq, ti bën ndarjen – lulja është e bukur, kurse gjembi i shëmtuar. Porse në vetë trungun është i njëjti lëng që ushqen edhe lulen edhe gjembin. Në jetën e drurit nuk ekziston ndarja, nuk ekziston gjykimi. Lulja nuk është vetëm e mbrojtura, kurse gjembi vetëm ai që mbron; të dy së bashku janë tërësi e pranueshme.

Dhe këtë do të duhej zbatuar në jetë.

Ekzistojnë gjëra, gjëra të vogla të cilat, po i gjykove, duken marroqe, idiotike. Por kjo është vetëm shkaku se i gjykon; mos e bëj atë dhe do të shohësh se edhe ato e kanë kuptimin e ekzistencës.

35

I tërë roli i mendjes është që të bëjë ndarje, gjersa roli i zemrës është t'i shohë lidhjet e për-

bashkëta për të cilat mendja është plotësisht e verbër.

Mendja nuk mund të kuptojë atë që është jashtë fjalëve; ajo mund të kuptojë vetëm atë që është linguistike, logjikisht e drejtë. Ajo nuk ka kurrfarë lidhjeje me ekzistencën, me jetën, me realitetin. E marrë në vetvete mendja është fiksion.

Që njeriu të jetojë nuk nevojitet mendja, por i nevojitet zemra.

Që të jetosh sa më plotësisht, fut më tepër zemër në jetë.

36

Jeta është rrjedhë; ajo është lumë, zhvillim i pandërprerë.

Njerëzit për vetveten mendojnë se janë statikë. Por vetëm gjësendet janë statike, vetëm vdekja është e pandryshueshme – jeta është ndryshim i pandërprerë. Më shumë jetë – më shumë ndryshim. Begatia e jetës nënkupton ndryshimin e madh në çdo moment.

37

Askush nuk është më i mirë, askush nuk është më i keq, askush nuk është identik me dikë tjetër. Secili është unikat.

Njëjtësia është psikologjikisht e gabuar. Nuk mundet secili njeri të jetë Albert Ajnshtajn dhe nuk mundet secili njeri të jetë Rabindranat Tagore. Por kjo nuk do të thotë se Rabindranat Tagore është më i mirë shkaku se ti nuk mund të jesh ai. Por as Rabindranati nuk mund të jetë ti.

I tërë qëndrimi im është në atë se çdo njeri në vetvete është manifestim unik. Së këndejmi, duhet ta zhdukim idenë e gjithmbarshme të së lartës e të së ulëtës, të së njëjtës e të jo së njëjtës, dhe ta zëvendësojmë atë me konceptin e ri të unikes.

Secili person është unik.

Vetëm shiko me dashuri dhe do të shohësh se çdo individ ka diçka të veçantë që s'e ka asnjë tjetër.

38

Bëje vetëm atë që është e këndshme – e këndshme për ty dhe e këndshme për rrethin tënd. Bëje vetëm atë që do t'i japë impuls këngës në ty dhe do të krijojë ritëm feste rreth teje.

Një jetë të tillë unë e quaj religjioze.

Ajo nuk ka parime, nuk ka disiplinë, nuk ka ligje. Ajo kërkon një të vetmen qasje – të jetohet në mënyrë inteligjente.

39

Dëgjueshmëria është e thjeshtë; mos-dëgjueshmëria kërkon nivel pak më të lartë inteligjence. Cilido idiot qoftë mund të jetë i dëgjueshëm – në të vërtetë, vetëm idioti edhe mund të jetë i dëgjueshëm. Personi inteligjent shtron pyetje: "Pse? Pse prej meje pritet ta bëjë këtë? Dhe duke qenë se i di shkaqet dhe paso-jat e kësaj pritjeje, nuk dëshiroj të marr pjesë në të." Dhe kështu ai bëhet përgjegjës.

40

Plotësisht është e pamundur që shenjtori të bëhet horr – por është e mundur që horri të bëhet shenjtor.

41

Njeriu akoma nuk është i mësuar që ta njohë bukurinë e vetmisë. Ai, në të vërtetë, përherë gjakon për ndonjë lidhshmëri, të jetë me dikë – me mikun, me babanë, me gruan, me burrin, me fëmijën... me dikë.

Ai ka themeluar shoqëri, ai ka themeluar klube – Klubi Lajons, Klubi Rotari. Ai ka themeluar parti – politike, ideologjike. Ai ka themeluar religjione dhe kisha. Por qëllimi

kryesor i gjithë kësaj është që njeriu të harrojë se është vetëm. Duke u fshehur në bashkësinë sa më të madhe, njeriu tenton të harrojë atë që në errësirë befas i kujtohet – se ka lindur vetëm, se ka për të vdekur i vetëm, dhe se, çfarëdo që të bëjë, ai ka për të jetuar i vetëm.

Kjo vetmi është aq esenciale në ekzistencën e njeriut saqë ai nuk mundet assesi që t'i shpëtojë.

42

Çdo përpjekje e deritashme i orientuar kah ajo që t'i ikim vetmisë – ka përjetuar pasueses, e kështu do të jetë edhe në të ardhmen, sepse ajo është i drejtuar kundër esencës së jetës. Ty nuk të nevojitet diçka që të mund ta harrosh vetminë tënde, ty të nevojitet diçka që të mund të ishe i vetëdijshëm për veçantinë tënde – sepse ajo është realiteti.

Është aq bukur ta shijosh, ta ndjesh veçantinë, sepse ajo është liria jote nga turma, nga të tjerët. Ajo është, njëherazi, liria jote nga frika për të qenë i vetmuar. Vetë fjala "vetmi" menjëherë ta përkujton plagën: ke nevojë të vësh diçka mbi të. Ajo është zbrazëti, dhe ajo zbrazëtia të dhemb. Diçka të nevojitet për ta mbushur atë zbrazëtirë.

"Veçantia" – sipas esencës së fjalës – nuk

shkakton të njëjtën ndjesi të lëndimit, të zbrazëtisë të cilën duhet përmbushur. Veçantia thjesht do të thotë përmbushje. Ti je tërësor; nuk të nevojitet askush me të përmbushur.

Provo ta kuptosh qendrën tënde më të brendshme në të cilën përherë je vetëm, në të cilën përherë ke qenë vetëm. Në jetë, në vdekje, kudo që të jesh, ti do të jesh i vetëm. Por ajo është aso përmbushje, dhe jo zbrazëti, ajo është aso plotënie dhe integriteti që të vërshon me të gjitha lëngjet e jetës, me gjithë bukurinë dhe bekimin e ekzistencës, saqë përnjëherë ndjen veçantinë e cila do të eliminojë çdo dhembje nga zemra. Vërtet, ka me të vërshuar ritmi i ri i ëmbëlsisë, i qetësisë, i gëzimit dhe lumturisë së pamatur.

Kjo ndërkaq, nuk do të thotë se njeriu që është i përqendruar në veçantinë e vet, që është i integruar në vetvete, nuk mund të ketë miq – përkundrazi, vetëm ai edhe mund të ketë miq, sepse atij më asgjë nuk i duhet, ai jep. Vetëm ai që ka plot, vetëm ai mund të japë.

43

Të gjithë ne jemi pjesë e një ekzistence. More cilindo që e lëndojmë, ne në të vërtetë e lëndojmë vetveten në lojën e pafund të ekzis-

tencës. Ti sot ndoshta këtë nuk e kupton, por një ditë, kur do të jesh më i vetëdijshëm, ndoshta ke për të thënë: "O imzot! Këtë plagë ia kam shkaktuar vetvetes!" Ti ke mundur të lëndosh ndonjë tjetër gjithnjë derisa ke menduar se njerëzit janë të ndryshëm.

Por nuk ekziston tjetërfarësia. E tërë ekzistenca është një, unitet kozmik. Nga ky kuptim rezulton jo-dhuna.

44

Kur je i hidhëruar, ti e ndëshkon vetveten. Ti e kallë dhe shkatërron zemrën tënde dhe kualitetet e saj të larta – dhe bëhesh përplot urrejtje.

45

Njeriu është i përmbushur nëse është në harmoni me universin. Nëse nuk është në harmoni me universin, atëherë ai është i zbrazët, tmerrësisht i zbrazët; e nga ajo zbrazëtirë lind lakmia.

Domethënë, lakmia është përmbushje e asaj zbrazëtie – me të holla, me shtëpi, me mobile, me miq, me seks dhe me çfarëdo qoftë tjetër – thjesht sepse nuk mund të jetosh me zbrazëtinë. Kjo është tmerruese. Kjo është jetë fantazmash. Po qe se je i zbrazët dhe s'ka asgjë

në ty, atëherë është vërtet e pamundur të jetosh.

Për të pasur ndjesi duhet gjithsesi të jesh i pasur në vetvete. Në të vërtetë, ekzistojnë vetëm dy mënyra. Ose jeton në harmoni me universin... dhe atëherë je i përmbushur, të gjitha lulet dhe të gjithë yjet janë në ty – dhe kjo është përmbushje e vërtetë.

Ose nëse nuk jeton në harmoni me universin – e miliona njerëz nuk jetojnë ashtu – atëherë e përjeton vetveten si me qenë pleh.

Lakmia thjesht tregon se ti thellë në vetvete ndjen zbrazëti dhe dëshiron ta përmbushësh me çfarëdo qoftë; nuk është me rëndësi se çfarë do të mund të ishte ajo.

Po qe se vetëm njëherë e kupton këtë mësim, nuk nevojitet të bësh asgjë me lakminë. Duhet vetëm të bësh diçka që në bashkësi të vish me përmbushje, dhe zbrazëtia e brendshme vetvetiu do të zhduket.

46

E tërë e kaluara njerëzore e ka festuar varfërinë dhe e ka quajtur të barabartë me të qenit shpirtëror, gjë që plotësisht është e pakuptimtë.

Të qenit shpirtëror është pasuria më e madhe që mund t'i ndodhë njeriut. Ajo në

vetvete përmban të gjitha pasuritë tjera, dhe anasjelltas: ajo është kundërshtar i çdo lloji të varfërisë.

Nga njëra anë, njerëzit do ta nderojnë varfërinë, kurse në anën tjetër do të thonë: "Shërbeji skamnorit!" Çudi! Po qe se varfëria është aq shpirtërore, atëherë gjërat më shpirtërore kanë për ta bërë çdo njeri të pasur të varfër. Ndihmo që njeriu i pasur të bëhet i varfër. Ashtu do të mund të jetë shpirtëror. Pse atëherë të ndihmohet njeriut skamnor? Vallë, dëshiron ta asgjësosh të qenit e tij shpirtëror?!

Të jetosh në begati është e vetmja gjë shpirtërore në botë.

47

Paraja është barrë e rëndë nga arsyeja e thjeshtë se deri më tash nuk ia kemi dalë që të ngrehim një sistem të shëndoshë në të cilin ajo e njëjta para do t'i shërbente njerëzimit, në vend se të zotërojë ajo në duart e një numri të vogël njerëzish lakmitarë.

Paraja është barrë e rëndë shkaku se psika e njeriut është përplot lakmi. E shikuar nga ana tjetër, paraja thjesht do të thotë ndërrim i gjërave, mjet i përsosur, dhe në këtë nuk ka asgjë të keqe. Por mënyra sesi ne e përdorim

këtë mjet në çdo pikëpamje është e keqe.

Po qe se nuk ke para, ti je i nëmur, e tërë jeta jote është e zbrazët. Dhe e tërë jeta jote atëherë është vetëm përpjekje për të ardhur gjer tek paraja në çfarëdo mënyre.

Nëse, megjithatë, ke para ai fakt nuk e ndryshon gjënë esenciale – ti dëshiron më tepër dhe kjo nuk ka fund. Më në fund, ti ke aq shumë para – megjithëqë ato nuk janë mjaft, ato kurrë nuk janë mjaft pa marrë parasysh se ato janë më shumë se cilido që mund të ketë – saqë zë të ndjesh fajësi, shkaku se mjeti që ke grumbulluar, paraja, në të vërtetë është i shëmtuar, johuman, i dhunshëm. Ke eksploatuar njerëz, ua ke pirë gjakun, ke qenë parazit. Duke iu falënderuar kësaj ti tash ke para, por e ke edhe gjithë krimin të cilin e ke bërë për ta grumbulluar atë para.

Kjo ndjenjë fajësie formon dy lloje njerëzish: një lloj, të cilët japin donacione për institucionet bamirëse që të heqin qafe fajësinë, dhe të tjerët, të cilët kanë ndjenjë aq të fuqishme fajësie saqë shkaku i saj ose çmenden ose vetëvriten. E tërë jeta e tyre, së andejmi, bëhet vetëm vuajtje. Çdo frymëmarrje bëhet e rëndë. E gjëja më e çuditshme në krejt këtë është ajo se ai ka punuar gjithë jetën për të mbledhur atë para, meqë shoqëria e provokon dëshirën, ambicien, pasurinë dhe

fuqinë.

Kurse paraja vërtet sjell fuqi; ajo mund t'i blejë të gjitha, përpos një numri gjërash të cilat nuk mund të blihen. Por kush po interesohet për ato gjëra?

Meditimi nuk mund të blihet, dashuria nuk mund të blihet, miqësia nuk mund të blihet, falënderimi po ashtu – por kush akoma po çan kokën për to?

48

Vetëm vështroje ekzistencën dhe begatinë e saj. Ç'nevojë ka për aq shumë lule të gjithfarëllojshme në botë? Vetëm trëndafilat do të mund të ishin mjaft. Por ekzistenca është bollëk – miliona e miliona lulesh të llojllojshme, zogjsh, shtazësh – të gjitha janë bollëk.

Natyra nuk është varfanjake, ajo vallëzon në të gjitha – në oqean, në dru. Ajo këndon në të gjitha – në erën që fryn nëpër pishnajë, në zogj...

Çfarë është nevoja për miliona sistemet diellore, prej të cilëve secili në vetvete përmban miliona yje? Siç duket nuk ka kurrfarë nevoje, përpos nëse mbushullimi nuk është natyra esenciale e ekzistencës; ajo begati është bërthama esenciale. Prandaj nuk beson në varfërinë.

49

Unë nuk konsideroj se lakmia është ndonjë lloj dëshire. Ajo është më parë ndonjë sëmundje ekzistenciale. Ti nuk je në harmoni me tërësinë; vetëm harmonia me tërësinë mund të të bëjë të përmbushur.

Sipas meje, lakmia nuk është ndonjë trajtë dëshire, prandaj ti nuk di çfarë të bësh me të. Ti vetëm vëren zbrazëtinë të cilën provon ta përmbushësh dhe shtron pyetjet: "Pse unë jam i zbrazët? Ndoshta për atë se kam humbur drejtimin? Kaherë nuk shkoj në atë drejtim, nuk jam në ekzistencë... Kjo është arsyeja e zbrazëtisë sime."

Për këtë ji në ekzistencë, shko, ji afër me ekzistencën në qetësi dhe paqe, në meditim. Dhe një ditë do të vësh re se je aq i përmbushur, i stërmbushur, i vërshuar nga gëzimi, lumturia dhe përdëllimi. Ke aq shumë gjëra të çmuara në vetvete saqë mund t'ia japësh tërë botës, e që kurrë të mos mbetesh pa to.

Atë ditë, të parën herë në jetë, nuk ke për të ndjerë kurrfarë lakmie – për paranë, për ushqimet, për gjërat - për çfarëdo qoftë. Ti do të jetosh natyrshëm, e jo me lakminë të cilën nuk do të mund ta ushqesh, me plagën të cilën nuk do të mund ta shërosh, dhe çfarëdo që do të kesh nevojë, do ta arrish pa problem.

50

Secili njeri ndjehet inferior në këtë apo në atë mënyrë. Arsyeja e kësaj është se nuk e pranojmë faktin se secili njeri është unik. Gjatë një qëndrimi të tillë nuk shtrohet pyetja e inferioritetit apo superioritetit. Çdonjëri është unik në llojin e vet – dhe aty nuk ka vend për krahasim.

Ne nuk jemi të gatshëm ta pranojmë vetveten si të tillë. Në çastin që e pranon vetveten të tillë siç je, pa kurrfarë krahasimi, të gjitha inferioritetet dhe superioritetet do të zhduken. Në pranimin e plotë të vetvetes, ti do të jesh i lirë prej këtyre kompleksëve – të inferioritetit dhe superioritetit. Në të kundërtën, ke për të vuajtur tërë jetën.

Unë nuk mund ta paramendoj personin i cili do të mund t'i kishte të gjitha në këtë botë. Shumë këtë e kanë provuar, por në fund kanë dështuar.

Vetëm ji i vetvetes, dhe kjo mjafton.

Të tillë siç je të pranon dielli, të pranon hëna, të pranon druri, të pranon oqeani, të pranon toka. Çfarë do më tepër se kaq? Të pranon e tërë bota.

Gëzoju kësaj.

51

Çdo njeri ndjen nevojën që të jetë me vlerë

dhe ta konfirmojë vlerën e vet.

E tërë jeta jonë është ashtu e strukturuar që të konsiderojmë se po qe se askush nuk na pranon, ne jemi asgjë, ne jemi të pavlerë. Puna të cilën e kryejmë nuk është shumë e rëndësishme, por së paku merr mirënjohje. Premisa e këtillë e gjërave e bën jetën rrëmujë.

Puna jonë duhet të merret e rëndësishme, sepse prodhon gëzim të brendshëm. Ti duhet të punosh jo që puna jote të jetë e pranuar, por që të kënaqesh në kreativitetin tënd. Ti e do atë punë shkaku i vetë asaj. Po e punon atë, sepse po e do atë.

Mos kërko mirënjohje. Nëse mirënjohja megjithatë vjen, pranoje atë i relaksuar. Nëse nuk vjen, kurrgjë kurrkujt. Kuptimi i punës tënde duhet të jetë në vetë punën.

52

Sikur çdo njeri ta mësonte këtë art të thjeshtë – që ta dojë punën e vet çfarëdo që të jetë, që të kënaqet në të duke mos pritur kurrfarë mirënjohjeje – do të kishim botë shumë më të bukur dhe shumë më të lumtur; në rast të kundërt, bota do t'ju mbërthejë në kurthin e jetesës së mjerë skamnore. Ajo që e punon nuk është e mirë shkaku se e do atë punë, shkaku se e bën atë përsosmërisht, por është

e mirë nëse bota e pranon, e shpërblen, i jep medalje të artë, i ndan çmimin Nobel.

Kështu e kanë çrrënjosur gjithë vlerën esenciale të krijimtarisë dhe në këtë mënyrë kanë asgjësuar miliona njerëz – sepse nuk munden që një numri të tillë njerëzish t'ia ndajnë çmimin Nobel. E atëherë tek secili njeri ata krijojnë dëshirën për mirënjohje, ashtu që askush më nuk mund të punojë në paqe, në qetësi, nuk mund të kënaqet në atë që e punon, çfarëdo që të jetë ajo. Kurse jeta përbëhet prej gjërave të vogla. Për ato gjëra të vogla nuk ekzistojnë mirënjohjet, ato nuk titullohen nga ana e qeverisë, universitetet nuk u ndajnë doktorata nderi.

Ai njeri që jeton për dashurinë e vet, për punën e vet personale, duke mos çarë kokën për mendimet e huaja, ai ka individualitetin e vet personal.

53

Kënaqësia nuk është në atë që të bëjmë diçka veç sa për ta bërë; kënaqësia është në atë që ti atë ta duash, ta duash atë me krejt fuqinë, të harrosh çdo gjë kur merresh me të, e harron mbarë botën; dhe vetëm ajo mbetet në objektivin e mbarë ekzistencës tënde.

Dhe kjo është lumturia jote dhe shpërblimi

yt – e jo sasia apo përhershmëria e diçkahi.

Në secilin çast të rrjedhës së ndryshueshme të ekzistencës do ta gjejmë shpërblimin tonë personal. Çfarëdo që bëjmë, ta bëjmë atë më së miri që mundemi, e jo me gjysmë zemre. Nëse nuk japim çdo gjë prej vetes, asgjë me vlerë nuk mund të bëjmë.

Në këtë është e tërë fatkeqësia jonë.

54

Është fakt i thjeshtë se çdo njeri është unik dhe se ka individualitet të veçantë. Me këso qëndrimi, ne në të vërtetë hedhim poshtë idenë se njeriu do të duhej të ishte ky apo ai, dhe e zëvendësojmë atë me filozofinë se njeriu është i bukur more sido që të jetë. Qëndrimi "do të duhej" është i gabuar, se kush jemi ne që t'ia imponojmë ndonjë "duhet" kujtdo qoftë? Po qe se ekzistenca të ka pranuar të tillë siç je, kush jam unë që këtë të mos e bëj?!

Prandaj, vetëm ndrysho qëndrimin dhe një gjë shumë e thjeshtë në çast do të vijë në horizontin tënd:

Secili njeri është unikat; secili njeri është i tillë çfarë është, dhe duhet të jetë i tillë çfarë është. Atij nuk i duhet të jetë dikush tjetër për të qenë i pranuar; ai është i pranuar përgjithmonë. Unë këtë e quaj nderim të individu-

alitetit, nderim të njerëzve – të tillë siç janë.

I tërë njerëzimi do të mund të ishte bashkësi aq e bukur dhe e gëzuar vetëm sikur të mund t'i pranonim njerëzit të tillë siç janë.

55

Ai komunizëm që lind nga dashuria, nga inteligjenca dhe fisnikëria do të jetë real. Komunizmi që do të lind dhunshëm, do të jetë joreal.

Dhe nuk ka asnjë njeri në botë, more sado qoftë i varfër, i cili nuk do ta përkrahte komunizmin e tillë real.

56

Pse nuk krijojmë jetë në të cilën paraja nuk do të krijojë hierarki, por, përkundrazi, do të japë më tepër shanse për gjithsecilin.

57

Njerëzit autoritarë janë ata të cilët vuajnë nga kompleksi i inferioritetit.

Sa më i fshehtë që të jetë inferioriteti i tyre, aq më tepër ata ekspozojnë kinse superioritetin e vet. Ata duan të konfirmojnë se janë dikush, se fjala e tyre është me peshë, se fjala

e tyre është ligj. Por thellë në vetvete ata janë krijesa tejet inferiore.

58

Natyra sigurisht se nuk është hierarki. Hierarkia është lojë mentale e njeriut, pasi që pa hierarki egoja nuk mund të ushqehet – ajo vdes.

Në natyrë, megjithatë, secili merr shansin e vet, pjesën e vet të hapësirës dhe aty askush nuk është kryesori. Askush nuk është zotëriu dhe askush nuk është shërbëtori. Natyra vepron gati si organizëm unik në të cilin individualiteti nuk është zhdukur, por në të cilën egoja nuk ka gjasë që të zhvillohet; prandaj druri nuk ka ego, zogjtë nuk kanë ego. Shtazët more të cilitdo lloj, nuk kanë ego.

Pra, ky është vetëm problem i njeriut!

59

Privilegj i njeriut – vetëm privilegj i njeriut është që të mbesë vetëm, që të qëndrojë i vetëm kundruall gjithë botës nëse ndjen se e vërteta është me të.

Nëse ti ndjen se ajo është mënyrë e cila të dërgon në liri, prano cilëndo formë të përgjegjësisë. Asnjë prej atyre përgjegjësive nuk ka me të sjellë dëm. Secila prej tyre ka me

të bërë person më të pjekur, më të përqendruar, më të integruar dhe më të bukur.

60

Ti ke vetëm një çast në duart e tua – çastin e tanishëm. Dhe ky çast është i papërsëritshëm. Së këndejmi, përjetoje atë ose hiçit je duke ia falur të papërjetuar.

61

Secili fëmijë e kupton atë se pikëpamja e tij ndaj botës është tjetër ndryshe nga pikëpamja e prindërve të tij. Për çfarëdo që interesohet, ajo është plotësisht unike.

Vlerësimi i tij është tjetër fare. Ai mund të mbledhë guaca deti në plazh, megjithëqë prindërit do t'i thonë: "Hiqu tyre. Pse humb kohë me marrëzira?" Por për të, guacat janë tepër të bukura.

Ai i sheh tjetër ndryshe, ai e sheh vlerën e tyre në tjetër mënyrë. Prindërit e tij nxitojnë pas parasë; ai, ndërkaq, dëshiron të mbledh flutura. Ai nuk mund të kuptojë se përse prindërit e tij aq shumë interesohen për para: "Çfarë do të bëni me ato para?" Prindërit e tij, prapë, nuk mund të kuptojnë se çfarë ai dëshiron të bëjë me ato flutura, apo lule.

Çdo fëmijë vjen gjer tek njohja se ekzistojnë dallime midis tij dhe prindërve të tij, problemi i vetëm është në atë se ai frikohet ta vërë në pah të drejtën e tij.

More për çfarëdo që interesohet, ai do të duhej të ishte i veçantë. Në pyetje është vetëm pak guxim – i cili akoma nuk është ndrydhur në fëmijën, përkundër asaj se e tërë shoqëria është e orientuar në atë mënyrë që madje edhe një kualitet i tillë i mrekullueshëm, siç është guximi tek fëmija, të jetë i gjykuar.

Po qe se prindërit vërtet e duan fëmijën e tyre, ata do t'i ndihmojnë të bëhet i guximshëm – i guximshëm madje edhe përballë tyre. Ata do t'i ndihmojnë të jetë i guximshëm kundruall mësuesve, kundruall shoqërisë, kundruall kujtdo qoftë që provon t'ia asgjësojë individualitetin e tij.

62

Mbaje në mend! Kurrë mos bëj kompromis. Kompromisi është në kundërshti absolute me vizionin tim të përgjithshëm.

Shikoji njerëzit. Ata janë fatkëqij shkaku se bëjnë kompromis në çdo situatë dhe nuk mund t'ia falin vetvetes shkaku se janë të tillë. Ata e dinë se kanë mundur të mbledhin guxim, por ata janë qyqe të verifikuara. Ata janë poshtëru-

ar në sytë e vet, e kanë humbur nderimin e vetvetes. Qe, çfarë bën kompromisi!

Pse na nevojitet kompromisi? Çfarë mund të humbasim? Në këtë jetë të vogël jeto sa më plotësisht që mundesh. Mos u frikëso të shkosh gjer në fund. Nuk mund të shkosh më larg sesa plotësia – ajo është linja e fundit. Dhe mos bëj kompromis. E tërë mendja jote do ta kërkojë kompromisin, sepse ashtu jemi edukuar, ashtu jemi kushtëzuar.

"Kompromis" është një nga fjalët më të shëmtuara në gjuhën tonë. Ajo do të thotë: "Unë po e jap gjysmën, ti jepe gjysmën; unë po lëshoj pe përgjysmë, ti lësho pe përgjysmë." Po përse? Nëse mund ta hash tërë ëmbëlsirën, pse atëherë do ta haje vetëm gjysmën? Prandaj, përse kompromisi?

Të nevojitet vetëm pak trimëri, pak guxim – dhe do të jesh në fillim. Menjëherë do ta shijosh bukurinë e të mos lëshuarit pe dhe të zgjimit të dinjitetit, do ta shijosh integritetin dhe individualitetin, dhe për të parën herë do të ndjesh se e ke esencën dhe se ajo akoma ekziston në qendrën tënde personale.

63

Personin fatkeq është lehtë ta robërosh. Por personin me gjallëri dhe të lumtur është e

pamundur ta robërosh.

64

Seksi është fillimi i jetës, kurse vdekja fundi i po së njëjtës jetë; së andejmi, ato janë dy skajet e së njëjtës energji; dy polet e së njëjtës energji. Ato nuk mund e të mos jenë të lidhura.

Seksi me gjasë është vdekje në sekuenca, derisa vdekja seks në plotësi.

Por, e padyshimtë është se po e njëjta energji vepron në të dyja anët.

65

Pse nuk krijojmë jetë në të cilën seksi nuk do të jetë përvojë e hidhur, nuk do të ketë xhelozi, nuk do të ketë dështime; pse nuk krijojmë jetë në të cilën seksi do të bëhej vetëm argëtim – kurrgjë më tepër se cilado lojë, në këtë rast, lojë biologjike.

Nëse luan tenis, kjo nuk do të thotë se gjithë jetën duhet patjetër të luash tenis me të njëjtin partner.

Jeta do të duhej të ishte më argëtuese sesa lojët e tenisit. Nevojitet vetëm pak mirëkuptim dhe dashuria nuk do të jetë problem, e seksi nuk do të jetë tabu.

66

Mendja është thjesht grumbull kujtimesh për të kaluarën dhe – përpos atij kujtimi – fantazim mbi ardhmërinë.

67

Shfrytëzo çdo rast në jetë që ta lartësosh inteligjencën tënde, vetëdijen tënde.

Ajo që rëndom bëjmë në jetë është se shfrytëzojmë çdo rast që vetë-vetes t'ia ndërtojmë ferrin. Shkaku i kësaj ti vuan, kurse vuajtja jote u krijon vuajtje të tjerëve.

E kur aq shumë njerëz jetojnë së bashku, dhe të gjithë i krijojnë vuajtje njëri-tjetrit, kjo shumëfishohet. Ja se në ç'mënyrë e tërë bota bëhet ferr.

Kjo do të mund të ndryshonte menjëherë vetëm po qe se do të kuptohej gjëja themelore: pa inteligjencë nuk ka parajsë.

68

Siç unë e kuptoj, roli i prindërve nuk është në atë që t'i ndihmojnë fëmijës të rritet; ai do të rritet edhe pa ndihmën e prindërve.

Roli juaj është në atë që ta përkrahni, ta edukoni, ta ndihmoni, që fëmija juaj të jetë

pikërisht ai që veç po bëhet. Mos i ofroni direktiva, mos i ofroni ideale. Mos i flisni se çfarë është në rregull e çfarë gabim – lejojeni që ai vetë atë ta zbulojë përmes rrugës së përvojës personale.

69

Ideja e përgjithshme se fëmijët janë pronë e juaja është e gabuar. Fëmijët kanë lindur nëpërmjet jush, por ata nuk janë pronë e juaj. Ju keni tërë të kaluarën, ata kanë vetëm ardhmërinë.

Ata nuk do të jetojnë sipas kritereve tuaja. Sikur të jetonin sipas kritereve tuaja, ajo do të thoshte se nuk jetojnë pothuajse fare. Ata dëshirojnë të jetojnë sipas kritereve të tyre – lirshëm, me përgjegjësi, duke u sfiduar.

70

Kuptojeni njëherë se fëmijët tuaj nuk ju përkasin juve; ata i përkasin ekzistencës kurse ju jeni vetëm dalje. Dhe duhet t'i jini falënderues ekzistencës që ju ka zgjedhur ju të jeni dalje për disa fëmijë të mrekullueshëm. Por ju nuk guxoni ta pengoni zhvillimin e tyre, mundësinë e tyre. Ju nuk guxoni t'ua impononi vetveten.

Ata nuk kanë për të jetuar në kohën tuaj, ata nuk kanë për t'u përballur me të njëjtat probleme me të cilat ju përballeni. Ata do të jenë pjesë e botës tjetër. Mos i përgatitni për këtë botë, për këtë shoqëri, për këtë kohë, se asisoj ju do t'u krijoni probleme. Do të jenë të papërgatitur për të, do të jenë të paaftë.

71

Mizoria është gabim në të kuptuar. Ajo lind në ne si pasojë e frikës nga vdekja. Ne nuk dëshirojmë të vdesim, prandaj para se dikush të na vrasë ne, ne dëshirojmë ta vrasim atë – se sulmi është mbrojtja më e mirë. Ti edhe nuk di se kush në të vërtetë e ka ndërmend me të vra.

Në mbretërinë shtazore, në botën njerëzore zhvillohet garë e tmerrshme në të cilën njerëzit thjesht sulmojnë, duke mos pasur dert se kë sulmojnë dhe se a është ajo e bazuar. Kjo s'është as me rëndësi – me rëndësi është të mos i japim shans askujt.

E kur e sulmon dikë, zemra jote gradualisht bëhet gjithnjë e më e fortë e më e fortë dhe ti zë të ndjesh kënaqësi në sulm. Dukuria e njëjtë mund të vihet re tek bota shtazore, se edhe atje zhvillohet gara (për ushqim, për fuqi...).

Mizoria nuk është asgjë tjetër pos garë në atë se kush do të jetë i pari. Nëse dhuna është

mjet për të ardhur tek kjo, atëherë do të ketë dhunë; por çfarëdo që duhet, ai duhet gjithsesi të jetë i pari. Kjo është kështu tek shtazët, e kështu është edhe tek njerëzit. Po përse ajo nervozë për të qenë i pari?

Kjo çon në konstatimin se vdekja është qëllimi i jetës.

72

Në harmoni me konstatimin tim mbi lindjen e mizorisë – mizoria zhduket vetëm atëherë kur e ke njohjen se vdekja nuk ekziston. Kur e shijon pavdekësinë në vete – mizoria zhduket. Atëherë ajo nuk ka kuptim; ti atëherë nuk ke nevojë të nxitosh dhe tjerët lirisht mund të jenë përpara teje, sepse ato krijesa të shkreta nuk dinë se bota është e pafundme, se jeta është e pafund.

E kur është ashtu, atëherë nuk ka gjasa që dikë ta lëshosh të dalë përpara teje; nëse kjo nuk ndodh sot, do të ndodhë nesër. Por nëse ke kuptim të drejtë, asgjë nuk mund të të dalë nga dora.

73

Në realitet, nëse luftojmë në mes veti, nëse jemi mizor dhe të dhunshëm, mund të humbasim shumëçka, se i tërë ai proces ka me të

zhvidhosur, do të bëjë që zemra jote të gurëzohet. E po qe se zemra gurëzohet, ajo do të humbas gjithçka që është e madhe, gjithçka që është e bukur, gjithçka që është e gëzuar.

Kjo është vështirë t'u shpjegohet shtazëve. Por, problemi i vërtetë është në atë se kjo është po ashtu vështirë t'i shpjegohet edhe njeriut; përmes rrugës së zilisë, ambicies së furishme, gjakimit që gjithkund të mbërrish i pari, ti krijon botë të çmendurish në të cilën askush në asgjë nuk kënaqet, por gjithsecili bëhet i skamur.

Ekziston vetëm një mënyrë që njeriu ta arrijë mirëkuptimin, e kjo është t'i ndihmosh të ndjejë unin e vet të pavdekshëm dhe e tërë ashpërsia do të zhduket në vend. Jeta është shumë e shkurtër për t'u bërë probleme. Po e shikove pafundësinë nga të dyja skajet – e kaluara dhe e ardhmja – nuk do të kesh nevojë të nxitosh, as që do të kesh nevojë të bësh garë me këdo qoftë.

Jeta është aq e begatshme dhe aq përmbajtësore saqë nuk mund ta shterrosh.

74

Për ata që dëshirojnë vetëm të mendojnë mbi jetën, mbi të jetuarit, mbi dashurinë – për ta e kaluara dhe e ardhja janë përsosmërisht të bukura shkaku se u ofrojnë horizont të

pafundmë.

Ata mund ta stolisin të kaluarën e tyre, mund ta bëjnë po aq të bukur sa ata dëshirojnë – edhe pse kurrë nuk kanë jetuar në të; kur ajo e kaluar ka qenë e tashmja, ata nuk kanë qenë aty. Ata janë vetëm hije, vetëm shprehje. Ata pandërprerë kanë nxituar, dhe derisa ashtu kanë nxituar, kanë parë një sërë gjërash për të cilat mendojnë se janë vetë jeta.

Në të kaluarën, vetëm vdekja është realitet, por jo edhe jeta.

Në të ardhmen, gjithashtu, vetëm vdekja ka realitet, por jo edhe jeta.

Për ata që e kanë huqur jetën në të kaluarën, si zëvendësim për atë zbrazëtirë automatikisht vihet në lëvizje ëndrra mbi ardhmërinë. Ardhmëria është vetëm projeksion i lindur nga e kaluara. Çfarëdo që njeriu të ketë huqur në të kaluarën, ai shpreson se atë do ta kompensojë në ardhmëri; në mes të këtyre dy mosekzistencave ndodhet një çast i vogël i ekzistencës – vetë JETA.

75

Është i rrënjosur mendimi se koha përbëhet prej tri segmenteve – së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes; ndërkaq, ky mendim është i gabuar. Koha përbëhet vetëm nga e

kaluara dhe e ardhmja. Jeta përbëhet nga e tashmja. Për ata që dëshirojnë të jetojnë, për ta nuk ekziston asnjë mënyrë tjetër përveçse ta jetojnë çastin e tanishëm.

Vetëm e tanishmja e posedon ekzistencën.

E kaluara është vetëm koleksion kujtimesh, kurse e ardhmja nuk është gjë tjetër përveçse imagjinata jote, ëndrrat e tua.

Realiteti është këtu dhe tash.

76

E tashmja nuk ka kurrfarë lidhjeje me kohën. Po qe se ndodhesh pikërisht këtu dhe në këtë çast, atëherë aty nuk ekziston koha. Ekziston vetëm qetësia e pamatshme, heshtimi, palëvizshmëria, asgjë nuk pipëtinë, çdo gjë ekzistuese befasisht ka ndaluar.

E tashmja ta jep rastin të zhytesh thellë në ujin e jetës, apo të fluturosh lart në qiellin e jetës.

Por mbi të dyja këto skajshmëri del para rreziku – "e kaluara" dhe "e ardhmja" janë fjalët më të rrezikshme në gjuhën njerëzore. Midis së kaluarës dhe së ardhmes, jeta në të tashmen duket gati si ecja nëpër litarin e ngrehur; nga të dyja anët përgjon rreziku.

Por, njëherë, ti ke për t'i shijuar lëngjet e së tashmes dhe s'ke për ta përfillur rrezikun.

Njëherë ke për t'u harmonizuar me jetën dhe asgjë tjetër nuk ka me qenë e rëndësishme.

Për mua, jetë është krejt çfarë ekziston.

77

Për atë që dëshiron të jetojë – e jo të mendojë mbi jetën; që dëshiron të dashurojë, e jo të mendojë mbi dashurinë; që dëshiron të ekzistojë, e jo të filozofojë mbi ardhmërinë – për të nuk ka alternativë përpos se t'i pijë lëngjet e çastit të tanishëm. Piji në tërësi, se ato nuk kanë për t'u kthyer përsëri. Ajo që njëherë ka shkuar, ka shkuar përgjithmonë.

78

Jeta zgjatet gjatë shtatëdhjetë, tetëdhjetë vjetëve, kurse vdekja ndodh në një sekondë. Ajo është aq e kondensuar saqë nëse e jeton jetën tënde vlefshmërisht, guximshëm, do të jesh në gjendje të penetrosh në misterin e vdekjes. E misteri i vdekjes është në atë se ajo është vetëm mbulesë: nën të është pavdekësia jote, jeta jote e amshueshme.

79

Unë nuk mendoj shumë mbi ardhmërinë,

se ajo lind nga e tashmja. Nëse mund të kujdesemi për të tashmen, do të mund të kujdesemi për të ardhmen.

Ardhmëria nuk mund të vijë prej askund, ajo lind prej këtij çasti. Momenti i ardhshëm do të lind nga i tashmi.

Po qe se ky çast është i bukur, i qetë, i bekuar, çasti tjetër duhet të jetë patjetër edhe më i qetë, edhe më i bekuar.

80

Të jesh serioz, për mua do të thotë – të jesh i sëmurë. Kuptimi për humor ka me të ba më human, më modest. Sipas meje, kuptimi për humor është pjesa më esenciale e religjiozitetit.

81

Njeriu nuk duhet ta transcendentojë natyrën. Përkundrazi, njeriu duhet ta realizojë natyrën – gjë të cilën asnjë shtazë nuk mund ta bëjë. Këtu është dallimi.

Ti je i lindur si qenie natyrore. Ti nuk mund të shkosh përmbi vetveten. Kjo është si të dëshiroje ta ngritje vetveten gjithsesi, ashtu që do t'i kapësh këmbët e tua dhe do të ngrihesh përpjetë. Këtë mund ta provosh pak, por

herët apo vonë ke për të rënë në tokë dhe ke për t'u thyer. Ti nuk mund të fluturosh.

Kjo është ajo që ndodh deri më sot: njeriu ka provuar ta ngritë vetveten mbi natyrën, që do të thotë mbi vetveten. Por ai nuk mund të ndahet nga natyra.

Njeriu ka aftësinë, ka inteligjencën, ka lirinë për të hulumtuar – dhe po qe se e hulumton natyrën në plotësi, ka për t'iu kthyer shtëpisë së vet.

Natyra është shtëpia e njeriut.

82

Ky është një nga ligjet themelore të jetës: krejt ajo që është më e lartësuar ajo është më e lëndueshme. Rrënja e drurit është shumë e fortë, por lulet e tij nuk janë. Lulet janë tejet të ndjeshme – e mjaftueshme është një puhi pak më e fortë dhe ato do të asgjësohen.

E njëjta vlen edhe për vetëdijen njerëzore. Urrejtja është shumë e fortë, por dashuria nuk është. Dashuria është mu si lulet – lehtë i ndrydh ndonjë gur apo i asgjëson ndonjë shtazë.

Vlerat e larta të jetës duhet të jenë të mbrojtura.

Vlerat e ulëta e mbrojnë vetveten. Gurit nuk i nevojitet mbrojtja, por vetëm pak përtej tij

trëndafilit në kaçubë i duhet mbrojtja. Guri është i vdekur dhe ai nuk mund të jetë më i vdekur sesa që është. Prandaj atij nuk i duhet mbrojtje.

Por, trëndafili është aq i gjallërishëm, aq i bukur, aq tërheqës. Në këtë është fuqia e tij – por, kjo provokon edhe rrezikun. Dikush mund ta këpusë. Askush nuk ka për të mbledhur gurë, por trëndafilin do ta këpusë.

83

Dashuria duhet të ngrihet gjer në kulmin më të lartë – por kjo kërkon disiplinë të caktuar. Njerëzit e shfrytëzojnë disiplinën, por jo edhe kur bëjnë dashuri. Unë e preferoj disiplinën për bërjen e drejtë të dashurisë, ashtu që ajo mos të jetë vetëm çështje biologjike e cila kurrë nuk ka me të ngritë në botën tënde shpirtërore.

Dashuria ka potencial me të ngritë madje gjer tek bota jote shpirtërore, kulmi i saj e ka këtë mundësi.

84

Orgazma nuk është diçka që është e domosdoshme për reproduktim. Ajo është diçka që hap shtegun për evolucionin më të lartë të vetëdijes.

85

Përvoja e orgazmës gjithnjë është joseksuale. Madje edhe nëse e arrin përmes seksit, ajo në vetvete nuk ka seksualitet.

Kjo na e ofron idenë se orgazma mund të arrihet edhe pa mjete seksuale, sepse ajo në vetvete është joseksuale, ashtu që seksualiteti nuk është detyrimisht mënyra e vetme për të.

More sido që të jetë përvoja e parë, prej saj duhet të nxirret përfundimi se mund të ekzistojnë rrugë të tjera për të arritur tek orgazma – për atë se seksi nuk është pjesë e domosdoshme e saj. Në të nuk mbetet kurrfarë ngjyre, kurrfarë shenje e seksit.

Së këndejmi, duhet kuptuar si ajo ndodh dhe gjërat atëherë bëhen më të qarta: në çastin kur ndodh orgazma, koha ndalet, ti e harron kohën. Mendja jote ndalon, ti nuk mendon mbi asgjë, ekziston vetëm qetësia e pamatshme dhe vetëdija e pamatshme.

Secili që kalon nëpër këtë eksperiencë, e që e vështron me kujdes, natyrshëm ka për të menduar në këtë mënyrë: "Po qe se këto gjëra do të mund të arriheshin pa seks – vetëdijshmëria, pamendimësia, pakohësia – atëherë gjendja orgazmike do të mund të arrihej edhe pa seks." E i këtillë është edhe koncepti im: ajo është mënyrë përmes së cilës njeriu do të

mund ta zbulojë meditimin.

86

Liria thjesht të bën përgjegjës ndaj gjithë asaj që je dhe gjithë asaj që synon të jesh.

87

Ekzistojnë njerëz që janë të hidhëruar për nga natyra; njerëzit e tillë ngritin revolucione, e transformojnë shoqërinë, e transformojnë shtetin. Por, të gjitha revolucionet e tyre falimentojnë, meqë ajo që buron nga hidhërimi, buron nga padituria. Ajo nuk është në gjendje të krijojë ndryshim autentik.

88

Ndryshimi kah e mira, që lind nga hidhërimi – është i pamundur.

Do të dëshiroja të mbanit mend një gjë – pikëllimi është, në të vërtetë, hidhërimi i kthyer mbrapsht. Ai nuk është gjë tjetër përpos hidhërim i ndrydhur. Nëse e analizoni çështjen, do të shihni se kjo është fakt. Pikëllimi mund të shndërrohet në hidhërim shumë lehtë; në të njëjtën mënyrë hidhërimi mund të shndërrohet në pikëllim. Ato nuk janë dy gjëra

të ndryshme... veçse, me siguri, dy anët e së njëjtës medalje.

89

Bota është pikëllim, bota është mërzi. Në zemrat e njerëzve ka vuajtje të madhe. Por ti nuk duhet të jesh i pikëlluar shkaku i kësaj, sepse duke u bërë i pikëlluar ti iu bashkëngjitesh, ashtu që vetëm sa e rrit pikëllimin. E kjo nuk është ndihmesë.

Kjo është si kur njerëzit janë të sëmurë: ti e provon sëmundjen e tyre, e atëherë edhe vetë bëhesh i sëmurë. Ndërkaq, të kesh ndjenja për sëmundjen e tyre do të thotë të gjurmosh për shkaktarin i cili ka prodhuar gjithë vuajtjen dhe mërzinë e tyre dhe t'u ndihmosh ta eliminojnë atë shkaktar.

Në të njëjtën kohë, ti do të duhej të mbeteshe i lumtur për aq sa kjo është e mundur, sepse atyre do t'u ndihmojë lumturia jote – e jo pikëllimi yt. Ti do të duhej të ishe plot gjallëri, për të mundur ata ta kuptojnë se është e mundur të jenë të gjallërishëm në këtë botë të pikëlluar...

90

Zemërimi është përherë shenjë dobësie.

91

Periudhat e fatkeqësisë të bëjnë të vetëdijshëm për realitetin i tillë çfarë ai është. Realiteti është përherë i thyeshëm, secili është përherë në rrezik. Kjo ndodh pikërisht në kohët e zakonshme kur njeriu lehtësisht luhatet dhe nuk e sheh rrezikun. Ai atëherë kotet, duke ëndërruar mbi gjërat e bukura të cilat do të ndodhin në ardhmëri.

E në momentin kur rreziku kanoset, njeriu befas bëhet i vetëdijshëm se ndoshta nuk do të ketë as lumturi, as të nesërme, dhe se ai moment është i vetmi moment që posedon.

Periudhat e fatkeqësisë janë shumë zhdehëse. Ato nuk sjellin asgjë të re në botë; ato bëjnë vetëm që të jemi të vetëdijshëm për botën ashtu siç ajo është. Ato të zgjojnë. Nëse këtë s'e kupton, atëherë ke për t'u çmendur; nëse e kupton, atëherë mund të bëhesh i vetëdijshëm.

Nuk është poenta në atë që ti shkaku i kësaj të jesh i brengosur, sepse ashtu, ti vetëm ke për ta huqur çastin, e atëherë nuk do të mund t'i ndihmosh askujt. Poenta është në atë se ekziston fshehtësia si mund të mbizotërohet rreziku.

E fshehtësia është si në vijim: fillo të jetosh më plotësisht, më tërësisht, më i përgatitur ashtu që në vetvete të mund të gjesh diçka të cilën vdekja nuk do të mund ta arrijë.

Ajo është e vetmja strehimore, e vetmja mbrojtje, e vetmja siguri.

Së këndejmi, shtrohet vetëm një pyetje – si ta përdorim tërësinë, gjithëpërfshirësen? Çfarëdo që ajo të jetë, ta përdorim në mënyrë të drejtë.

Fatkeqësia është e madhe, rreziku është i madh, por edhe momenti i volitshëm është po ashtu i madh.

92

Asnjë mashtrim nuk mund të qëndrojë përballë realitetit. Realiteti do ta shlyejë herët apo vonë.

93

Roli i babait apo i nënës është i madh, sepse ata sjellin mysafirin e ri në botë – i cili nuk di asgjë, por i cili bart disa potenciale në vete. Po qe se potencialet e tij nuk zhvillohen, ai do të bëhet fatkeq; asnjë prind nuk mund as ta mendojë atë që fëmija i tij do të mbetet fatkeq.

Ata ua dëshirojnë fëmijëve të tyre që të jenë të lumtur – dhe pikërisht në këtë pikë të menduarit e tyre është gabim.

Ata mendojnë se – nëse fëmija i tyre do të bëhet mjek, nëse do të bëhet profesor, apo inx-

hinier, apo shkencëtar, atëherë ai do të jetë i lumtur. Por ata s'i kanë as dy lidhje me këtë.

Fëmija i tyre mund të jetë i lumtur vetëm nëse bëhet ai që duhet të bëhet. Ai mund të zhvillohet vetëm ashtu siç është fara që bart në vetvete.

94

Gjykimi është i shëmtuar – ai lëndon njerëzit. Nga njëra anë, ti i lëndon, u shkakton plagë, kurse në anën tjetër e dëshiron dashurinë e tyre, respektin e tyre. Kjo është e pamundur.

Duaji njerëzit, respektoji ndaj dashuria jote dhe respekti yt pa dyshim do të mund t'u ndihmojnë t'i ndryshojnë shumë nga dobësitë e tyre, shumë nga manitë e tyre – sepse ajo dashuri do t'u japë energji të re, mjete të reja, fuqi të re.

Dashuria do t'u japë rrënjë të reja të qëndrojnë kundër frymës së fuqishme, të qëndrojnë përkundër diellit të fortë, rrebesheve të mëdha.

95

Kurdo që në pyetje është zgjedhja, koka nuk guxon të bëjë zgjedhje kundër zemrës.

Zemra jote është në farefisni me ekzistencën, kurse koka jote është në farefisni me bashkësinë shoqërore.

96

Kur je i mërzitur, kjo do të thotë se je në gabim; kur je i gëzuar, kjo do të thotë se s'ke të sharë.

97

Kur të them ji i hareshëm, ji i lumtur, gëzoju faktit që nuk je në situatën të jesh fatkeq dhe i mërzitur, unë kam qëllimin e caktuar tej këtyre.

Qëllimi është në atë që ti të bëhesh shembull për ata njerëz të cilët në tërësi kanë harruar se jeta gjithashtu mund të jetë GËZIM. Përkundër gjithë muzgut ti akoma mund të jesh i pangarkuar me të, akoma mund të vallëzosh. Errësira nuk mund ta pengojë vallëzimin tënd; ajo nuk do ta pengojë fuqinë.

Për mua, kjo është shërbëtore e vërtetë.

98

Mendja do të duhej të mësohej t'i shërbejë mendjes.

Logjika do të duhej t'i shërbente dashurisë.

Vetëm atëherë jeta do të mund të bëhej festival drite.

99

Mësimi i lashtë: "Si lart, ashtu poshtë", apo thënë anasjelltas, përmban njërën nga të vërtetat më fundamentale të misticizmit. Domethënia i kësaj është në atë se nuk ekziston as lart, as poshtë, por se ekziston vetëm një ekzistencë.

Ndarjen e bën mendja.

Ekzistenca është e pandarë.

Ndarja është projeksion yni, dhe ne aq shumë jemi identifikuar me ndarjen saqë e kemi humbur lidhjen me tërësinë.

Mendja jonë është vetëm dritare e vogël që është e hapur kundruall gjithësisë gjigante. Por nëse ti pandërprerë shikon për dritare, korniza e dritares do ta kornizojë qiellin përjashta. E duke qenë se nuk ka kornizë në qiell – ai është i pakornizuar – vështrimi yt i kornizës së dritares do të bëhet kornizë e ekzistencës.

100

Qe një shembull të vërtetë: ndodh ngan-

donjëherë që njerëzit të cilët bartin syze t'i kërkojnë ato, kurse ato u qëndrojnë mbi hundë. Ata madje harrojnë se nuk mund të shohin pa syze, ndaj sillen dhe i kërkojnë, të bindur plotësisht se megjithatë do t'i shohin në ndonjë vend.

Po qe se i përdorë syzet për disa vite, pak nga pak ato bëhen pjesë jotja, ato bëhen sytë e tu. Ti për to nuk mendon si për të ndara nga ti. Kështu çdo lloj syzesh mund t'u japë ngjyrën e vet të veçantë gjërave që shikojnë. Ti je ai vështruesi tej syzeve – ato nuk mund të shikojnë të pavarura. Gjërat e jashtme nuk kanë atë ngjyrë të cilën syzet e kanë futur ndërmjet, por ti ngadalë zë të identifikohesh me syzet e tua...

Mendja e njeriut është po ashtu vetëm një instrument. Syzet qëndrojnë mbi kafkë, derisa mendja ndodhet në kafkë, ndaj nuk mund ta heqësh për çdo ditë. Për këtë bëhesh shumë i afërt me atë përbrenda, ashtu që vjen gjer tek identifikimi.

Për këtë, çfarëdo që mendja të shohë ti mendon se është realiteti. Por mendja nuk mund ta shohë realitetin; mendja mund t'i shohë vetëm paragjykimet e veta. Ajo mund të shohë projeksionet e veta të veçanta të ekspozuara në billbordet e botës.

101

Armiku më i madh i së vërtetës në këtë botë është njeriu i ditur, kurse miku më i madh i së vërtetës është ai që di se nuk di asgjë.

102

Ne kemi qenë të shtrënguar të flasim, mendojmë, veprojmë në këtë mënyrë saqë edhe dukuritë si dashuria ka qenë dashur t'i nënshtrohen mendjes.

Dashuria në esencë i përket zemrës, por e tërë bashkësia jonë provon ta shmangë zemrën, për atë se zemra nuk është logjike, nuk është racionale, kurse mendja jonë nëpërmjet rrugës arsimore është trajnuar se është e keqe krejt ajo që është jologjike, se është e keqe krejt ajo që është irracionale, e se vetëm gjërat logjike janë të mira.

Në programin tonë arsimor nuk ka pasur vend për zemrën, por vetëm për mendjen. Zemra gati se është hedhur nga ekzistenca, është shukatur. Nuk i është dhënë shansi të zhvillohet, të realizohen mundësitë e saj. Kështu që mendja ka mbizotëruar.

Mendja është e mirë kur është në pyetje paraja, kur është në pyetje lufta, mendja është

e mirë kur në pyetje është ambicia, por mendja është plotësisht e padobishme kur në pyetje është dashuria. Paraja, lufta, gjakimi, ambicia – ti nuk mund ta vësh dashurinë në të njëjtën kategori me to.

Dashuria ka burim të veçantë në qenien tënde, aty ku nuk ka konflikte.

103

Arsimimi autentik nuk do ta stërvitë vetëm mendjen tënde – sepse mendja mundet me të ofruar vetëm të ardhura të mira për jetë, por jo edhe jetë të mirë. Zemra, megjithatë, nuk mund të të ofrojë të ardhura të mjaftueshme për jetë, por mund të të japë jetë të mirë; nuk ka nevojë të bëhet përzgjedhje midis këtyre dyjave: shfrytëzo mendjen për atë, kurse zemrën për këtë.

104

Njerëzit religjiozë dhe afaristë, politikanët dhe luftëtarët – të gjithë këta kërkojnë mendje të stërvitur. Zemra mund të jetë e shqetësuar, ajo dëshiron të jetë e shqetësuar.

Nëse je ushtar, dhe ke zemër, ti atëherë nuk do të mund ta vrasësh armikun. Në çastin kur e merr pushkën me qëllimin për të vrarë

dikë, zemra jote ka për të thënë: "Siç ti ke gruan që të pret dhe ke fëmijë, nënë dhe baba – ai njeriu i shkretë po ashtu ka gruan që e pret, ka fëmijën, ka nënën dhe babanë të cilët presin që djali t'iu kthehet në shtëpi."

Ai nuk të ka bërë asgjë të keqe, kurse ti po synon ta vrasësh. Përse? Për të marrë medalje nga akademia ushtarake? Që kjo të festohet?

105

Kur mendon mbi atë se shoqëria mund të bëhet shoqëri ideale, parajsë, kjo të duket e pamundur. Në të ka aq shumë konflikte ndaj duket sikur nuk ka mënyrë që ato të harmonizohen.

Ta harmonizosh bashkësinë njerëzore është e mundur, do të duhej të ishte e mundur, shkaku se bashkësia e tillë do të ishte rasti më i mirë që secili t'i zhvillojë potencialet e veta, rasti më i mirë që secili të jetë i vetvetes. Mundësitë më të mira do të ishin të arritshme për gjithsecilin.

Edhe pse duket se ekziston mënyra e duhur, bashkësia mbetet plotësisht marroqe.

Utopistët nuk janë ëndërrimtarë, por janë të ashtuquajturit realistët tuaj të marrë, të cilët i gjykojnë utopistët. Por edhe të parët, edhe të dytët, pajtohen në pikën e njëjtë – se

diçka duhet bërë me bashkësinë.

Të gjithë këta janë të brengosur me bashkësinë – dhe pikërisht në këtë pikë ndodhet gabimi i tyre.

Siç unë e shoh, utopia nuk është diçka që nuk do të mund të realizohej – ajo është diçka që është e realizueshme, por duhet shkuar gjer tek shkaku, e jo gjer tek simptoma.

Atëherë kemi për ta kuptuar se shkaku është në individin, dhe jo në shoqërinë.

106

Njeriu ka harruar çka ai vërtet është. Ai është bërë gati se i autohipnotizuar me idetë e caktuara mbi vetveten dhe ato ide ai i bart gjatë gjithë jetës së tij, duke mos kuptuar se ato ide nuk janë vetë ai, por se ato janë vetëm hija e tij. E nuk mund t'i japësh kuptim hijes tënde.

107

Nuk ka nevojë për kurrfarë lufte, për kurrfarë beteje, xhelozie, urrejtje. Jeta është aq e shkurtër, kurse dashuria aq e çmueshme. Dhe kurdo që je në mundësi, mbushe jetën tënde me dashuri, me harmoni, me gëzim; kurdo që je në mundësi, bëj nga jeta poezi për veten – madje edhe nëse e huq, vetëm ti je përgjegjës

për këtë, askush tjetër.

Kuptoje vetëm një gjë: nevojitet një kuptim i thjeshtë e që t'i pengosh forcat e errësirës, të negativitetit, destruksionit të të tërheqin teposhtë.

Vetëm pak zgjuarsi nevojitet që t'i përkushtohesh krijimtarisë, dashurisë, përdëllimit - ashtu që nga kjo jetë e imët të bësh gërshetë këngësh – që ajo të jetë vallëzim, kurse vdekja jote të jetë kreshendo e vallëzimit tënd; të jetosh në plotëni dhe të vdesësh në plotëni, pa mërzi, veçse i gëzuar dhe falënderues ekzistencës.

108

Ajo çfarë gjatë një mijë vjetëve të kaluara burri i ka bërë gruas, thënë thjesht, është monstruoze. Ajo nuk ka guxuar të mendojë për veten se është e barabartë me burrin. Dhe ky kushtëzim është mbjellë aq thellë në të saqë madje edhe po i thatë se është e barabartë me ju, ajo nuk do të mund të besojë në këtë. Kjo është rrënjëzuar në mendjen e saj, domethënë, ky kushtëzim është bërë vetë mendja e saj – se ajo është më e ulët në çdo gjë - ashtu si për nga forca fizike, ashtu edhe për nga kualitetet intelektuale.

Kurse burri që e ka sjellë gruan në një gjendje të tillë, ai nuk mund as ta dojë. Dashuria mund të ekzistojë vetëm në barazi,

vetëm në miqësi.

109

Po qe se e kërkon pikëpamjen time të dashurisë... atëherë më nuk do të ketë fjalë mbi dialektikën, mbi kundërshtitë. Mashkulli dhe femra janë të ndryshëm, por edhe komplementarë. Mashkulli është njëra gjysmë, femra tjetra. Vetëm së bashku, në ndjenjën e thellë të njëjtësisë, ata do të bëjnë që për të parën herë ta ndjejnë plotësinë, përsosmërinë.

110

Evolucioni vepron përmes polariteteve. Pikërisht si ti që nuk mund të ecësh vetëm në njërën këmbë, porse të nevojiten dy, ashtu edhe ekzistencës i nevojiten polet e të kundërtave – burri dhe gruaja, jeta dhe vdekja, dashuria dhe urrejtja – për të krijuar vrull; në të kundërtën krejt do të ishte e vdekur.

Nga njëra anë kundërshtia të tërheqë, kurse nga ana tjetër bën që të ndjehesh i varur. Ndërkaq, askush nuk dëshiron të jetë i varur; prandaj, ekziston lufta e pandërprerë në mesin e dashnorëve. Ata provojnë të dominojnë njëra palë mbi tjetrën. Ajo është dashuri vetëm për nga emri, derisa esenca e asaj loje

në të vërtetë është politika.

Mashkulli investon tepër shumë përpjekje në atë që ta nënshtrojë gruan, për ta sjellë në pozitë inferiore, për t'ia pamundësuar zhvillimin që të mbetet vazhdimisht e retarduar.

Çlirimi i gruas nga robërimi do të jetë gjithashtu liri edhe për burrin, që të shijojë diçka të re.

Prandaj unë them se Lëvizja për Çlirimin e Gruas nuk është vetëm liri për gratë, ajo është po ashtu edhe lëvizje për çlirimin e meshkujve: të dy do të jenë të çliruar.

Robëria prangos edhe mashkullin edhe femrën, prandaj ekziston lufta e pandërprerë në mes tyre. Gruaja ka gjetur strategjinë e vet personale e cila bazohet në atë që ta atakojë burrin, që ta mërzisë, që ta pengojë; mashkulli, prapë, ka strategjinë e vet. Dhe në mes të këtyre dy fuqive ndërluftuese ne kemi shpresuar se ka për të ndodhur dashuria. Shekujt kanë kaluar – dashuria nuk ka ndodhur, përveçse ngandonjëherë.

E këtillë është situata në dashuritë e përçdoditshme, të cilat vetëm sa quhen ashtu, por realisht nuk janë ajo.

111

Secili dëshiron të jetë i dashuruar. Por kjo

vetëm sa flet mbi edukatën e gabuar.

E ajo zë fill ashtu që fëmija, fëmija i vogël, nuk guxon të dojë, nuk guxon të thotë asgjë, nuk guxon të bëjë asgjë, nuk guxon të ofrojë asgjë – ai guxon vetëm të fitojë.

Përvoja e dashurisë të fëmijës së vogël është te fitimi – fitim nga nëna, fitim nga babai, fitim nga vëllezërit, motrat, fitim nga mysafirët, të huajt, por përherë është vetëm fitimi. Kjo është përvoja e tij e parë, thellësisht e ngulitur në ndërdijen e tij – se duhet vetëm ta fitojë dashurinë.

Por problemet shfaqen shkaku i asaj se secili prej nesh ka qenë fëmijë, dhe shkaku i asaj se secili ka nevojë të njëjtë për ta fituar dashurinë; e askush nuk ka lindur me kod tjetërfare. Së këndejmi të gjithë kërkojnë: "Na jepni dashuri", e nuk ekziston ai që do ta japë, meqë edhe personat tjerë janë të edukuar në të njëjtën mënyrë.

Prandaj njeriu do duhej të kthjellet dhe të bëhet i vetëdijshëm se një rast, siç është të lindurit, nuk guxon të mbetet gjendje vazhdimisht mbizotëruese e mendjes së tij. Në vend se të kërkojë: "Më jepni dashuri", duhet të fillojë të japë dashuri. Harrojeni fitimin, vetëm jepni dhe unë ju garantoj – keni për të fituar shumë.

112

Nëse mund të duash pa xhelozi, nëse mund të duash pa posesivitet, nëse mund ta duash ndonjë person aq shumë saqë lumturia e tij me qenë edhe lumturia jote – madje edhe po qe se ai, i dashuri yt, ta zëmë, do të ishte i lumtur me ndonjë femër tjetër, kjo edhe ty me të bërë të lumtur, sepse e do aq shumë. Ti do të ishe e lumtur shkaku se ai është i lumtur, dhe ti do t'i ishe falënderuese femrës e cila ka bërë që personi, të cilin ti e do, të jetë e lumtur – e nuk do të ishe xheloze. Vetëm në këtë mënyrë dashuria do të spastrohet.

Dashuria e këtillë nuk mund të krijojë pranga. Ajo thjesht ua hap zemrën të gjitha erërave dhe gjithë qiellit.

113

Xhelozia është fenomen tepër i ndërlikuar. Ajo përmban shumë përbërës në vetvete. Qyqanllëku është njëri prej tyre; egoizmi i dyti; mandej aty është edhe dëshira për monopol – në të cilën nuk ka kurrfarë përvoje të dashurisë por vetëm të posesivitetit; mandej tendenca kah rivaliteti, si dhe frika thellë e rrënjëzuar nga ajo se do të jesh i varur në lidhje.

Aq shumë gjëra janë të përfshira në xhelozi.

114

Rreziku do të duhej të ishte një nga parimet kryesore të njeriut të vërtetë.

Kur sheh se gjërat kanë ngecur, ti shkundi ato.

115

Ti je vetëm turmë, vetëm shumësi. Nëse shikon më sinqerisht, më thellë në vetvete, ke për të parë atje shumë njerëz. Të gjithë ata kohë pas kohe shtiren si ti, të aktrojnë ty. Kur zemërohesh, për shembull, personi i caktuar të posedon dhe të aktron ty. Kur dashuron, po ashtu, personi tjetër të posedon dhe aktron.

Jo vetëm se është rrëmujë në ty, rrëmujë është edhe në secilin prej atyre që vjen në kontakt me ty, sepse nuk do të mund të luajë lojë zaresh. Secili prej tyre atëherë edhe vetë bëhet turmë.

Kështu edhe në çdo lidhje dashurie, martesë nuk lidhin dy persona, veçse dy turma. Nga kjo lind lufta e madhe e cila zhvillohet pandërprerë, shkaku se rrallë ndodh – krejt rastësisht – që, ta zëmë, personit tënd të

dashur, t'i bijë çdo gjë me masë dhe ty çdo gjë me masë. Në gjithë situatat tjera ti dështon. Ty të ka ardhur qejfi për dashuri, por personi yt i dashur është e pikëlluar apo e hidhëruar apo e brengosur. Ndodh dhe anasjelltas, asaj i ka rënë qejfi për dashuri, por ty jo, dhe nuk ekziston mënyra të harmonizosh gjithë ato personalitete, sepse ato sillen e mbështillen sipas trilleve të veta personale.

116

E vetmja vendlindje e vërtetë është ajo që gjejmë në vetvete.

117

Dhënia e dashurisë është përvojë vërtet e mrekullueshme, se ti atëherë je si perandor. Pranimi i dashurisë është përvojë tepër e imët, dhe ajo është përvojë lypsaraku.

Mos u bëj lypsar. Së paku sa i përket dashurisë, ji perandor, se dashuria është kualitet i pashterueshëm në ty; mund të vazhdosh të japësh sa të duash. Mos u frikëso se ajo do të shterojë, se një ditë befas do të kuptosh: "Imzot, më fare nuk kam dashuri për të dhënë".

Dashuria nuk është sasi, ajo është

kualitet, kualitet i llojit të caktuar që rritet me dhënien, dhe vdes po qe se e mban. Nëse je koprrac në dhënie, ajo vdes. Prandaj ji shkapërdar i vërtetë, shpenzues pa masë! Mos u lodh me pyetjen se kujt po i jep. Vetëm mendja koprrace e ka idenë se do t'u "jap personave të caktuar me veti të caktuara".

Ti nuk po e kupton se ke tepër shumë, se je si re shiu. Reja e shiut nuk pyet se kah do ta lëshojë shiun – në shkëmbinj, në kopshtie, oqeane – kjo për të nuk ka rëndësi. Ajo dëshiron të shkarkohet, dhe ajo shkarkesë është lehtësim i madh.

Për këtë, e fshehta e parë është në atë që të mos kërkosh dashuri. Mos prit, duke menduar se ke me dhënë nëse dikush do ta kërkojë – por jepe!

118

Gjëja më themelore të cilën do duhej mbajtur mend është: "kur të ndjehesh mirë, kur je në disponim ekstatik, mos fillo të mendosh se ajo do të jetë gjendje jotja e vazhdueshme.

Jetoje atë moment me gëzim, sa më hareshëm që është e mundur, duke e ditur përsosmërisht mirë se ai ka ardhur dhe se do të shkojë – pikërisht siç puhiza hyn në shtëpinë tënde, me gjithë aromën dhe freskinë

e saj, dhe del në derën tjetër.

Nëse zë të preokupohesh se si çastet e tua ekstatike t'i bësh të vazhdueshme, veç ke filluar t'i shkatërrosh. Kur të vijnë, ji falënderues; kur shkojnë, falënderoju ekzistencës. Qëndro i hapur. Kjo ka për të ndodhur shumë herë. Mos gjyko, mos ji nazeli, qëndro pa zgjedhje.

Po, do të ketë çaste kur do të ndjehesh fatmjerë. E çfarë do të thuash? Ka njerëz që janë të mjerë e të cilët kurrë nuk kanë njohur asnjë çast ekstaze. Ti je i lumtur.

Madje edhe në mjerimin tënd, kujtohu se ai nuk do të jetë i vazhdueshëm; edhe ai do të shkojë. Pikërisht për këtë le të të mos shqetësojë. Qëndro i relaksuar. Mu siç ekziston dita dhe nata, ekzistojnë edhe çastet e gëzimit edhe çastet e pikëllimit. Pranoji si pjesë të dysisë së natyrës, si mënyrë në të cilën bota ekziston.

Kurse ti thjesht je vështrues; ti nuk bëhesh as lumturia as pikëllimi. Lumturia vjen e shkon, pikëllimi vjen e shkon. Një gjë përherë mbetet, përherë e përherë – e ai është vështruesi, ai që dëshmon.

119

Meditimi merret me vetë bërthamën esenciale të qenies tënde, e cila nuk mund të ndahet në mashkullore e femërore.

Vetëdija është thjesht vetëdije.

Pasqyra është pasqyrë – ajo nuk është mashkullore, ajo nuk është femërore, ajo thjesht pasqyron. Vetëdija është mu si pasqyra që pasqyron.

Kurse meditimi i lejon pasqyrës tënde të pasqyrojë, që thjesht ta pasqyrojë mendjen në aksion, trupin në aksion. S'ka rëndësi se a është ai trup mashkull apo femër, nuk është me rëndësi sesi mendja funksionon – emocionalisht apo logjikisht. Sido që të jetë, vetëdija vetëm duhet të kujdeset për to.

Ai kujdes, ajo vetëdije, është meditimi.

120

Ngadalë, ngadalë, gjithnjë e më shumë përqendrohu në vështruesin. Do të vinë ditët e do të vinë netët, do të vinë jetët e do të vinë vdekjet, do të vijë suksesi, do të vijë pasuksesi. Por po qe se je i përqendruar në vështruesin – meqë ky është realiteti i vetëm në ty – të gjitha këto janë fenomene kalimtare.

Së paku për një çast provo ta ndjesh këtë që po flas: thjesht ji vështrues. Mos u lidh për asnjë çast sepse është i bukur dhe mos e hidh asnjë çast sepse është i mjerë. Ndërprite ta bësh këtë. Këtë e ke bërë gjatë shumë jetëve dhe akoma nuk ke pasur sukses në këtë, dhe

kurrë s'do të kesh.

E vetmja mënyrë që t'i tejkalosh të gjitha është të mbetesh në të andejmen e çdo gjëje, të gjesh vendin prej nga mund t'i vështrosh të gjitha këto dukuri të ndryshueshme, e që të mos identifikohesh (me to).

121

Përvoja vjen dhe shkon – mos u mbështet në të. Po qe se nuk e ke zbuluar atë i cili e ndjen gëzimin, i cili e ndjen dhembjen, i cili e ndjen shëndetin, i cili e ndjen pikëllimin, atë i cili është ajo vetëdije...

Do të duhej të jepje krejt nga vetja të zësh vetë qendrën e ciklonit. E tërë qenia jote është ciklon ndryshimi, skena të cilat ndryshojnë, ngjyra të cilat ndryshojnë: por, pikërisht në mesin e këtij cikloni ekziston qendra e qetë. Aty je ti.

122

Kur njëherë identifikohesh me ndonjë ide, ti je i sëmurë.

Çdo identifikim është sëmundje mentale.

Në të vërtetë, mendja është sëmundja jote.

Ta lësh mendjen anash dhe thjesht të shikosh realitetin – pa kurrfarë mendimi, pa

kurrfarë paragjykimi – kjo është mënyrë e shëndoshë për t'u njohur me realitetin. Ashtu do të zbulosh realitet plotësisht të ri.

Zbulimi i dëshirës së vërtetë ka me të liruar nga shumë marrëzi, nga shumë besëtytni. Ajo do ta pastrojë zemrën tënde prej çfarëdo plehu që brezat e kanë hedhur në ty. Sëmundjet barten nga brezi në brez; ti e trashëgon gjithë të kaluarën me të gjitha idetë e saj të marra. Përndryshe, nuk do të ishin ndryshimet, nuk do të ishin krahasimet.

E kur njëherë çlirohesh prej krahasimit, ti je i lehtë, e tërë qenia jote është e lehtë. E humb gjithë rëndesën tënde. Bëhesh aq i lehtë saqë mund t'i hapësh krahët e të fluturosh.

123

Çdo gjë shkon, por ti mbetesh – ti je realiteti. E tëra është vetëm ëndërr: ka ëndrra të mrekullueshme, ka ankthe. Por nuk ka rëndësi se a kemi të bëjmë me ëndërr të bukur apo me ankthin, i rëndësishëm është ai që e sheh atë ëndërr.

Ai vështrues është i vetmi realitet.

Ai vështrues është diçka absolutisht e përjetshme.

Vetëm pak qasje në të dhe gjithë problemet e tua do të fillojnë të zhduken, se do të shfaqet

një perspektivë plotësisht e re, një vizion i ri, një mënyrë e re jetese, një mënyrë e re e shikimit të gjërave, e shikimit të njerëzve, të reaksioneve, të situatave.

E ai vështrues është përherë i pranishëm, njëzet e katër orë në ditë. Çfarëdo të bësh apo të mos bësh, ai është aty. Ka qenë aty me shekuj, gjatë përjetësisë, duke pritur që atë ta vëresh. Ndoshta e ke harruar pikërisht shkaku se përherë ka qenë aty. Është e qartë se ai përherë harrohet – kujtoje.

Kur ndjen mirëqenien, euforinë, kujtoje.

Kur je në mjerim, në mundime, kujtoje.

Në të gjithë nënqiejt, në të gjitha disponimet, vazhdo ta kujtosh. Së frikti do të jesh në gjendje të mbetesh i përqendruar në të, nuk do të ketë nevojë ta kujtosh. E ajo është dita më e madhe në jetën e njeriut.

124

Po të them, nuk ka të keqe dhe nuk ka forca të këqija në botë. Ekzistojnë vetëm njerëzit e vetëdijshëm dhe ekzistojnë njerëzit që thellësisht flenë – kurse gjumi nuk ka fuqi.

E tërë energjia është në duart e njerëzve të zgjuar. Kurse një njeri i zgjuar mund ta zgjojë gjithë botën. Një qiri i ndezur mund të ndezë miliona qirinj, e që dritën e vet të mos e humbas.

125

Hidhërimi e ushqen egon – për këtë shohim aq shumë njerëz të mjerë në botë. Pika e tyre themelore, qendrore është egoja.

126

Për ta kuptuar dashurinë, së pari do të duhej të duash: vetëm atëherë mund ta kuptosh dashurinë.

Miliona njerëz vuajnë; ata dëshirojnë të jenë të dashur, por nuk dinë sesi të duan. Kurse dashuria nuk mund të ekzistojë si monolog; ajo është dialog, një dialog tejet harmonik.

Nuk sjell kënaqësi ajo që njerëzit të japin, kënaqësi sjell ajo që ti u jep njerëzve. Nuk mund të jesh i kënaqur që do të jesh lypsar, por se do të jesh perandor.

Ti mund të japish aq shumë, aq pashterueshëm, saqë sa më shumë që jep, aq më e rafinuar, më e kulturuar, më aromatike bëhet dashuria jote.

127

Atë çast kur e kupton se ç'është dashuria – kur e përjeton se ç'është dashuria – ti bëhesh

dashuri. Atëherë nuk ka nevojë që të jesh i dashur dhe nuk do të ketë detyrime në ty që të duash: dashuri do të jetë ekzistenca jote e thjeshtë, spontane, vetë frymëmarrja jote.

Nuk do të mund të bësh asgjë tjetër, por fare thjesht ke për të dashur.

Tash, po qe se dashuria nuk të vjen si kundërshpërblim, nuk do të ndjehesh i lënduar, thjesht shkaku i asaj se vetëm personi që është bërë dashuri mund të dojë. Mund të japësh vetëm atë që ke.

Ti kërkon prej njerëzve të të duan – prej njerëzve që nuk kanë dashuri në jetën e tyre, të cilët nuk kanë arritur gjer tek burimi i qenies së tyre, ku dashuria ka altarin e vet. E si mund të duan ata? Ata mund të shtiren. Ata mund të thonë se po të duan. Ata madje edhe mund t'i besojnë kësaj. Por, herët apo vonë ka për t'u ditur se ajo është vetëm shtirje, se ajo është vetëm aktrim, se ajo është vetëm hipokrizi.

Ndoshta ata nuk e kanë për qëllim me të mashtruar, por ç'mund të bëjnë? Ti kërkon dashuri, edhe personi tjetër po ashtu e do dashurinë. Që të dytë këtë e kuptoni – se mund të merrni dashuri vetëm kur prej jush pritet që të doni – ndaj që të dytë përpiqeni në çdo mënyrë. Ajo është pozë, por ajo pozë është e zbrazët. Që të dytë keni për ta zbuluar këtë

dhe që të dytë keni për t'iu ankuar njëri-tjetrit se kjo nuk është e drejtë.

Që nga fillimi, kemi pasur të bëjmë me dy lypsarë të cilët lypin njëri prej tjetrit, e që të dytë kanë çinitë e zbrazëta prej lypsari.

128

Egoja është robëria më e madhe, i vetmi ferr për të cilin unë di.

129

Ata të cilët e kanë zbuluar burimin e dashurisë në vetvete, më nuk kanë nevojë që të jenë të dashur – sepse ata do të japin dashuri.

Ata do të duan vetëm shkaku i asaj se dashuri kanë edhe tepër – mu siç reja e shiut dëshiron ta lëshojë shiun, mu siç lulja dëshiron ta lirojë aromën e saj, pa dëshirën që çfarëdo qoftë të fitojë. Shpërblimi për dashurinë është në dhënien e dashurisë, jo në marrjen e dashurisë.

Kurse ekzistojnë edhe misteret e jetës që, po qe se dikush me të drejtë është i shpërblyer me atë që t'i dojë të tjerët, shumë do ta donë atë, sepse, pasi që janë në kontakt me të, ngadalë do të fillojnë ta zbulojnë atë burim në

vete. Tani ata e njohin së paku një person i cili shfaq dashuri e dashuria e të cilit nuk buron prej kurrfarë nevoje. E sa më tepër që ai jep dhe shpërndan pa hesap dashurinë e vet, aq më tepër ajo rritet.

130

Mos mendo mbi të vërtetën si mbi objektin – ajo nuk është objekt. Ajo nuk është atje – ajo është këtu.

131

Mendja funksionon në mënyrën ose-ose; ose kjo mund të jetë e saktë, ose mund të jetë e saktë ajo që është e kundërt. Sa i përket mendjes, logjikës së saj, rracionalitetit të saj, të dyja gjërat nuk mund të jenë të sakta.

Zemra nuk ka logjikë, veçse ndjeshmëri, mirëkuptim. Ajo mund të shohë jo vetëm se ato dy gjëra mund të jenë së bashku, por se, në të vërtetë, ato edhe nuk janë dy. Ajo është vetëm një dukuri, e parë nga dy aspekte të ndryshme.

E po qe se kemi të bëjmë me zgjedhjen midis mendjes dhe zemrës, zemra ka përherë të drejtë, sepse mendja është sajesë e shoqërisë. Ajo ka lindur me arsimimin. Ta ka

dhënë shoqëria, dhe jo ekzistenca.

Zemra është e pandotur.

Zemra është ekzistencë e pastër, ndaj së andejmi ka mirëkuptim.

Shiko nga perspektiva e zemrës, dhe kundërshtitë do të zënë të shkrihen mu si akulli.

132

Po të them: për të qenë një me universin, ti duhet të zhdukesh, dhe e lejon ekzistencën që të jetë. Thjesht duhet të mungosh, që qenia të jetë e pranishme në tërësinë e vet. Por, personi për të cilin them se duhet të zhduket nuk është 'ti' i vërtetë, ai është vetëm personaliteti yt; ajo është vetëm një ide në ty.

Në realitet ti veç je një me ekzistencën. Nuk mund të ekzistosh në kurrfarë mënyre tjetër – ti je ekzistencë.

Por, personaliteti krijon mashtrimin dhe bën që të ndjehesh i ndarë. Ti mund të supozosh se je i ndarë – ekzistenca ta jep lirinë e plotë, madje edhe që të jesh kundër saj. Ti mund të mendosh mbi veten si mbi entitetin e ndarë, egon. E kjo është pengesa që të pengon të shkrihesh me hapësirën që të rrethon në çdo moment.

133

Kur sodit perëndimin e Diellit, së paku për një sekondë ti e harron ndasinë tënde: ti je perëndimi i Diellit. Ai është çasti kur e ndjen bukurinë e tij. Por, atë çast kur thua se ai është perëndim i mrekullueshëm i Diellit, ti më nuk e ndjen; i je kthyer entitetit tënd të veçantë, të mbyllur të egos. Tani mendja flet.

Dhe ky është një nga misteret – se mendja mund të flasë, e nuk di asgjë; kurse zemra i di të gjitha, e nuk mund të flasë. Ndoshta është vështirë të flitet nëse edhe di së tepërmi; e mendja di aq pak, ndaj mund të flasë. Asaj i mjafton gjuha, por zemrës jo.

Por nganjëherë, nën mbresën e çastit të caktuar – natës me yje, daljes së diellit, lules së bukur – së paku për një çast ti harron se je i ndarë. E madje edhe harresa ndaj saj liron bukuri të madhe dhe ekstazë.

134

Në jetë asgjë nuk është e qëndrueshme, asgjë nuk mund të jetë e qëndrueshme. Ti nuk je në mundësi që çfarëdo qoftë të bësh të qëndrueshme. Vetëm gjërat e vdekura mund të jenë të qëndrueshme. Sa më e gjallë që të jetë një gjë, aq më kalimtare është.

Sot është dashuria e pranishme, nesër kushedi; ndoshta do të jetë aty, ndoshta jo. Nuk je në mundësinë që ta kontrollosh. Ajo është ndodhi. Ti nuk mund të bësh asgjë; nuk mund ta krijosh nëse nuk është e pranishme. Ose është e pranishme ose nuk është e pranishme – ti këtu thjesht je i pandihmë.

Guri mund të jetë i qëndrueshëm. Lulja nuk mundet.

E dashuria nuk është gur. Ajo është lule, dhe atë shumë e veçantë.

135

Zemra është tejkalim i dualiteteve. Zemra i sheh gjërat me dashamirësi, kurse dashuria është vetia e saj e natyrshme – jo diçka të cilën do të duhej mësuar. E kjo dashuri nuk e ka urrejtjen si moshatare të veten.

136

Ti mund t'i tejkalosh dualitetet e vetive dashuri – urrejtje.

Në këtë çast, ato në jetën tënde shkojnë dorë për dore. Ti e do të njëjtin person të cilin njëkohësisht edhe e urren, ndaj në mëngjes aty është urrejtja, kurse në mbrëmje dashuria – e kjo shkakton konfuzion të madh. Ti madje

as nuk e kupton se po e dashuron apo urren atë person, meqë i bën që të dyja këto gjëra në mënyrë alternative.

Por, kështu funksionon mendja; ajo funksionon përmes kundërthënieve. Evolucioni gjithashtu vepron rrugës së të kundërtave, por ato të kundërta në ekzistencë nuk janë kundërthënëse, ato plotësohen.

137

Urrejtja po ashtu është një lloj dashurie e cila është e kthyer kokëposhtë.

138

Dashuria që vjen nga mendja është përherë dashuriurrejtje. Ato nuk janë dy fjalë, veçse një fjalë: "dashuriurrejtje" – nuk i ndan madje as vijëza. Kurse dashuria që vjen prej zemrës sate është përmbi të gjitha dualitetet...

Të gjithë gjurmojnë pas kësaj dashurie e cila tejkalon dashurinë dhe urrejtjen – por e kërkojnë me mendjen, prandaj për këtë janë të mjerë. Çdo dashnor e ndjen pasuksesin, mashtrimin, tradhtinë, por kjo nuk është faji i askujt. Në realitet ti përdor instrument të gabueshëm. Kjo është si kur dikush do t'i shfrytëzonte sytë për të dëgjuar muzikë, e pas-

taj të nervozohej pse nuk ka muzikë. Por, sytë nuk janë të dedikuar për dëgjim, mu ashtu siç veshët nuk janë të dedikuar për shikim.

Mendja është shumë afariste, mekanizëm llogaribërës; ajo s'ka të bëjë asgjë me dashurinë.

Dashuria do të ishte kaos, ajo do t'i çrregullonte të gjitha në të. Zemra nuk ka të bëjë asgjë me punën – ajo është përherë në pushim. Ajo mund të dojë, dhe atë të dojë ashtu që dashuria e saj kurrë mos të kthehet në urrejtje; ajo nuk ka helm të urrejtjes.

Të gjithë e kërkojnë dashurinë, por thjesht me instrument të gabuar: prandaj gjithë ky pasukses në botë. Dhe shkallë-shkallë, shkallë-shkallë, pasi shohin se dashuria sjell vetëm mërzi, njerëzit mbyllen: "Dashuria është absurditet i plotë". Ata krijojnë mur të trashë ndaj dashurisë. Por, ata do t'i huqin të gjitha gëzimet e jetës, do të huqin çdo gjë që vlen...

139

Miqësia është dashuria më e pastër.

Ajo është trajta më e lartë e dashurisë – në të cilën asgjë nuk kërkohet, s'ka kushte, ku njeriu thjesht kënaqet duke dhënë. Ai edhe merr shumë; por, kjo është sekondare dhe ndodh vetëm spontanisht.

140

Guximi më i madh është të jetosh pa ardhmëri.

Vetëm qyqet jetojnë në të ardhmen.

E kaluara e njeriut ka qenë tejet qyqare. Ai ka jetuar jo në të tashmen, veçse në të ardhmen: "Krejt çka duhet të ndodhë, do të ndodhë nesër". Dhe kështu njerëzit kanë jetuar dhe kështu kanë vdekur. Ajo që kanë pritur kurrë nuk ka ndodhur: është dëshmuar se ajo është pritje e Godosë.

E tashmja ka mbetur e pahulumtuar, e pajetuar – e ajo është i vetmi realitet që ekziston.

141

Lejo që jeta jote të jetë pikërisht e tillë siç dëshiron të jetë vdekja jote – meqë vdekja nuk është e ndarë nga jeta.

Vdekja nuk është fund i jetës, ajo është vetëm ndryshim.

Jeta vazhdon, ka vazhduar dhe përgjithmonë do të vazhdojë. Por, format janë bërë të papërdorshme, më tepër barrë sesa gëzim: atëherë më mirë është t'i jepet jetës trajtë e re, e freskët.

Vdekja është bekim, e jo mallkim.

142

Metoda më e zakonshme e meditimit është thjesht qëndrimi i vështruesit. Ka njëqind e dymbëdhjetë mënyra meditimi, por të vështruarit është pjesa esenciale e gjithë njëqind e dymbëdhjetë metodave. Prandaj, sa më përket mua, vështrimi është metoda e vetme. Ato njëqind e dymbëdhjetë metoda janë zbatim i ndryshëm i të vështruarit.

Preokupimi esencial, vetë fryma e meditimit, është që të mësosh sesi të vështrosh.

Ti e shikon drurin; ti je këtu, druri është atje, po a nuk mund të kuptosh edhe diçka? – se derisa e shikon drurin, në ty ekziston vështruesi i cili sheh se ti po e shikon drurin.

Bota nuk është e ndarë vetëm në objekt dhe subjekt. Ekziston diçka që i tejkalon – e kjo është meditimi.

143

Të jesh i pastrehë do të thotë të jesh i lirë, ajo është liria. Ajo do të thotë se nuk ka ngujim, nuk je i lidhur me asgjë nga jashtë: domethënë se nuk ke nevojë të marrësh ndonjë ngrohtësi nga jashtë, por se ngrohtësia jote është në ty. Ti e ke burimin e asaj ngrohtësie; më shumë se aq ty nuk të nevojitet. Prandaj,

kurdo që je pa shtëpi, për habi të mrekullueshme, ti je në shtëpi.

144

Njerëzit që kërkojnë shtëpi përherë bien në dëshpërim, dhe në fund do të ndjejnë: "Të mashtruar jemi, jeta na ka mashtruar. Disi na e ka dhënë dëshirën të kërkojmë shtëpi - kurse shtëpi fare nuk ka, ajo thjesht nuk ekziston".

Ne përpiqemi të krijojmë shtëpi në të gjitha mënyrat e mundshme: dikush gjen burrë, dikush gjen grua, lind fëmijë...

Njeriu provon të krijojë familje – domethënë, shtëpi psikologjike.

Njeriu jo vetëm se ndërton shtëpi, por tenton që prej saj të bëjë ndonjë farë qenie të gjallë.

Njeriu provon ta ndërtojë shtëpinë në harmoni me ëndrrat e veta, të cilat do të jenë mbushje me ngrohtësi në këtë ftohtësi...

Kurse ftohtësia e ekzistencës është e madhe. I tërë universi është i ftohtë, aq indiferent, saqë ti dëshiron të krijosh pak strehë për veten në të cilën mund të ndjesh se je i siguruar, se diçka po të mbron, se është ajo diçka që të përket ty, se ti je pronar, e jo bredhëritës i pastrehë.

Por, në realitet kjo ide ka me të sjellë ankth, pasi që një ditë do të zbulosh se je i

huaj në raport me burrin me të cilin ke jetuar, me gruan me të cilën ke jetuar. Madje edhe pasi që të keni mbijetuar së bashku pesëdhjetë vjet, ai tëhuajësim nuk është zhdukur; përkundrazi, ai është zgjuar. Më pak keni qenë të huaj ditën e parë kur jeni takuar.

145

Koha ka kaluar dhe ju keni qenë së bashku, jeni bërë gjithnjë e më tepër të huaj për njëri-tjetrin, sepse gjithnjë e më tepër e më tepër e keni njohur njëri-tjetrin – kurse tash fare nuk e kupton se kush është ai personi tjetër. Sa më tepër që e ke njohur, aq më pak di për të. Duket sikur sa më shumë që e ke njohur dikë, aq më i vetëdijshëm je bërë se padituria jote për të është absolute; nuk ka mënyrë që ta shfuqizosh atë.

Fëmijët e tu – menduar ke se ata janë fëmijët e tu, e një ditë ke për ta zbuluar se ata nuk janë fëmijët e tu. Ti ke qenë vetëm shtegu nëpër të cilin ata kanë ardhur. Ata e kanë jetën e tyre të veçantë - ata janë plotësisht të huaj. Ata nuk të përkasin. Ata do të gjejnë rrugët e veta dhe jetën e vet.

Kush është me ty?

Askush nuk është me askënd.

Ti je përherë në turmë, por vetëm. E është

krejt një se a je vetëm apo në turmë, është krejt një se a je në shtëpi apo thjesht je bredhacak.

146

Për egon, vetmia kurrë nuk është gëzim.

Egoja jeton vetëm kur dikë e nënshtron, kur mund të thotë: "Jam më i lartë se ti, jam më i madh ti".

Egoja kurrë nuk mund të kënaqet në vetmi; e ç'kuptim ka të kesh ego në vetmi?

147

Jeto dhe dashuro, dhe dashuro plotësisht dhe fuqishëm – por kurrë në dëm të lirisë.

Liria duhet të mbetet vlera më e lartë.

148

Gjithmonë na kanë mësuar se dashuria është marrëdhënie, ndaj jemi mësuar me këtë ide. Por kjo nuk është e vërtetë. Ky është lloji më i ulët i dashurisë – tepër e ndotur.

Dashuria është gjendje e qenies.

149

Çdoherë kur njeriu kupton ndonjë pjesë të

së vërtetës, në zemrën e tij diçka zë të luajë. Zemra është i vetmi argument i së vërtetës.

E ajo nuk mund t'i dëshmojë fjalët e vërteta.

Zemra mund të dëshmojë në mënyrën e vet të veçantë: nëpërmjet dashurisë, nëpërmjet lojës, nëpërmjet muzikës – joverbalisht. Ajo flet, por nuk flet me gjuhë dhe me logjikë.

150

Koha është gjithmonë e pasigurt. Kjo është problem me mendjen: mendja do siguri – kurse koha është gjithmonë e pasigurt.

Prandaj, kur mendja në koincidencë të plotë gjen një pjesëz të sigurisë, ajo ndjehet e shtëpisë; e rrethon një lloj qëndrueshmërie iluzore. E prirur është të harrojë natyrën e vërtetë të ekzistencës dhe jetës: ajo zë të jetojë në një lloj bote nga ëndrrat, e cila fillon të marrë dukje të realitetit.

Kjo ia kënda mendjes, se mendja përherë u frikësohet ndryshimeve, nga arsyeja e thjeshtë se nuk di çfarë do të sjellë ndryshimi: mirë apo keq. Një gjë është e sigurt, se ndryshimi ka për të fshirë botën tënde të iluzioneve, pritjeve, ëndrrave. Mendja është mu si fëmija i cili luan në bregun e detit, duke bërë kështjella prej rëre. Një çast duket sikur pallati është i kryer, por është i bërë nga rëra që zhbëhet. Në çdo

rast mjafton një puhi e që ajo të rrënohet të bëhet thërrmija. Por, ne zëmë të jetojmë në atë pallat prej rëre. Zëmë të ndjejmë sikur kemi gjetur diçka që gjithmonë do të mbetet me ne.

Ndërkaq, koha pandërprerë vazhdon ta pengojë mendjen tonë. Kjo duket e vështirë, por ekzistenca në të vërtetë është tejet e mëshirshme, se përherë mbetet me ne. Ajo nuk na lejon që të ndërtojmë realitet nga fanitjet. Ajo nuk na e jep shansin të pranojmë maskat si fytyrë tonën të vërtetë, si fytyrë tonën burimore.

151

Njerëzit mendojnë se ajo që janë të qëndrueshëm në parimet e veta u jep njëfarë fuqie. Mashtrohen. Kjo thjesht ua thith gjithë fuqinë. Ata janë njerëzit më të dobët në botë.

Ata janë si fëmijët e vegjël që janë rritur, e akoma i përdorin pizhamet të cilat janë bërë për ta derisa kanë qenë bebe. Tashmë duken të trashë nga mendja, ndjejnë të njëjtat probleme. Ata vazhdimisht mbajnë pizhamet e tyre se ato iu bien poshtë e më poshtë, kurse njerëzit qeshin me ta.

Jo, duke u rritur, edhe pizhamet e tua do të duhej të rriteshin. Por, pasi që pizhamet nuk po rriten, duhet t'i ndërrosh.

Prandaj unë në këtë nuk shoh kurrfarë problemi. Por, ti mund të shohësh se kjo nuk është situatë vetëm e një personi – miliona njerëz jetojnë në këtë mënyrë. Ata i përmbahen disiplinës, e pastaj bien në vështirësi. Askush nuk ua imponon vështirësitë – ato janë parimet e tyre personale. Po qe se i heqin qafe, ndjehen keq: po qe se u përmbahen, atëherë vuajnë.

Unë po ta mësoj bukur mënyrën joprincipele të jetës, të jetës inteligjente e cila ndryshon me çdo ndryshim rreth teje, po të mësoj të mos kesh ndonjë princip i cili do të pengonte të ndryshoheshe. Ji absolutisht joparimor dhe thjesht pasoje jetën, kështu në jetën tënde nuk do të ketë mërzi.

152

Do të duhej t'i qëronim hesapet me të kaluarën – ajo ka qenë plotësisht e sëmurë. Njeriu ka jetuar jetë tejet të sëmurë, meqë ka krijuar filozofi tepër të sëmurë dhe tepër seriozisht i është përmbajtur asaj.

Do të duhej t'i qëronim hesapet me këtë sëmundje – more sado që duket e nderuar e sado që të jetë e lashtë – dhe përsëri zbulojmë integritetin e njeriut.

E kjo mund të bëhet vetëm kur me respekt

i qasemi joshjes për vallëzim; kur joshja për vallëzim bëhet nderim i thellë; kur ai nderim nuk të shtynë të vdesësh, të heqësh dorë, por të gëzosh, të vallëzosh, të festosh.

153

Jeto si luftëtar, në këtë apo në atë mënyrë, por kurrë me kompromise.

Më mirë është të jesh i mundur, por plotësisht, sesa të fitosh rrugës së kompromisit. Ajo fitore nuk ka me të sjellë asgjë përpos nënçmimit; kurse humbja pa kompromis ka me të sjellë dinjitet.

Jeta është e çuditshme. Këtu fitorja ndonjëherë është e turpshme, e humbja dinjitoze, sepse njeriu nuk dëshiron të bëjë kompromise.

154

Në ndonjë marrëdhënie, të jesh i matur do të thotë se ti mund të mos kesh të drejtë, e se gruaja mund të ketë të drejtë. Çështja se je mashkull s'është garanci se ke fuqi dhe autoritet të kesh të drejtë. E nuk i ka as gruaja.

Sikur të ishim vetëm pak më njerëzor dhe pak më miqësor, njëri-tjetrit do të mund t'i thoshim: "Më fal". E ç'janë ato gjëra për të cilat

lufton? – aq të vogla, aq të parëndësishme, saqë do të turpërohesh nëse ndokush ka me të pyetur në këtë mënyrë.

Thjesht hidhe idenë se çdo gjë duhet të përputhet; hidhe idenë se do të vijë gjer tek harmonia e plotë – se këto nuk janë gjëra të mira. Sikur çdo gjë të përputhej, do t'i mërziteshit njëri-tjetrit. Nëse çdo gjë është harmonike, keni për ta humbur gjithë ëmbëlsinë e marrëdhënies.

Është mirë që gjërat nuk përputhen. Është mirë që përherë ekziston jazi, ashtu që gjithmonë ka diçka të hulumtohet, diçka të kalohet, të ndërtohet ndonjë urë.

Gjithë jetët tona mund të jenë hulumtime të mëdha reciproke po qe se i pranojmë dallimet, veçantinë bazike të çdo individi, dhe po qe se nga dashuria nuk bëjmë ndonjë lloj robërie, veçse miqësi.

155

Mendja mund të funksionojë vetëm me të priturën, vetëm me të diturën. Kur aty ka diçka të papritur, ajo duhet të ndalojë. Kurse ndalimi i mendjes është tingulli i një dore që thurë.

Kjo është heshtja.

156

Kush ka me të mësuar të rrish i qetë? Kjo është gjëja më e vështirë në botë.

Krejt mund t'i bësh fare lehtë, por gjëja më e lehtë – të rrish qetë – duket se është më e vështira.

157

Dashuria duhet të jetë marrëdhënie miqësore në të cilën askush nuk është i mbifuqishëm, në të cilën askush nuk do të mashtrojë, në të cilën të dyja palët janë plotësisht të vetëdijshme se janë të ndryshëm, se qasja e tyre ndaj jetës është e ndryshme, se mendojnë ndryshe, e megjithatë – me gjithë këto dallime – ta duan njëri-tjetrin. Atëherë nuk do të ketë kurrfarë problemesh.

Probleme bëjmë ne.

Mos provo të krijosh diçka mbinjerëzore. Ji krijesë njerëzore dhe pranoje njerëzoren e personit tjetër, me gjithë brishtësinë ndaj së cilës njeriun është i prirur. Ai tjetri do të bëjë gabime pikërisht siç i bën ti – e që të dy duhet të mësoni.

Të jesh së bashku është dituri e madhe – në ndjesë, në mirëkuptimin se ai tjetri është njeri siç je ti. Nevojitet vetëm pak ndjesë...

158

Kur njerëzit flasin, ata dëshirojnë që atë ta kthejnë në mendim të tyre. Kjo është si sprovë për të përhapur një perandori subtile. Kur njerëzit flasin, ata duan të të indoktrinojnë, sepse secili që ka ndonjë doktrinë – thellë në vete frikësohet se a është ajo e vërtetë apo jo.

Mënyra e vetme sipas të cilës mund të ndjejë se ajo është e vërtetë është – nëse mund të indoktrinojnë shumë njerëz dhe në sytë e tyre të shohë bindjen, ndryshimin. Atëherë e kanë më lehtë, meqë llogaria është kjo: "Po qe se kaq shumë njerëz gjejnë kaq shumë ngushëllim në këtë që po ua them unë, duhet gjithsesi që aty të ketë ndonjë të vërtetë".

Njerëzit u flasin të tjerëve që vetë të mund të besojnë në atë që thonë.

159

Mund të ekzistojnë dy lloje miqësish.

Njëra miqësi është ajo ku ti je lypsar: të nevojitet diçka nga tjetri që t'i ndihmojë vetmisë tënde. Personi tjetër është po ashtu lypsar, ai e do të njëjtën gjë prej teje. Dhe natyrisht, dy lypsarë nuk mund t'i ndihmojnë njëri-tjetrit.

Së frikti ata vërejnë se lëmosha prej lypsari

ka dyfishuar apo shumëfishuar nevojat e tyre. Në vend se aty të jetë vetëm një lypsar, tashmë janë dy. E po qe se, për fat të keq, kanë edhe fëmijë, aty është shoqata e lypsarëve që lypin – e askush asgjë nuk ka për të dhënë.

Për këtë të gjithë janë të frustruar dhe të mllefosur dhe të gjithë ndjehen të mashtruar, të manipuluar. E në të vërtetë askush nuk mashtron, askush nuk manipulon, se çfarë ti ke fituar për me mujt me dhanë?

Lloji tjetër i miqësisë, lloji tjetër i dashurisë, ka kualitet krejtësisht tjetërfare. Ajo nuk është nga nevoja; ajo buron prej asaj se ke tepër shumëçka në vetvete që dëshiron ta ndash. Lloji i ri i gëzimit ka hyrë në qenien tënde – gëzimi i dhënies – për të cilin kurrë më parë nuk ke qenë i vetëdijshëm, shkaku se përgjithmonë ke lypur lëmoshë.

Kur u jep të tjerëve, aty nuk kemi të bëjmë me përputhje.

Ti rrjedh me ekzistencën, Ti rrjedh me ndryshimin, sepse nuk ka rëndësi se me kë e ndan. Ai mund të jetë personi i njëjtë edhe nesër, personi i njëjtë i tërë jetës tënde, por mund të jetë edhe ndonjë tjetër – nuk ka rëndësi.

Ajo nuk është kontratë, ajo nuk është martesë; ajo vjen thjeshtë nga plotësia jote të cilën dëshiron ta ndash. Për këtë, kushdo që është në afërsinë tënde, ti ia ndan. Kurse dhë-

nia është gëzim i madh.

160

Njeriu është i lindur si i pastrehë (i pashtëpi) dhe tërë jetën mbetet i pastrehë. Pranimi i kësaj të vërtete sjell transformim të madh. Atëherë më nuk gjurmon pas shtëpisë – sepse shtëpia është diçka atje, larg, diçka që nuk je ti. E të gjithë gjurmojnë pas shtëpisë. Kur ta kuptosh iluzoritetin e shtëpisë, në vend se të gjurmosh pas saj, fillon të gjurmosh pas qenies e cila ka lindur si e pastrehë, fati i së cilës është pastrehësia.

Nuk ka mënyrë që të krijohet shtëpi.

Dhe kjo është e çuditshme: atë çast që e kupton se nuk ka mënyrë që të krijosh shtëpi, shtëpi jotja bëhet e tërë ekzistenca. Atëherë, kudo të jesh, ti je në shtëpi.

161

Në botën e shprehive, e tëra është përsëritje. Në botën e vetëdijes nuk ka përsëritje.

162

Në jetë, krejt çka është e rëndësishme është e pakuptimtë.

163

Asnjë person inteligjent nuk është i interesuar që të dominojë mbi të tjerët.

Ai më parë është i interesuar që ta njohë vetveten. Prandaj, inteligjenca më kualitative e synon misticizmin, kurse ajo skajshmërish mediokre fuqinë. Ajo fuqi mund të jetë laike, politike, mund të jetë me para... mund të përbëhet dhe nga dominimi shpirtëror mbi miliona njerëz – por është impulsi i saj themelor që të dominojë mbi një numër sa më të madh e më të madh njerëzish.

Ai impuls shfaqet shkaku se nuk e njeh vetveten dhe nuk do t'ia dish se nuk e njeh vetveten.

Frikësohesh fort të bëhesh i vetëdijshëm për paditurinë e cila dominon mbi vetë qendrën e qenies sate, dhe prej asaj errësire ikën me ndihmën e këtyre metodave – me lakminë për fuqi, me lakminë për konsideratë, nderim. Kurse njeriu që në vetvete bart errësirë, mund të bëjë çfarëdo qoftë destruktive. Personi i tillë nuk mund të krijojë, meqë kreativiteti vjen nga ajo se je i vetëdijshëm, deri diku i zgjuar, që ke dritë, dashuri. Kreativiteti nuk është i interesuar fare për dominim mbi këdo qoftë – e për çfarë qëllimi? Tjetri është tjetri. As ti nuk dëshiron të dominosh mbi këdo qoftë, as nuk

dëshiron që kushdo qoftë të dominojë mbi ty.

Liria është pikërisht ajo shije që ke kur je së paku paksa i zgjuar.

164

Liria është lulëzimi yt, lotosi yt që hapet në diellin e mëngjesit. E derisa kjo nuk ndodh, nuk mund ta ndjesh kënaqësinë, përmbushjen, qetësinë të cilën njeriu e ndjen kur vjen në shtëpi.

Kurse të gjithë e bartin shtëpinë e vet në vetvete.

Ti nuk është e thënë të shkosh askund; duhet ta ndërpresësh të shkosh që të mund të mbetesh aty ku je, që të mund të mbetesh ai që je.

Thjesht ji. Dhe në atë qetësi të skajshme të qenies, të fshehura janë të gjitha të fshehtat e ekzistencës.

165

Mos kërko shtëpi, se nuk ka.

Kërko vetveten, se dikush i tillë ekziston!

166

Dashuria të ndihmon ta arrish vendin në të cilin besimi është i mundur. Pa dashuri, besi-

mi nuk është i mundur. Dashuria është gati si ura e cila mund të shembet në secilin moment, por megjithatë është urë. Nëse mund ta përdorësh, ajo mundet me të dërguar gjer tek besimi, por pa të nuk mund të vish tek besimi drejtpërdrejt.

Për këtë dashuria është absolute, por vetvetiu nuk është e mjaftueshme. Përdore si mjet: besimi është fundi.

167

Atë moment kur zë të besosh në qëndrimin "le të shkojë", atë çast që pushon së luftuari kundër ekzistencës, nuk duhet brengosur mbi asgjë. Ekzistenca brengoset.

E tërë vështirësia me mendjen njerëzore është në atë se ajo përherë lufton, se provon të notojë lumit përpjetë. Ka arsye pse e bën këtë; vetëm notimi lumit përpjetë e përmbushë egon. Me lëvizjen e thjeshtë nëpër rrjedhën e jetës, pa kurrfarë lufte, duke i lejuar jetës me të dërguar kudo të dëshirojë, egoja jote do zhduket.

Ti do të jesh, do të jesh më tepër sesa je tash – më i vërtetë, më i real – por nuk do të jetë ndjesia "unë". E atëherë do të mund të shohësh se ku po shkon.

Ata të cilët nuk kanë ego mund të shohin madje edhe gjurmët (në ajër) që i lë kur lëvizë.

Mund të shohësh madje edhe gjurmët e këmbëve të zogjve në qiell. Ata nuk lënë kurrfarë gjurmësh. Por, kur mendja pastrohet prej egos, e tërë qenia bëhet pasqyrë aq e pastër saqë madje edhe gjurmët e tilla shihen në të.

Një gjë e di. Ekzistenca nuk ka qëllim, dhe si pjesë e ekzistencës unë nuk mund të kem kurrfarë qëllimi. Atë çast që ke qëllim, ti vetveten e shkëput nga ekzistenca. Atëherë pika e vesës provon të luftojë kundër oqeanit. E panevojshme është ajo vuajtje, e pakuptimtë ajo luftë.

168

Me besimin nënkuptohet krejt çfarë është e bukur në dashuri. "Besim" është ndoshta më e bukura fjalë në gjuhën e njeriut. E besimi është aq shumë afër së vërtetës saqë, nëse është i plotë, atë çast besimi yt personal bëhet e vërteta jote, zbulim, revolucion.

169

Dashuria është e mrekullueshme, por e ndryshueshme. Ajo është e mrekullueshme, por në të nuk mund të mbështetesh. Sot është këtu, nesër nuk është më. Dashuria është më e lëngshme se besimi, më e natyrshme se bes-

imi, por besimi është kualitet më i lartë.

Në fjalorë "besimi" gati se gabimisht është prezantuar; ai do të thotë besim në dikë që është i denjë për besimin; ai më tepër është objekt – sepse dikush është i denjë për besim, ndaj ti po i beson. Kjo nuk është veti jotja; vetia e personit tjetër është ajo prej së cilës varesh ti. E pasi që njerëzit e denjë për besim janë të rrallë, miliona njerëz kanë harruar se ç'është besimi, për të nuk ka gjasë. I nevojshëm është personi i denjë për besim, kurse persona të denjë për besim nuk ka askund.

Askush nuk i beson askujt; prandaj "besimi" është bërë fjalë e thatë, e papërjetuar – fjalë e varfër, pa lëng, pa shije.

Kur e them fjalën "besim", ajo është plotësisht tjetërfare: unë nuk mendoj në atë t'i besosh dikujt që është i denjë për besim. Ai nuk është besim. Ai njeriu është i denjë për besimin, ndaj merita nuk është jotja. Kur them "besim", mendoj në atë që të kesh besim pavarësisht prej njeriut, pavarësisht asaj se a është i denjë për besim apo nuk është. Në të vërtetë, kur nuk është i denjë për besim, atëherë beso... vetëm atëherë, për të parën herë, do të pashë se diçka e re po lind në vetëdijen tënde. E atëherë besimi do të bëhet dukuri tejet e ndritshme, larg më tepër se dashuria, se atij nuk i nevojitet asgjë nga ai tjetri.

170

Vetëm një qenie e pavarur, plotësisht autonome që jeton në liri mund ta arrijë përvojën e së vërtetës.

171

Kur thua: "Të dua", ekziston rrymimi subtil i posesivitetit. Edhe nëse nuk thuhet, nënkuptohet: "Ti tash je pronë imja – askush tjetër nuk duhet të të donjë".

Kur është në pyetje besimi, nuk kemi të bëjmë me posedimin e personit në të cilin ke besim. Përkundrazi, ti thua: "Të lutem, posedomë. Më shkatërro mua si ego. Më ndihmo që të zhdukem dhe të shkrihem në ty ashtu që me ty të mos ketë kurrfarë kundërshtie."

Dashuria është konflikt i përhershëm, luftë.

Dashuria kërkon.

"Të dua" do të thotë: "Ti duhet të më duash mua. Në të vërtetë, të dua vetëm për atë se dua që edhe ti të më duash mua". Kjo është biznes i kulluar: së këndejmi edhe frika – "Nuk duhet të duash askënd tjetër, askush tjetër nuk duhet të të dojë ty, sepse nuk dua që askush të marrë pjesë në dashurinë time, ta ndajë dashurinë time".

Njeriu i pavetëdijshëm vazhdon të mendojë

sikur dashuria të ishte një sasi, pothuajse ekziston sasia e caktuar e dashurisë: "Nëse unë të dua, ti do të duhej të merrje gjithë sasinë. Nëse dua disa njerëz të tjerë, atëherë ajo sasi do të shpërndahet; nuk do ta kesh të tërën".

Prandaj, xhelozi, luftë, fyerje - gjithçka që është e shëmtuar fshihet prapa kësaj fjale të bukur – "dashuri".

Tek besimi nuk vjen në shprehje kurrfarë lufte. Ai në të vërtetë është dorëzim. Kur thua: "Të besoj", kjo do të thotë: "Nga ky çast, lufta ime me ty përmbyllet. Tashmë jam yti".

172

Besimi nuk është garë; prandaj s'ka xhelozi. Ti mund të më besosh mua; miliona njerëz mund të më besojnë. Në të vërtetë, sa më shumë njerëz që më besojnë, ti do të jesh aq më i lumtur. Do të gëzohesh që kaq shumë njerëz më besojnë. Me dashurinë nuk është kështu.

173

Besimi është gjithsesi vlerë më e lartë se dashuria. Tek besimi, dashuria nënkuptohet, por në dashuri besimi nuk nënkuptohet. Kur thua: "Unë të besoj", nënkuptohet se e do.

Por, kur thua se e do, besimi me këtë nuk

ka lidhje. Në të vërtetë, dashuria jote është tejet e dyshimtë, tejet e frikësuar, përherë vigjilente, duke vëzhguar personin që do. Dashnorët gati se janë bërë dedektivë. Ata spiunojnë njëri-tjetrin.

Dashuria është e mrekullueshme nëse shfaqet si pjesë e besimit, sepse besimi nuk mund të ekzistojë pa dashuri.

174

E vërteta është se, kur thua "Të dua", ajo nuk është dorëzim, ajo nuk është gatishmëri për t'u zhdukur. Ajo nuk është gatishmëri për t'u dërguar në hapësirat e panjohura e të pakuptueshme. Kur thua "Të dua", ti mbetesh identik me veten, e në atë njëjtësi ekziston vija e caktuar agresive.

Por, kur thua: "unë po të besoj", ajo është dorëzim i thellë, hapje, ndjeshmëri, shpallje vetvetes dhe universit se: "Madje edhe nëse ai njeri më çon në ferr, për mua ajo është në rregull. Nëse ajo mua më duket si ferr, me siguri se nuk shoh mirë. Ai nuk mund të më dërgojë në ferr".

Kur në pyetje është besimi, gjithmonë të metat do t'i kërkosh në vetvete.

Kur në pyetje është dashuria, gjithmonë të metat do t'i kërkosh tek personi që dashuron.

Kur në pyetje është besimi ti përherë, megjithëqë nuk e thua, kërkon ndjesë: "Unë jam i padituri, unë po fle, i pavetëdijshëm jam. Është e mundur të them diçka gabim, të bëj diçka gabim, ndaj ki mëshirë ndaj meje, ki dhembshuri".

Besimi nënkupton jashtëzakonisht shumë. Ai është thesar i madh.

175

Në udhëtimin e vërtetë të jetës, intuita jote personale është mësuesi yt i vetëm.

176

Në vend që të nxitosh për atë që kërkon, gjurmo pas atij i cili kërkon. E kur e gjen gjurmuesin, befasisht do të kuptosh se e tërë ekzistenca është shtëpia jote; për këtë, kudo që të jesh, ti je tek shtëpia.

Vetëm nëse e gjen vetveten, do të zbulosh se e tërë ekzistenca është shtëpia jote.

177

Bota që quhet: "jep më tepër", është bota e njeriut të zakonshëm.

Bota në të cilën nuk kërkohet më tepër, nuk

kërkohet kurrfarë qëllimi që është para teje, veçse thjesht shikohet çasti në të cilin je dhe në të cilin ndodh zhytja në praninë e vetëdijes tënde - ky është revolucioni i vetëm, dhe religjioni i vetëm, dhe vetëm këtu është devocioni.

178

Kjo jetë e vogël që ke fituar mund të shndërrohet në parajsë.

Vetë kjo tokë është lotosi-parajsë.

179

Kjo tokë është një tërësi unike. Do të duhej të ishim krenarë që ky është planeti ynë në këtë gjithësi të pafundme, ku miliona sisteme diellore kanë miliona e miliona planetë... Planeti ynë është i vetmi që ka zhvilluar jo vetëm jetë, jo vetëm vetëdije, por madje ka prodhuar edhe lulëzën e fundit të vetëdijes tek njerëzit siç janë Gautam Buda, Lao Ce, Tilopi dhe shumë të tjerë.

Do të duhej që të ishim krenarë në planetin Tokë.

180

Kur them se krejt përpos njeriut është e

vërteta e gjallë – oqeani, retë, yjet, gurtë, lulet – se krejt është vetë vërtetësia, asgjë tjetër pos ajo që është, pa maskë, se vetëm njeriu është në gjendje t'i mashtrojë të tjerët, ta mashtrojë veten – duhet ta kemi parasysh se kjo, në të vërtetë, është shansi i tij i madh. Kjo nuk guxon të gjykohet, kjo duhet të lavdërohet, sepse edhe po qe se kaçuba e trëndafilit apo e lotosit do të donin të gënjenin, nuk do të mund ta bënin këtë. E vërteta e tyre nuk është liri; e vërteta e tyre është robëri. Ata nuk mund ta tejkalojnë atë kufizim.

Njeriu ka mandatin, ka privilegjin që të jetë jo i vërtetë. Kjo do të thotë se njeriu e ka lirinë që të zgjedhë. Nëse zgjedh që të jetë i vërtetë, ai nuk e zgjedh robërinë, ai e zgjedh të vërtetën dhe lirinë. Liria është privilegji i tij. Në gjithë ekzistencën, lirinë s'e ka askush tjetër. Por, kur e ke shansin, të pranishme janë edhe rreziqet.

Kur e ke lirinë, mund të devijosh.

Asnjë trëndafil nuk mund të devijojë, asnjë shkëmb nuk mund të devijojë. Ti mund të devijosh: prandaj edhe mund të të përshkojë vetëdija e thellë mbi çdo veprim, mbi çdo mendim, mbi çdo ndjenjë.

Vetëm njeriut i duhet të gjurmojë pas së vërtetës; gjithë të tjerët veç e kanë fituar, por në atë nuk ka lavdi, nuk ka liri. Ti duhet të gjurmosh pas saj dhe ta gjesh; dhe në vetë

këtë kërkim dhe gjetje ti je i lavdishëm, ti je vetë kurora e ekzistencës.

181

Mërzia është vetëm zgjedhje e njëanshme.

Ti zgjedh përvojën e dashurisë, ndjenjën e ekstazës, por me atë se zgjedh, ty të harron një proces natyral. Ti do të rrokesh për ato ndjenja – kurse ato nuk janë të qëndrueshme; ato janë pjesë e rrotës e cila sillet.

Mu si dita e nata: po qe se e zgjedhim ditën, çfarë mund të bëjmë që t'i ikim natës? Nata ka për të rënë. Nata nuk sjell mërzi, por zgjedhja jote e ditës përkundrejt natës sjell mërzi.

Çdo zgjedhje ka gjithsesi për të përfunduar me gjendje mërzie.

Mosekzistimi i zgjedhjes është lumturi.

Kurse mosekzistimi i zgjedhjes është qëndrimi "Lëre të rrjedh".

Kjo do të thotë se vjen dita, se vjen nata, vjen suksesi, vjen mossuksesi, vijnë ditët e lavdisë, vijnë ditët e gjykimit – e pasi që nuk ke zgjedhur asgjë, krejt çfarë vjen është në rregull për ty, ti gjithnjë e ke super.

Ngadalë, ngadalë ke për të parë sesi në ty rritet një distancë: rrethi do të vazhdojë të sillet, por ti nuk je i zënë në të. Për ty nuk ka rëndësi se a është ditë apo natë. Qendra jote

është në ty: ti nuk përputhesh me asgjë tjetër, nuk e krijon qendrën tënde në ndonjë vend tjetër.

E tërë çështja është në atë se a mund të jetosh pa kurrfarë zgjedhjeje. Çfarëdo që vjen, kënaqu në të. Kur të shkojë, e pastaj vjen diçka tjetër, prapë kënaqu në të. Dita është e mrekullueshme, por nata është e mrekullueshme në mënyrën e vet – pse të mos kënaqesh në të dyja? E mund të kënaqesh me të dyja vetëm nëse nuk je i lidhur me asnjërën prej tyre.

182

Prandaj vetëm personi që nuk bën zgjedhje, në plotësi shtrydhë lëngun e jetës. Ai kurrë nuk është i mjerë. Çfarëdo që të ndodhë, ai gjen mënyrë të kënaqet në të.

Dhe në këtë është i tërë arti i jetës – të gjesh mënyrë të kënaqesh në të. Por, duhet të mbash mend kushtin themelor: mos zgjidh. Mund të mos zgjedhësh vetëm nëse do të jesh i zgjuar, i kujdesshëm; përndryshe do të lëshohesh në ndonjë zgjedhje.

Jeta gjithsesi është art, arti më i madh – kurse formula e tij më e shkurtër është vetëdija pa zgjedhje, e cila mund të zbatohet në të gjitha situatat, në të gjitha problemet.

183

Kur njëherë e pranon jetën në tërësinë e vet - jeta e përfshin edhe vdekjen – vdekja atëherë nuk është kundërvënie jetës, por është vetëm shërbëtor i saj, mu siç është i tillë edhe gjumi. Jeta jote është e përjetshme – ajo do të jetë këtu përgjithmonë dhe përgjithmonë – por trupi nuk është i përjetshëm; ai duhet të ndryshohet. Ai plaket, e atëherë është më mirë të kesh trup të ri, trajtë të re, sesa që pas vetes ta bartim të vjetrin.

Për mua, njeriu që kupton, nuk do të ketë kurrfarë problemesh. Përndryshe vetëm qartësi shikimit - dhe problemet zhdavariten. Qetësia e madhe ka mbetur në prapavijë, qetësia e bukurisë së madhe dhe e bekimit të madh.

184

E vërteta lëndon më së tepërmi.

185

Dituria e huazuar është padituri.

Përvoja e së vërtetës nuk të bën të ditur, veçse modest. Sa më tepër që e di (të vërtetën), aq më pak shpall se e di. Atë ditë që të vërtetën përsosmërisht ke për ta ditur, do të thuash:

"Unë jam skajshmërish i paditur. Unë jam vetëm fëmijë që mbledh guaca në plazh. Nuk di asgjë".

"Nuk di" mund të thotë vetëm njeriu që përsosmërisht di.

Njerëzit që thonë: "Ne dimë" janë skajshmërish të paditur, kurse memorien e kanë plot. Por, ato kujtesa janë të vdekura, sepse nuk kanë prodhuar kurrfarë përvoje të tyren.

186

Për mua, të jesh i natyrshëm do të thotë të jesh shpirtëror. Unë investoj përpjekje ta krijoj njeriun natyral – njeriun pa faj, i cili i pranon të gjitha dobësitë, mossukseset të cilave iu nënshtrohet qenia njerëzore.

Në atë pranim të thellë të qenies tënde natyrale gjendet fara e transformimit tënd.

187

Ne i kemi mbushur jetët tona me gjëra tokësore, vepra tokësore, sepse nuk e njohim të fshehtën e thjeshtë sesi ta transformojmë kualitetin e çdo gjëje që bëjmë.

Dhe mbaje në mend, nëse nuk e di të fshehtën e transformimit, midis atyre gjërash tokësore edhe ti je tokësor – përveç nëse ke vetëdi-

je e cila të bën të përkushtuar dhe të shenjtë dhe e cila çdo gjë që bën do ta transformojë në të njëjtën gjendje në të cilën je ti.

Atëherë gjithçka që prek do të bëhet e shenjtë.

Çfarëdo që bën, do të bëhet e përkushtuar.

188

Krejt çka është bukur, krejt çka ta përkujton të andejmen, do të krijojë në ty gjakim, gjakimin për të cilin nuk do të mund të kuptosh se përse është. Ti nuk e di objektin e tij, sepse në të vërtetë, ai nuk ka lidhje me kurrfarë objekti.

Kur dëgjon muzikë të bukur, sodit perëndimin e Diellit apo thjesht zogun në fluturim apo trëndafilat e mrekullueshëm, apo gjersa rri në qetësi, mund të ndjesh ndonjë dhembje të ëmbël.

Gjakon që të tretesh në atë gjendje ndjenjash, që ajo të mos mbetet dukuri kalimtare e cila vjen dhe shkon, por diçka që mbetet me ty, që mbetet vetë ti.

Po ajo muzikë që dje ka qenë e ëmbël, sot ndoshta nuk do të jetë e ëmbël, nesër a pasnesër ndoshta do të bëhet e mërzitshme. Prandaj nuk është në pyetje muzika, veçse diçka tjetër që është vu në lëvizje në ty – gjaki-

mi për të qenë përplot qetësi, për të qenë muzikal, për ta pasur gjithë bukurinë e ekzistencës dhe për ta pasur përgjithmonë.

Ky është gjakim shpirtëror, gjakim për të andejmen, për anën tjetër tej të gjitha përvojave kalimtare; gjakim për t'u ndalur koha dhe për të qenë tash dhe këtu, përjetësisht në këtë moment.

Kjo është religjiozitet i vërtetë.

189

Kur e ndjen ekzistencën drejtpërsëdrejti – pa kurrfarë ndërmjetësuesi, pa mendjen të cilën dikush tjetër ta ka dhënë – ti shijon diçka që ka me të transformuar, që ka me të përndritur, zgjuar, që ka me të përcjellë gjer tek maja më e lartë e vetëdijes.

Përmbushje më të madhe nuk ka. Më tepër kënaqësi nuk ka. Relaksim më të thellë nuk ka. Ke ardhur në shtëpi.

Jeta bëhet gëzim, këngë, vallëzim, shenjtëri – dhe atë jetë unë e quaj religjioze.

190

Nevojitet njeriu që është i edukuar pa kurrfarë sistemi religjioz të besimit, pa kurrfarë ideologjie politike. Arsimimi i tij do të ishte

vetëm mprehje e inteligjencës, që një ditë të mund ta gjejë të vërtetën personale.

Dhe mbaje në mend, po qe se e vërteta nuk është e jotja personale, ajo nuk është e vërtetë. Për të qenë e vërtetë, ajo duhet të jetë jotja personale, përvojë jotja – nuk mund ta huazosh prej tjetrit.

191

Zoti mund të vdesë, religjionet mund të zhduken, por religjioziteti është diçka që është thurur në vetë ekzistencën. Ai është bukuria e perëndimit Diellor, ai është bukuria e zogut krahëhapur. Ai është bukuria e lotosit që mugullon. Ai ka krejt çfarë është e vërtetë, krejt çfarë është e sinqertë dhe burimore, krejt çfarë është plot dashuri dhe përdëllim.

Religjioziteti përmban krejt çfarë të ngrit përpjetë, që bën që të mos ndalesh aty ku je, veçse përherë ta përkujton se duhet të shkosh edhe shumë më larg. Çdo vend që ndalesh për të pushuar është vetëm pushim për të bujtur; në mëngjes përsëri e vazhdon pelegrinazhin. E ky është pelegrinazh i amshuar.

192

Do të dëshiroja që të gjithë të bëheshin

Ciganët e ekzistencës.

Nuk të nevojitet rrënja – ti nuk je lis.

Ti je qenie njerëzore.

193

Natyra nuk është agoni, ajo është lumturi. Ajo nuk është sëkëlldi, mërzi, vuajtje. Ajo është dashuri, ajo është gëzim. Ajo është përherë kremtim.

Kemi lindur nga natyra, jemi pjesë e saj – trashëgojmë të njëjtat veti në vetëdijen tonë.

194

Besim thjesht do të thotë se jemi në harmoni me gjithçka që ndodh. Jo të pagëzuar, jo si të shkretë – atëherë e kemi huqur poentën – por me qejfin më të madh për vallëzim, me këngë, me hare, me dashuri.

Çfarëdo që të ndodhë, është për qëllime të mira. Ekzistenca nuk mund të kthehet mbrapsht. Nëse nuk na i plotëson dëshirat tona, kjo thjesht do të thotë se dëshirat tona kanë qenë të gabuara.

195

Nevoja më e madhe e njeriut është që për të

- të kenë nevojë të tjerët. Nëse për ty ka nevojë dikush, ndjehesh i shpërblyer. Por, nëse për ty ka nevojë mbarë ekzistencës, atëherë lumturia jote nuk njeh kufij. E kjo ekzistencë ka nevojë si për yllin më të madh, ashtu edhe për fijen e vogël të barit: këtu nuk bëhet fjalë mbi pabarazinë.

Askush nuk mundet me të zëvendësuar. Nëse nuk je këtu, ekzistenca do të jetë jo e plotë dhe përherë do të mbetet jo e plotë – kurrë nuk ka për të qenë e plotë. Kjo ndjesi – se i nevojitesh kësaj tërësie, ekzistencës gjigante – i eliminon të gjitha mërzitë e tua.

Për herë të parë ti ke ardhur në shtëpi.

196

Përmes njerëzimit evolucioni provon të mbërrijë majën më të lartë të vetëdijes. Pak njerëz e kanë mbërritur: ata janë argument i mjaftueshëm se secili mund ta mbërrijë – vetëm pak angazhim, vetëm pak sinqeritet, vetëm pak hulumtim.

Gjithçka po të flet se mënyra në të cilën po jeton nuk është e mjaftueshme, se gjërat që po i bën nuk janë e tëra: se jeta jote tokësore është vetëm sipërfaqësore – jeta jote e vërtetë, në numrin më të madh të rasteve, mbetet e paprekur. Njerëzit linden, jetojnë dhe vdesin, e

duke mos e ditur se kush janë.

E tërë ekzistenca është e qetë. Nëse edhe ti mund të jesh i qetë, ke për ta ditur se cila është ajo vetëdije në ty. E kur këtë e di, jeta bëhet gëzim, hare e pandërprerë, kremte drite e cila nuk ka të sosur kurrë.

197

Ekziston vetëm një lutje e vërtetë, e kjo është të jetosh ashtu që të fillosh të ndjesh falënderimin kundrejt ekzistencës. Ekzistenca të ka dhënë shansin e madh – të cilin kurrë nuk e ke kërkuar, të cilin kurrë nuk e ke merituar, e megjithatë e ke fituar. Duke iu falënderuar kësaj ti ke lulëzuar në mijëra lule dhe ke lënë aromën e shenjtë të falënderimit.

198

Vepro më vetëdijshëm dhe gjithnjë e më shumë i afrohesh vetisë që quhet njeriu hyjnor - jo Zot, jo ndonjë person, veçse veti e hyjnisë.

Vepro pavetëdijshëm dhe gjithnjë e më tepër do t'i afrohesh diçkaje që nuk mund të personifikohet si djall, veçse mund të quhet veti e – ligësisë.

Njeriu i pavetëdijshëm sillet në mënyra të gabueshme, njeriu i vetëdijshëm sillet në

mënyrat e duhura.

Kurse religjioni i vetëm që ekziston është arti i shndërrimit të mendjes së pavetëdijshme në të vetëdijshmen, ashtu që të mos e kesh dysinë e së vetëdijshmes dhe së pavetëdijshmes, por e ke vetëm një – dritën e pastër, vetëdijen e pastër.

E me vetëdije të tillë, çdo gjë është hyjnore.

199

Përherë ji i gatshëm që të lëvizësh nga e njohura kah e panjohura – në të gjitha, në çdo përvojë.

Kjo është më mirë madje edhe nëse e panjohura tregohet më e keqe se e njohura – nuk është poenta aty. I rëndësishëm është vetëm ndryshimi yt prej së njohurës në të panjohurën, gatishmëria jote që të kalosh prej asaj që njeh në të panjohurën. Kjo është me vlerë tepër të madhe.

Përherë kije në mendje se e reja është më e mirë se e vjetra.

Unë them, madje edhe po qe se e vjetra është e artë, harroje. Zgjidhe të renë – se a është e artë apo jo, kjo s'ka rëndësi. E rëndësishme është zgjedhja jote; zgjedhja jote të mësosh, zgjedhja jote të përjetosh, zgjedhja jote t'i rashë errësirës.

200

Meditimi është përgjigjja e vetme në të gjitha pyetjet e njeriut. Ndoshta është në pyetje frustrimi, ndoshta është në pyetje depresioni, ndoshta vuajtja, ndoshta marrëzia, ndoshta agonia; probleme mund të ketë shumë, por përgjigjja është një.

Meditimi është zgjidhja.

201

Gjithkund në botë kanë provuar të bëjnë shoqëri njerëzore harmonike, por askush nuk ia ka dalë kësaj, nga arsyeja e thjeshtë se askush nuk ka shtruar pyetjen se përse ajo për nga natyra nuk është harmonike.

Ajo nuk është harmonike shkaku se secili individ përbrenda është i ndarë, kurse ndasitë e tij projektohen në shoqëri. Dhe derisa nuk i shthurim ato ndasi të brendshme të individit, nuk ka gjasa që vërtet ta realizojmë utopinë dhe të krijojmë shoqëri harmonike në botë.

Prandaj rruga e vetme kah utopia është që vetëdijesimi yt të rritet edhe më tepër, kurse jo-vetëdijesimi yt të zvogëlohet, ashtu që në fund të vijë momenti që të mos mbetet asgjë që është e pavetëdijshme: ti atëherë je thjesht një vetëdije. Atëherë më nuk ka ndasi.

202

Natyrisht, në botë nevojitet veprimi, e jo mosveprimi. Për të arritur çfarëdo suksesi, i nevojshëm është veprimi, e jo mosveprimi. Për të gjitha ambiciet i nevojshëm është veprimi. Prandaj gjithë bota shpejt është përqendruar në aktivitet.

Por, pjesa aktive do të krijojë tension; ajo do të krijojë agoni, vuajtje. Madje edhe po e arrite qëllimin tënd, ke për të parë se nuk ke mbërritur asgjë – thjesht e ke harxhuar kohën tënde dhe energjinë tënde.

Pjesa aktive e mendjes tënde nuk mundet me të lejuar që të jesh në gjendje qetësie, relaksimi, të jesh në paqe, në shtëpi. Për mendjen aktive kjo nuk është e mundur.

Mendja jovepruese është ajo që mundet me ta dhënë shtëpinë në të cilën do të pushosh dhe ndjenjën e mrekullueshme se asgjë nuk është e thënë të bëhet; se je mirë ashtu siç je, se je veç në cak, se nuk duhet madje as të luash vendit.

203

Bota mund të vijë tek harmonia po qe se meditimi përhapet kudo dhe njerëzit bihen tek gjendja e vetëdijes unike. Ky do të ishte dimen-

sion plotësisht i ri i punës.

Deri tash ky ka qenë evolucioni. Poentë ka qenë shoqëria, struktura e saj. Kjo gjithnjë rishtas në mënyra të ndryshme ka përjetuar mossuksese. Tani ky do të duhej të ishte individi; dhe jo evolucioni, por meditimi, transformimi.

E kjo nuk është gjithaq vështirë sa njerëzit mendojnë. Kjo është vetëm çështje mirëkuptimi e vlerave të meditimit.

Atëherë është lehtë e mundur që miliona njerëz të heqin ndarjen përbrenda vetes. Ata do të jenë grupi i parë në kuadrin e njerëzimit që do të bëhen harmonikë. Kurse harmonia e tyre, bukuria e tyre, përdëllimi i tyre, dashuria e tyre – të gjitha vetitë e tyre – në mënyrë të pashmangshme do të oshtijnë nëpër botë.

204

Njerëzimi është në rrezik në çdo çast. Po qe se mbijetojmë gjer në fund të këtij shekulli, kjo do ishte çudi.

205

Kjo është diçka themelore të cilën do të duhej kuptuar - se e vërteta mund të jetë vetëm përvojë jotja personale. Nuk ka mënyrë

tjetër ta fitosh.

Gënjeshtra mund të fitosh me bollëk – gjithfarë gënjeshtrash, të të gjitha trajtave dhe madhësive, çfarëdo që i dëshiron. Ato janë në dispozicion dhe të përgjigjen. Ti nuk është e thënë të harmonizohesh me to, ato i ke tamam. Kjo është tepër lehtë; ato janë të bëra për ty, ato janë të sajuara për ty.

E vërteta është gjë krejtësisht tjetërfare.

Ti duhet të përputhesh në të. E vërteta nuk di për kompromise. Ti duhet të ndryshohesh në harmoni me të – ti duhet të përjetosh transformim.

206

Njeriu me mendjen religjioze ka për të qenë religjioz në të gjitha veprimet e veta, në të gjitha marrëdhëniet, mendimet, ndjenjat. Atij nuk i duhet kisha apo sinagoga apo tempulli. I nevojitet qartësia e vizionit, qetësia e zemrës, përvoja e qenies së tij personale – pasi që përvoja e qenies së tij ka për ta bërë të vetëdijshëm për atë se e tërë bota është hyjnore; se gjithçka që ekziston është e ndarë në nivele të ndryshme të evolucionit, por se edhe në atë më të ulëtin ekziston potenciali i jetës dhe potenciali i vetëdijes.

207

Mendja nuk di për tri kohët e foljes. Ajo di vetëm për dy: të kaluarën dhe të ardhmen. E tashmja për mendjen është joekzistuese. Ajo që ekziston është joekzistuese për mendjen; kurse ajo që nuk ekziston, për mendjen është ekzistuese.

Së këndejmi i tërë angazhimi përbëhet prej asaj se si të dalim nga mendja, të dalim prej asaj që nuk ekziston dhe të ndalemi në mes – aty ku është ekzistenca.

Si të jemi në të tashmen? – këtu është e gjithë shkathtësia e meditimit. Në çastin kur do jesh në të tashmen, përndritja është nusprodukt i tij.

208

Të gjitha artet kanë buruar prej meditimit; dhe të gjitha artet janë larguar prej meditimit – e kjo është fatkeqësia. Përndryshe çdo artist, more me çfarëdo arti specifik që do të merret, do të duhej të gjente rrugën kah meditimi. Por, duket sikur kjo nuk është kështu.

Përkundrazi, numri më i madh i artistëve bashkëkohorë, muzikantëve, valltarëve, poetëve, piktorëve, skulptorëve, në vend se të vënë dorë mbi meditimin, përfundojnë në çmenduri

– kjo është skajshmëria tjetër e meditimit. E arsyeja e kësaj është se në artin burimor kanë qenë të rëndësishme pauzat, e jo fjalët. Por, siç koha ka kaluar, fjalët janë bërë më të rëndësishme se pauzat.

209

Asnjë njeri që ka qenë meditativ nuk ka bërë kurrë vetëvrasje, kurrë nuk është çmendur, nga arsyeja e thjeshtë se ai lëvizë kah baraspesha më e madhe, kah harmonia e brendshme më e madhe, dhe më në fund, kah harmonia absolute – kjo është harmonia e jo-mendjes.

E ta mbërrish jo-mendjen do të thotë t'i arrish të gjitha.

Nuk ka asgjë më të lartë se kjo, sepse kjo është paqja, kjo është qetësia, kjo është lumturia.

Jo-mendja është devotshmëri, ajo është pavdekësi, ajo është amshim.

210

Psikologjia perëndimore akoma sorollatet rreth rrënjës. Ajo madje as nuk i ka çikur gjethet, lulet, frutat. Nuk bëhet as fjalë që ajo të kalojë në jo-mendje; ajo nuk ka qenë në gjendje madje as ta vërë re gjithë mendjen. Kurse pa

njohjen e gjithë mendjes, nuk mund të kërceni në jo-mendje.

Jo-mendja është realizim.

Jo-mendja është përndritje.

Jo-mendja është çlirim.

211

Shkencëtarët kurrë nuk do të jenë në gjendje t'i kuptojnë thellësitë e pafundme, errësirën dhe pjesët misterioze të mendjeve të tyre personale.

212

Nëse ekziston vetëm një shkencë, atëherë mund të ekzistojë edhe vetëm një religjion. Nëse një shkencë është e mjaftueshme të hulumtojë botën objektive, një religjion është i mjaftueshëm të hulumtojë botën e brendshme të njeriut; e ai religjion i vetëm nuk është e thënë të ketë kurrfarë përcaktori – i krishterë, hinduist, taoist, apo cilido qoftë tjetër.

Mu siç shkenca thjesht është shkencë, religjioni thjesht është religjion.

Në të vërtetë, për mua, ekziston vetëm shkenca, me dy dimensionet: njëri dimension punon në botën e jashtme, dimensioni tjetër punon në të brendshmin. Mundemi madje

edhe të lirohemi nga fjala "religjion".

Është rregull themelore e shkencës se do të duhej shfrytëzuar minimumin e hipotezave. Prandaj, pse t'i përdorim dy fjalë? – e mjaftueshme është vetëm njëra. E "shkencë" është fjalë e mrekullueshme; ajo do të thotë "të njohësh".

Të njohësh të tjerët është njëri aspekt: të njohësh unin tënd është aspekti i dytë: por shprehja "të njohësh" i mbulon që të dyja.

213

Po qe se je i gatshëm të hapësh dyer të reja në qenien tënde, po qe se je i gatshëm ta dëgjosh zemrën, atëherë çdo gjë që them është aq e rëndomtë saqë nuk ka nevojë të besosh në të, thjesht shkaku se nuk ka mënyrë që në të të mos besosh. Kjo është aq e thjeshtë saqë nuk ka mënyrë që të dyshosh në të.

Prandaj jam kundër të besuarit, thjeshtë shkaku se nuk është i nevojshëm besimi për krejt mësimet e mia. Jam plotësisht për dyshimin, sepse në mësimet e mia të thjeshta nuk mund të dyshosh.

214

Kushtëzimet tona nuk na lejojnë të jemi të

natyrshëm. Kushtëzimet tona ne, që nga vetë fillimi, na mësojnë se duhet të jemi diçka më lart se natyra, se të jesh i natyrshëm do të thotë të jesh shtazë - ndaj nga kjo arsye, ne duhet të jemi mbinatyror.

Dhe kjo duket mjaft logjike. Të gjitha religjionet na e kanë mësuar këtë – se të jesh njeri do të thotë të ngrihesh përmbi natyrën. Dhe ato gjatë shekujve e kanë bindur njerëzimin që të ngrihet mbi natyrën.

Askush nuk ia ka dalë që të ngrihet mbi natyrën. Të gjithë që këtë e arrijnë, e asgjësojnë bukurinë e tyre natyrale, të pafajshme, pafajësinë e tyre.

215

Kur një person i rritur përsëri bëhet fëmijë... ekziston dallimi midis fëmijës së zakonshëm dhe përsëri të lindurit. Rëndom fëmija është i pafajshëm shkaku se është i paditur; kurse pafajësia rishtas e lindur është nga vlerta më të mëdha të jetës, sepse ajo nuk është padituri, ajo është inteligjencë e kulluar.

Pafajësia, kur është vetëm, bëhet padituri.

Inteligjenca, kur është vetëm, bëhet dinakëri.

Që të dyja së bashku nuk janë as padituri as dinakëri, veçse thjesht ndjeshmëri, çiltër-

si... zemra atëherë është e aftë t'i çuditet edhe gjësë më të imët në jetë.

Kurse njeriu që di për ndjenjën e çudisë për mua është njeriu i vetëm religjioz. Përmes çudisë ai e kupton se ekzistenca nuk është vetëm materie, se kështu nuk mund as të jetë. Për të kjo nuk është ndonjë konstatim logjik, nuk është besim, veçse përvojë e vërtetë. Një përvojë e tillë e mrekullueshme, aq misterioze, aq e paarritshme – tregon se në të ekziston një inteligjencë e hatashme.

Por, ekzistenca nuk është dinake. Ajo është tepër e thjeshtë, ajo është e pafajësi.

Prandaj, po qe se njeriu i ruan këto dy veti së bashku – pafajësinë dhe inteligjencën – nuk i nevojitet asgjë tjetër. Ato do ta dërgojnë tek caku i fundit i vetënjohjes.

216

Do të doja të të thosha se vetëm një gjë vendos se kush është mësues i vërtetë, e kjo është se prania e tij mundet që befasisht të ngjallë mendjen tënde të fjetur; ajo mund ta ndezë atë. Ajo mund të bëjë që të lulëzosh në mijëra lule, në një çast të vetëm. Ai çast bëhet aq intensiv saqë gati është i barabartë me amshimin. Kjo është mënyra e vetme të kuptosh – çdo gjë tjetër është e parëndësishme.

217

Mendja i sheh gjërat bardh-zi – në mes nuk ka asgjë. Dita dhe nata, asgjë në mes. Dashuria dhe urrejtja, asgjë në mes.

Mendja thjesht ndan në dysh, përgjysmon, pret ndonjë gjë në dy realitete të ndara, të kundërvëna, i bën aq të kundërta, saqë duket se nuk është e mundur të ekzistojë ndonjë mënyrë në të cilën ato nuk do të ishin të ndara, në të cilën do të ishin një realitet i vetëm.

Mendja ka marrë vetëm dy skajet e një realiteti. Kjo që thuhet në vijim e provon këtë. Logjikisht, dashuria dhe urrejtja janë kundërshti, kundërthënie, por kjo në esencë nuk është e saktë. Dashuria lehtë mund të kalojë në urrejtje pa kurrfarë pengese. Urrejtja mund të kalojë në dashuri mu siç tallazet hyjnë në tallazet tjera pa kurrfarë pengese.

Është parafytyrim yni se drita dhe errësira janë dy realitete kundërthënëse. Kjo nuk është e vërtetë. Nuk ka kundërshti. Më së tepërmi që mund të themi është se drita është më pak e errët, kurse errësira më pak e ndritshme. Por, duhet të shfrytëzojmë diçka që e bën dallimin vetëm në shkallë, e nuk krijon kurrfarë kundërthënieje.

Për çdo ditë shohim sesi jeta kalon në vdek-

je aq qetësisht, aq heshturazi, pa kurrfarë pipëtime. Nuk mund ta dëgjosh madje as çapëritjen e hapave të vdekjes. Aty nuk mund të ketë kurrfarë kundërthëniesh. E ata që dinë, e dinë anën tjetër – se vdekja që vjen shndërrohet në trajta tjera jete. Të gjitha dallimet i ka bërë njeriu. Ekzistenca është pa dallime.

Kur zëmë të mendojmë mbi padallimësinë, mbi një realitet të vetëm – duke mos e ndarë atë në dualitete, dikotomi – kryqi zhduket nga mendja jonë. Askush nuk të ka kryqëzuar; vetë je përgjegjës, shkaku se mund ta heqësh kryqin nga vetja dhe gjithë mendja jote mund të bëhet unitet.

218

Mendimet janë surrogate të vetëdijesimit.

219

Kjo është diçka që duhej mbajtur mend – kurdo që përjeton diçka për të cilën nuk ekziston kundërshtia, ke ardhur në shtëpi.

Derisa ekzistojnë kundërshtitë, gjithmonë do të jesh i plasaritur. Do të jesh vetëm top futbolli në mes të atyre dy përvojave – ngandonjëherë duke u ndier i lumtur, ngandonjëherë i mërzitur, por kurrë nuk ke për ta ditur

se ekziston diçka që është përmbi edhe të bukurën edhe depresiven. Prandaj kjo nuk mund të shprehet me fjalë, sepse të gjitha fjalët janë dyfytyrëshe: përndryshe nuk do të kishin kurrfarë domethënieje.

220

Dy persona që mendojnë janë dy; dy persona që nuk mendojnë janë një, sepse nuk ka dallime, nuk ka kufij – të dytë janë në gjendje të njëjtë.

Mendimet do të jenë tjetër ndryshe, ato do ta tërheqin linjën e demarkacionit. Por, jomendimet nuk e kanë kufirin dhe nuk kanë demarkacion, nuk kanë dallime.

Dy qenie të pafajësi janë një.

221

Fenomeni i paemër tek i cili çon besimi i plotë nuk është ndonjë marrëdhënie. Ai është pajtim. Dysia zhduket... është bërë një rreth, një pol. Dhe kjo përherë vjen pa kurrfarë informacioni paraprak, thjesht befas, ngjashëm me puhinë. Por, kur njëherë provon – që edhe dashuria edhe besimi duken tepër të qartë – e ke njohur pasurinë. Kjo mund të ndodhë vetëm për disa sekonda, nuk ka rëndësi.

Dashuria nuk është shumë e besueshme, por është e dobishme.

Shfrytëzoje dhe kalo në besim.

Por, as besimi gjithashtu nuk është argument i qindpërqindtë.

Tejkaloje atë.

Atëherë më nuk mund të rashë: atëherë nuk ka mënyrë për t'u kthyer. Atëherë ajo është diçka që i bashkohet amshimit.

222

Në të andejmen e dashurisë dhe besimit është një hapësirë e cila nuk është as objektive as subjektive, e cila thjesht është aty.

Ka shumë gjëra në ekzistencë të cilat nuk mund të emërtohen, kurse ato janë gjëra të vërteta. Ajo që mund të emërtohet paraqet kualitet të ulët të shtresës së ulët.

Ajo e paemërtuara, hapësirë e qetë... ajo përmban dashuri, ajo përmban besim dhe diçka edhe më shumë. E ajo "më shumë" është aq e gjerë. Por, ajo mund të vijë vetëm vetë, ti nuk mund t'i grahësh.

223

Ta përjetosh këtë çast, njëkohësisht do të thotë edhe të përjetosh krejt çfarë ka qenë dhe

krejt çfarë do të jetë, meqë ky çast i përmban të dyja.

Ai e përmban gjithë të kaluarën, se ku ka për të shkuar e kaluara? Ajo shkon tutje dhe hyn në çastin e tanishëm. Kurse ai përmban edhe gjithë të ardhmen, se prej nga e ardhmja ka për të buruar? Ajo do të rritet prej këtij çasti, edhe në çastin tjetër edhe në çastin tjetër, dhe gjithë amshimin.

Momenti i tashëm është fara që përmban gjithë drurët e së kaluarës, gjenerata e gjenerata drurësh. Ajo farë nuk ka ardhur prej askund, ajo ka ardhur prej drurit. Ai dru ka lindur prej ndonjë fare tjetër, kurse ajo farë ka ardhur prej ndonjë druri tjetër. Po qe se ktheheni prapa, farërat do të ju çojnë gjer tek vetë fillimet – nëse ka pasur farë fillimesh. Ajo përgjithmonë ka qenë aty.

Kurse ajo farë gjithashtu përmban drurin e ardhshëm. Prej asaj fare ka për t'u rritur një dru i ri, kurse ai dru do të lindë mijëra fara dhe mijëra trungje. Një e vetmja farë mund ta gjelbërojë gjithë Tokën; e madje edhe mund të thuhet se ajo mund të gjelbërojë gjithë universin – aq shumë përmban një farë kaq e vogël.

224

Çasti i tanishëm është fara e kohës. Ajo

është e padukshme – prandaj nuk dimë se çfarë përmban. Ajo përmban gjithë të kaluarën; ajo përmban gjithë të ardhshmen.

Për këtë insistoj në këtë që vijon: mos mendo mbi të shkuarën, mos mendo mbi të ardhmen. Thjesht ji në çastin e tanishëm – dhe gjithë e kaluara është jotja, gjithë e ardhmja është jotja.

225

E panjohura përherë pandërprerë hyn në botën tënde të njohur dhe e shqetëson. Por, ajo e shqetëson vetëm për atë se ti nuk e pret me mirëseardhje. Nëse mund ta përshëndesësh të panjohurën, dhe nëse mund ta lësh të njohurën...

Nëse je i gatshëm ta përshëndesësh të panjohurën, ti e di të fshehtën si të mbesësh fitues në të gjitha disfatat dhe në gjithë mossukseset.

226

Errësira ka qetësinë dhe errësira ka thellësinë. Errësira ka heshtjen dhe errësira merr gjithë diturinë tënde, merr krejt atë që mendon se të ka takuar. Ajo të dërgon absolutisht në të panjohurën dhe në misteriozen.

Për mua, errësira është një nga misteret

3rj0n1xx -Mundësoi Librin-



më të mëdha të ekzistencës – larg më i madh se drita.

Ata të cilët i frikësohen errësirës kurrë nuk do të mund të hyjnë në qenien e tyre. Ata kanë për të shkuar rreth e rrotull dhe kurrë nuk kanë për të ardhur tek vetvetja.

E kjo duhet të jetë errësirë, dhe jo dritë, sepse drita vjen e shkon: e kur njëherë e zbulon pikën e errësirës në vetvete, ke zbuluar diçka që është e përjetshme, diçka të paasgjësueshme, diçka që është më shumë se ajo që ti di mbi jetën. Ajo është substanca themelore nga e cila është bërë ekzistenca.

227

Koan është një enigmë që nuk mund të zgjidhet; nuk ka mënyrë që ajo të zgjidhet. Ajo është strategji me të cilën lodhet mendja jote aktive – aq shumë saqë nga lodhja bie; vetëm ashtu ajo e njeh mossuksesin e vet.

Në ato momente fokusi shumë lehtë mund të zhvendoset. Pasi që mendja nuk ka pasur sukses, ti lëvizë kah jo-mendja.

228

Ka ekzistuar arsye e besueshme që mistikët meditimin ta quajnë "jo-mendje", sepse po

u quajt meditim, mendja përsëri prej tij bën një qëllim.

Atëherë duhet ta arrish meditimin.

Prandaj nuk ka dallim se a është cak përndritja apo meditimi: qëllimi mbetet, ardhmëria mbetet dhe ato vazhdojnë ta asgjësojnë të tashmen.

Mistikët të cilët për herë të parë e kanë ndërruar termin "meditim" në "jo-mendje" kanë pasur vizion të hatashëm.

Tashmë, jo-mendja nuk mund të bëhet qëllim.

Mendja nuk mund të bëjë qëllim prej saj.

Kjo thjesht është absurd – si mendja mund të thotë se qëllim është jo-mendja?

Ajo thjesht do të thotë se kjo nuk është e mundur, mendja është gjithçka, nuk ekziston jo-mendja.

Kjo ka qenë strategjia që mos me t'u lejua ta shndërrosh në qëllim. Tepër pak njerëz e kanë kuptuar këtë strategji; për këtë e kanë quajtur jo-mendje – që të pengohet mendja që prej saj të bëjë qëllim.

Prandaj - ji - gjithnjë e më tepër e më tepër në gjendjen e jo-mendjes.

Thjesht vazhdo të mënjanosh kujtimet, fantazinë, ta pastrosh dhe ta kthjellosh çastin e tanishëm. Dhe ashtu si kjo do të shkojë duke u thelluar, ashtu si ti shkon duke u bërë gjith-

një e më i aftë e më i aftë për ta pasur jomendjen, përndritja do të vijë nga vetvetja.

229

Mu siç dashuria shërben si mjet besimi, besimi i shërben si mjet diçkahi të cilin e tejkalon – për ç'gjë në asnjë gjuhë nuk ekziston fjala. Ajo është përvojë. Ajo nuk është çështje dashurie, nuk është çështje besimi, veçse diçka absolutisht e panjohur për mendjen.

Dashuria dhe besimi të ndihmojnë ta arrish.

Prandaj mbaje në mend, ato janë vetëm mjete për t'u arritur qëllimi për të cilin nuk ekziston emër. Por, befasisht, kur besimi të jetë i plotë, ti mund ta pashë për një çast. Ai është vërshues; ti thjesht zhdukesh.

230

E vërteta nuk mund të thuhet, ndaj krejt çfarë mund të thuhet do të jetë rrenë e bukur – e bukur shkaku se mundet me të sjellë tek e vërteta.

Për këtë unë e bëj dallimin ndërmjet rrenave: rrenat e bukura dhe rrenat e shëmtuara – rrenat e shëmtuara, të cilat ju zvarritin për

tek e vërteta dhe rrenat e bukura, të cilat ju afrojnë kah e vërteta. Por, sa i përket përcaktimit të tyre, që të dyja janë rrena.

Por, ato rrena të bukura veprojnë: së andejmi në njëfarë mënyre përmbajnë shijen e së vërtetës.

231

Lëngu i vërtetë i jetës është përbrenda teje.

Mu në këtë çast mund të kthehesh përbrenda vetes, të shikosh në vetvete. Nuk nevojitet kurrfarë liturgjie, nuk nevojitet kurrfarë lutjeje. Krejt çfarë është e nevojshme është udhëtimi i qetë në qenien tënde personale.

Unë atë e quaj meditim, pelegrinazh i qetë në qenien tënde personale.

E atë çast kur e zbulon qendrën tënde, e ke zbuluar qendrën e gjithë universit.

232

Ekstremisti është përherë egoist.

233

Në momente të caktuara je më i vetëdijshëm; në momente të caktuara, më pak i vetëdijshëm. Është e mundur ta krijosh situ-

atën në të cilën do të jesh më i vetëdijshëm.

Për këtë vetëdijesimi është bërë bazë e meditimit. E me vetëdijesim ka ardhur befasia – mendimet janë zhdukur. Kur je plotësisht i vetëdijshëm, atëherë nuk ka më mendime dhe, befas, koha është ndalur.

234

Si mund të vdesësh natyrshëm nëse jeton jonatyrshëm?

235

Vdekja është mendimi i të tjerëve për ty.

236

Vetëm njeriu i zgjuar mund të vdesë me vdekje të natyrshme; përndryshe të gjitha vdekjet janë të panatyrshme, sepse të gjitha jetët janë të panatyrshme.

237

Vdekja është vetëm kulmi, kreshendoja e jetës tënde. Ajo nuk është kundër jetës, ajo nuk e asgjëson jetën.

Për të vdekur bukur, njeriu duhet të jetojë

bukur.

Për të vdekur në mënyrë të admirueshme, në ekstazë, njeriu duhet ta përgatisë gjithë jetën e vet për ekstazë, trazim, mahnitje.

238

Kur them se duhet të zhdukesh për ta kuptuar atë të skajshmen, nuk mendoj në ty; mendoj në atë që ti s'je. Mendoj në ty siç ti mendon se je.

Uni që njeh kur je një me ekzistencën nuk është uni yt i vjetër. Ai ka qenë personi yt – kurse ky individualiteti yt. Atë ta ka dhënë shoqëria, kurse ky është natyrë, realitet, dhuratë e ekzistencës.

239

E vërteta nuk është objekt të cilin do ta gjesh ndokund kur je i qetë. E vërteta është subjektiviteti yt.

Thjesht provo ta kuptosh. Ti je këtu dhe bota është këtu: krejt çfarë ti sheh është objekt, por ai që sheh është subjekti. Në qetësi, të gjitha objektet zhduken – ti e ke gjithë përjetësinë dhe qetësinë. Ajo është plot vetëdije; ajo është plot prani; ajo është plot me qenien tënde. Por, nuk ke për të gjetur asgjë të

tillë që do të ishte e vërteta. Ajo do të bëhej objekt – kurse e vërteta në asnjë mënyrë nuk është objekt.

E vërteta është subjektivitet.

Ta zbulosh subjektivitetin tënd – të papenguar, të cilin askush nuk e kundërshton – në pafundësinë dhe përjetësinë e vet të plotë – ajo është e vërteta.

240

Dështimi është si kur e gjen veten në pasqyrë. E kur kjo ndodh, zënë të ndodhin çuditë.

Kur thjesht i sodit mendimet e tua, mendimet zhduken. Pastaj befas lind qetësia e llahtarshme në ty, për të cilën kurrë më herët nuk ke ditur. Kur i shikon disponimet e tua – zemërimin, pikëllimin, lumturinë – ato befasisht zhduken, dhe ti e përjeton një qetësi edhe më të madhe.

E kur nuk ka asgjë çfarë do të vështroje, ja revolucioni: energjia e të vështruarit lëviz në vetvete, sepse nuk ka asgjë që në këtë do ta pengonte, nuk ka mbetur asnjë objekt.

Fjala "objekt" është e bukur. Ajo thjeshtë do të thotë ajo që të pengon, të kundërshton. Kur nuk ka objekte, të vështruarit tënd thjesht lëvizë për një rreth të plotë kah vetvetja – kah

burimi – dhe kjo është pika në të cilën njeriu bëhet i përndritur.

241

Përndritja thjesht është njohje e qenies tënde, njohje e përjetësisë së qenies tënde, njohje se më herët nuk ka pasur vdekje e as që ndonjëherë prapë do të ketë vdekje – se vdekja është e trilluar.

Të pamurit e qenies tënde në lakuriqësinë e vet të skajshme, në bukurinë e vet absolute, në madhështinë e vet, qetësinë e vet, ekstazën e vet – fjala "përndritje" përfshin të gjitha këto.

Kur njëherë e shijon atë lëng, mendja fillon me të lëshuar nga kthetrat e veta, sepse ke gjetur diçka që për nga kualiteti është aq lart, aq përmbushës, kënaqësi aq e madhe, saqë mendja e ndjen se roli i saj ka përfunduar.

Mendja duket e shëmtuar, shkaku se të ka sjellë vetëm mërzi, brenga, shqetësim. Me çfarë ajo ka kontribuar? Shtrëngimi i saj lëshon pe; ajo zë të fshihet në hije dhe gradualisht zhduket.

Ti vazhdon të jetosh, por jeta jote tash është valëvitëse; e ajo që ke fituar si nusprodukt në atë pauzë të vogël të jo-mendjes vazhdon të rritet. Asaj rritjeje nuk i shihet fundi.

Përndritja vetëm fillon, ajo kurrë nuk për-

fundon.

242

Nuk po provoj me të dhënë kurrfarë idealesh – se do të duhej të bëheshe i këtillë apo i atillë. Thjesht përpiqem me të ndihmuar me pa se ti veç je ai çfarë ke nevojë të jesh.

Thjesht hidhi të gjitha gjakimet, të gjitha dëshirat, të gjitha ambiciet për të qenë dikush tjetër, që të mund të jesh pikërisht ai që je.

Nuk dua me të tërheqë nga qenia jote. Dua që gjithnjë e më tepër t'i ofrohesh qenies tënde, që në fund të mbetesh vetëm ti në vetveten.

243

Dëshira, si e tillë, përherë është joshpirtërore. Prandaj, nuk mund të ekzistojë kurrfarë dëshire e përshpirtshme.

244

Njeriu është eksperimenti më i madh i ekzistencës. Në këtë univers të gjerë e të pafund, vetëm në këtë Tokën e vogël ekzistenca ia ka dalë ta prodhojë njerëzimin – i cili ka aftësinë që të bëhet plotësisht i vetëdijshëm.

Ekzistenca pret shumë prej teje.

245

Në ty, nga koha në kohë, ndodh ndërrimi i caktuar i personalitetit, përpiqu vetëm ta vështrosh këtë, por mos u përziej me ato personalitete sepse ashtu do të krijosh konfuzion edhe më të madh, hutesë edhe më të madhe. Vetëm vështro, se gjersa i vështron gjithë ato personalitete, ti bëhesh i vetëdijshëm se ekziston gjithashtu edhe një vështrues, që nuk është asnjëri prej atyre personaliteteve, por që para tij të gjitha ata vijnë dhe shkojnë.

Ai nuk është asnjëri prej atyre personaliteteve, për atë se ato nuk mund të vështrohen në mes veti. Kjo është tejet interesante dhe tejet thelbësore – që një personalitet nuk mund ta vështrojë tjetrin, sepse ata nuk e posedojnë shpirtin.

Ajo është si veshja jote. Ti mund ta ndërrosh veshjen, por veshja jote nuk mund ta dijë se është ndërruar, se në vend të saj tash është përdorur një tjetër pjesë e veshjes. Ti nuk je veshja, prandaj mund ta ndërrosh, ti nuk je personaliteti – andaj mund të jesh i vetëdijshëm për të gjitha ato personalitete të shumta.

Kjo, po ashtu, e bën një gjë tepër të qartë, se ekziston diçka e pandryshueshme që e vështron gjithë këtë lojë të personaliteteve që ndërrohen në ty.

E kjo mosndryshueshmëri, kjo je ti.

246

Vetëm vështroji ato personalitete, por mbaje në mend se zgjimi yt është realiteti yt. Dhe po qe se do të mund ta mbash vëmendjen në personalitetin e caktuar në ty, të gjithë ata do të zënë të zhduken, nuk do të mund të jetojnë. Atyre iu nevojitet që me diçka të identifikohen për të mbetur në jetë. Po qe se, për shembull, ti hidhërohesh, ajo kërkon prej teje që të harrosh natyrën tënde të vërtetë dhe që të identifikohesh me hidhërimin, nëse nuk identifikohesh – atëherë hidhërimi nuk ka jetë: ai bëhet i vdekur, vdes, zhduket.

Së këndejmi bëhu sa më shumë që mundesh i mbledhur, i koncentruar në zgjimin tënd, dhe të gjitha ato personalitete në ty do të zhduken. E kur të mos mbetet më asnjë, atëherë realiteti yt – zotëriu yt – do të vijë në shtëpi.

Ti atëherë bëhesh i vërtetë, autentik. Dhe çfarëdo që bën, e bën atë tërësish, i dhënë pas saj – pa kurrfarë ankimi, përherë i hareshëm, me disponim.

247

Shumë nga problemet tona – në të vërtetë

shumica prej tyre – lindin sepse kurrë me to nuk jemi përballur, kurrë me to nuk jemi konfrontuar; dhe kjo se me to nuk jemi përballur u jep energji. Frika prej tyre u jep energji, përherë kur duam t'u shmangemi i ushqejmë me energji – sepse ashtu iu dorëzohemi.

Dorëzimi yt i vërtetë u jep jetë. Nëse nuk dorëzohesh, ato nuk mund të jetojnë.

Ti e ke burimin e energjisë në vetvete. Çfarëdo që ndodhë në jetën tënde, atë e kërkon energjia jote. Po qe se nuk e ndërpret atë burim energjie – kjo është ajo që unë, me fjalë tjera, e quaj identifikim – dhe po qe se nuk identifikohesh me ngjarjet, ato menjëherë vdesin, sepse nuk e posedojnë energjinë e tyre vetanake.

Ai mos-identifikim është ana tjetër e zgjimit.

248

Lehtë është të arrish shprehinë, vështirë është ta arrish vetëdijesimin – por vetëm në fillim.

249

Ne kurrë nuk çajmë kokë për rrënjën e dashurisë, por gjithmonë flasim për lulet e saj. U flasim njerëzve që të mos bëhen të dhunshëm, që të jenë të ndjeshëm, të dashur – aq

shumë sa të mund t'i duan armiqtë e tyre, të mund t'i duan madje edhe të afërmit e tyre.

Ne flasim mbi lulen, por askush nuk çan kokë për rrënjën. Së këndejmi lind pyetja: pse ne nuk e duam ekzistencën? Pyetja nuk ka të bëjë me atë se a e do ti këtë person apo atë tjetrin, këtë të dytin, këtë armikun; veçse (ka të bëjë) me atë – se a do ti apo nuk do fare?

Vallë, a e do trupin tënd personal? A je kujdesur ndonjëherë për të me dashuri? A e do vetveten?

Ti je i pavyeshëm, kurse do të doje të ishe i mirë. Je mëkatar, kurse do të doje të bëheshe shenjtor. Si mund ta duash vetveten nëse nuk mund ta pranosh vetveten ashtu siç je. E në të vërtetë kjo është rrënja.

Lulja plastike është e pandryshueshme – dashuria e mbyllët është e pandryshueshme. Lulja natyrale është e ndryshueshme; ajo ndryshon prej çastit në çast. Ajo sot është këtu, vallëzon në erë, nëpër diell e nëpër shi. Por nesër ti nuk do të mund ta gjesh. Ajo zhduket po aq mistershëm siç është lajmëruar.

Dashuria e vërtetë është si lulja natyrore.

250

Zemra nuk di asgjë mbi të kaluarën, asgjë mbi të ardhmen; ajo di vetëm për të tashmen.

Zemra nuk ka kurrfarë ideje mbi kohën.

251

Kupto se e kaluara dhe e ardhmja nuk ekzistojnë. E vetmja që ke ai është një çast me të vërtetë i vogël: ky çast. Ti nuk ke asnjë çast tjetër. Ti përherë e ke vetëm një çast në duart e tua, e ai është aq i pavërejtshëm dhe afatshkurtër saqë do të ikën me vrap nëse do të mendosh mbi të kaluarën dhe të ardhmen.

E vetë ai çast është jeta dhe vetë ai çast është realiteti.

252

Politika është sëmundje, dhe do të duhej trajtuar pikërisht ashtu. Ajo është më e rrezikshme se kanceri; nëse operacioni është i domosdoshëm, duhet bërë. Por, politika është e ndytë në esencën e vet. Dhe duhet të jetë e tillë sepse mijëra njerëz gjakojnë, kanë dëshirë të zjarrtë të zënë të njëjtin pozicion kyç. Së këndejmi është krejtësisht e natyrshme se ata do të luftojnë, se do të vrasin, se do t'i bëjnë të gjitha për hir të saj.

I tërë programi ynë mental është i gabuar sepse jemi programuar për të qenë ambiciozë – e kjo është ajo që e përbën esencën e politikës.

Dhe kjo nuk ngjan vetëm në botën e përditshme të politikës, por kjo e ndotë edhe jetën tënde të përditshme.

253

Madje edhe fëmija i vogël zë t'u buzëqeshë nënës dhe babait me buzëqeshje të shtirur. Nuk ka ndonjë domethënie më të thellë përtej saj, por fëmija thjesht e di se, po qe se buzëqesh, do të marrë shpërblimin për të. Ai e ka mësuar rregullën e parë nga shkencat politike. Ai ende është në djep, kurse ju e mësoni të jetë politikan. Dhe së këndejmi politika është e pranishme në të gjitha marrëdhëniet njerëzore.

Mashkulli e ka sakatuar femrën. Kjo është politikë. Femra e përbën gjysmën e njerëzimit dhe mashkulli nuk ka të drejtë ta sakatojë kështu deri në fund; por, gjatë shekujve, mashkulli e ka sakatuar femrën.

Ai nuk e ka lejuar të arsimohet, nuk e ka lënë madje as t'i dëgjojë mësimet e shenjta. Në shumë konfesione mashkulli nuk u ka lejuar femrave që të hyjnë në faltore; po qe se, në ndonjë rrethanë, edhe do t'ia lejonte, ajo atje ka qëndruar në vend të izoluar. Ato as para Zotit nuk mund të jenë të barabarta me meshkujt.

254

Mashkulli ka provuar t'ia shkurtojë femrës lirinë në të gjitha mënyrat e mundshme. Kjo është politikë; kjo nuk është dashuri. Ti e do femrën, por nuk ia jep lirinë. Ç'lloj dashurie është ajo e cila frikësohet ta japë lirinë? Ti e ke mbyllë në kafaz femrën si papagallin. Ti mund të thuash se e do papagallin, por nuk e kupton se ashtu je duke e varë atë.

Ti ia ke suprimuar papagallit tënd gjithë qiellin e tij, kurse ia ke dhënë vetëm kafazin. Kafazi mund të jetë i ndërtuar nga ari, por madje edhe kafazi i artë nuk mund të krahasohet me lirinë të cilën papagalli e ka në qiell, ashtu që fluturon nga lisi në lis dhe e këndon këngën e tij – por jo ashtu siç ti do ta detyrosh të këndojë, por ashtu që ajo është sipas natyrës së vet dhe është shprehje autentike e tij.

255

Gjysma e njerëzimit në secilin shtet, në secilin civilizim është e shkatërruar si pasojë e politikës së familjes. Por kjo është esenca e vetë politikës. Kudo që ekziston nevoja për të pasur pushtet mbi personin tjetër – ajo është politikë.

Pushteti është përherë politik, madje edhe

mbi fëmijët e vegjël. Prindërit mendojnë se i duan fëmijët e tyre, por ajo është vetëm në mendjet e tyre; në të vërtetë, ata i duan fëmijët për t'i përulur. E çfarë do të thotë ajo përulje? Ajo do të thotë se e tërë fuqia është në duart e prindërve.

Po qe se përulja është kualitet aq i lartë, përse atëherë prindërit nuk u përulen fëmijëve të tyre? Po qe se ajo është gjë aq religjioze, prindërit do të duhej t'u përuleshin fëmijëve të vet.

Pushteti nuk ka kurrfarë lidhjeje me religjionin. E vetmja lidhje në mes tyre mund të jetë në atë që ta fshehin politikën në këtë botë të bukur.

Njeriu duhet të zbulojë secilën pikë ku është futur politika – kurse ajo është futur gjithkund, në secilën marrëdhënie. Ajo e ka ndotur jetën e gjithmbarshme, e edhe më tej pa ndalim e ndot.

256

Është krijuar ambicie e tillë që ti duhet të bëhesh dikush në këtë botë, ta dëshmosh se nuk je vetëm një person i rëndomtë, por se je i pazakonshëm. Por përse kjo? Cilit qëllim i shërben kjo? Kjo i shërben vetëm një qëllimi: që ti të bëhesh i pushtetshëm, kurse gjithë të

tjerët të jenë të nënshtruar.

Ti do të doje ta tredhje gjithë njerëzimin në mënyra të ndryshme – dhe kjo tredhje është esenca e politikës.

257

Njerëzit e duan lirinë – por askush nuk e do përgjegjësinë.

Kurse liria dhe përgjegjësia shkojnë së bashku dhe nuk mund të jenë të ndara.

258

Pse brengosesh rreth asaj që të jesh i pëlqyer? Ka kuptim të brengosesh rreth saj vetëm nëse nuk e do punën tënde; vetëm atëherë ajo e ka kuptimin e vet të plotë, në të kundërtën kjo është vetëm surrogat.

Ti e urren punën tënde, nuk e do, porse e kryen shkaku se ajo ka me të sjellë mirënjohje; ti do të jesh i pranuar, do të jesh i çmuar.

Por, në vend se të mendosh mbi këtë, rishqyrtoje punën tënde. A e do për ta punuar? Dhe kjo është e tëra. Nëse nuk e do, atëherë ndërroje atë.

Prindërit, mësuesit përherë insistojnë në atë se duhet të jesh i pranuar, se duhet të jesh i pëlqyer. Kjo është strategji tepër dinake që

njerëzit të mbahen nën kontroll.

Mësoje një gjë themelore. Bëje vetëm atë që dëshiron ta bësh, që do ta bësh, dhe kurrë mos kërko të jesh i pëlqyer. Ai është fillimi. Përse do të kërkoje që dikush me të pëlqyer? Përse do të gjakoje që dikush me të pranuar?

Shiko thellë në vete. Ti sigurisht nuk e do atë që bën. Ti me siguri frikohesh se ndodhesh në rrugë të gabuar. Pranimi ka me të ndihmuar ta ndjesh se je në rrugën e duhur. Aprovimi do të bëjë që ta ndjesh se po shkon kah qëllimi i drejtë.

Qe pyetje për ndjenjat e tua më të thella, kjo nuk ka kurrfarë lidhjeje me botën e jashtme: Përse varesh nga të tjerët? – Atëherë të gjitha këto gjëra varen nga të tjerët dhe ti vetë bëhesh i varur.

Nëse i ikën kësaj varësie, ti atëherë bëhesh individual dhe do të jesh individ, ashtu që do të jetosh në liri të plotë mbi këmbët e tua, duke u furnizuar nga burimet e tua individuale – e kjo është ajo që bën që njeriu të jetë vërtet në qendrën e vet, bimuar nga rrënja e vet. Dhe ky është fillimi i lulëzimit të tij më të bujshëm.

259

Po qe se inteligjenca mbetet e padjallëzuar, ajo është gjëja më e bukur e cila mund të

ndodhë. Por po qe se inteligjenca është kundër padjallëzisë, atëherë ajo është thjesht ligësi dhe kurrgjë tjetër: ajo në të vërtetë edhe nuk është inteligjencë.

Në çastin kur çiltërsia zhduket, shpirti i inteligjencës shkon dhe mbetet vetëm kërma. Ajo atëherë është më mirë të quhet, thjesht, "intelekt". Në këtë mënyrë ti mund të bëhesh intelektual i madh, por kjo nuk ka me ta ndryshuar jetën dhe nuk ka me të hapur ndaj mistereve të ekzistencës.

Ai mister është i hapur vetëm ndaj inteligjencës së fëmijës. Dhe, në të vërtetë, personi inteligjent e ruan fëmijërinë e vet, e jeton deri në frymën e fundit. Kurrë nuk e lë ajo – çudia të cilën fëmija e ndjen duke shikuar zogjtë, duke soditur lulet, qiellin... Inteligjenca, po ashtu, duhet të jetë, në njëfarë mënyre, fëmijërore.

260

Pak është e pazakonshme ajo se e vërteta nuk është demokratike. Mbi atë se ç'është e vërteta nuk kanë për të vendosur votuesit në zgjedhje; në këtë mënyrë ne, përkundrazi, kurrë nuk kishim për të ardhur tek e vërteta. Njerëzit do të votojnë për atë që është komode – e gënjeshtra është tepër komode, se ti nuk dëshiron të investosh kurrfarë mundi rreth

saj, por dëshiron vetëm të besosh.

E vërteta, megjithatë, kërkon angazhim të madh, zbulim, rrezik, e kjo kërkon që vetë të ecësh shtegut të cilit askush para teje nuk ka ecur.

261

Cilësitë e personit të rritur janë tepër të çuditshme. E para, ai nuk është personalitet, e nuk është as unë i vërtetë.

Ai është i pranishëm, por nuk është personalitet.

E dyta, ai më tepër është si ndonjë fëmijë – i thjeshtë dhe naiv. Për këtë unë them se cilësitë e njeriut të rritur janë tejet të çuditshme, sepse "rritja" jep iluzionin se, nëse ai apo ai tjetri është me përvojë, ai sipas moshës është i vjetër.

Psikikisht kjo mund të jetë kështu, por shpirtërisht ai është një fëmijë naiv. Rritja e tij nuk do të thotë se ai ka zënë vetëm përvojë jetësore – atëherë ai nuk do të mund të ishte i pranishëm. Ai do të mund të ishte vetëm person me përvojë – i shkathtë, por jo edhe i pjekur.

Pjekuria nuk ka kurrfarë lidhjeje me përvojën jetësore. Ajo ka lidhje me udhëtimin tënd të brendshëm, me përvojën e brendshme.

262

Sa më tepër ndonjë person futet më thellë në brendësinë e vet, ai do të jetë më i pjekur. Kur arrin gjer tek vetë qendra e qenies së vet, ai do të jetë përsosmërisht i pjekur. Por, në atë çast personaliteti zhduket, kurse mbetet prania; uni zhduket, mbetet vetëm qetësia. Përvoja zhduket, mbetet mituria.

Për mua, pjekuri është vetëm emër tjetër për realizimin. Ti mund ta arrish realizimin e mundësive të tua. Ato mund të bëhen reale. Fara e ka përfunduar udhëtimin e vet të gjatë dhe ka lulëzuar.

Pjekuria është aroma e lules. Ajo i jep bukuri të pafund individit. Ajo i jep inteligjencë, mundësinë më të mprehtë të inteligjencës. Ajo në njeriun, në individin krijon vetëm dashuri.

Veprimi i tij është dashuri, mosveprimi i tij është dashuri. Jeta e tij është dashuri, vdekja e tij është dashuri.

Ai, në të vërtetë, është lule e dashurisë.

263

Muzika bashkëkohore e ka humbur magjinë shkaku se e ka harruar qëllimin e vet themelor. Ajo e ka harruar origjinën e vet. Ajo

nuk e di se ka bazë të njëjtë me meditimin. E njëjta gjë vlen edhe për artet tjera. Të gjitha ato bëhen meditative, dhe të gjitha ato njeriun e çojnë në çmenduri.

Artisti ashtu e krijon rrezikun si për vetveten gjithashtu edhe për gjithë ata të cilët do ta dëgjojnë.

Ai mund të jetë edhe piktor, por edhe pikturimi i tij po ashtu do të jetë çmenduri – shkaku se gjithë ai art nuk rrjedh nga të medituarit.

264

E tërë mendja vepron ashtu që krijon ndasi. Zemra vepron ashtu që i sheh lidhjet bashkuese për të cilat mendja është plotësisht e verbër.

265

Mendja e mediokritetit nuk mund të çmendet.

266

Mendimi mbi qetësinë dhe qetësia nuk shkojnë së bashku. Ky nuk është problem yti personal; ky është problem i mendjes njerëzore si e tillë, sepse për të qenë e qetë, për të

pasur qetësi, do të duhej të ishte në gjendjen e jo-mendjes.

Mendja nuk mund të jetë e qetë. Ajo duhet pa ndalim të mendojë, të brengoset. Mendja punon si biçikleta. Nëse i sjell pedalet e saj, ajo sillet; në atë moment që pushon së bëri atë, ke për të rënë poshtë. Mendja është automjet në dy rrotë, mu si biçikleta; kurse të menduarit tënd është sjellje e pandërprerë e pedaleve.

Madje nëse ndonjëherë je vetëm pak më i qetë, ti menjëherë zë të brengosesh: "Përse jam i qetë?" E pastaj i bën të gjitha që të krijosh brengosje, mendueshmëri, sepse mendja mund të ekzistojë vetëm në një mënyrë – në nxitim, përherë në vrap për diçka, apo në ikje prej diçkahi, por përherë në nxitim. Pikërisht ai nxitim, ajo është mendja.

Në çastin kur ndalon, mendja zhduket.

267

Në çdo mënyrë ne provojmë ta mënjanojmë ndjenjën se jemi të vetmuar në ekzistencë. Nga kjo arsye ne sajojmë të gjithë llojet e titujve. Ndonjë njeri, ta zëmë, merr nuse; e ç'është martesa tjetër përveçse titull? Por përse? Sepse ata dëshirojnë ta zotërojnë atë vetmi dhe disi të ndërtojnë urë.

Por ura kurrë nuk është e ndërtuar; ata

vetëm mendojnë se njëri është burri, kurse tjetra gruaja, ndërkaq ata mbesin vetëm të vetmuarit. Tërë jetën ata do të jetojnë, por edhe përkundër kësaj nuk do të jenë kurrgjë tjetër përveçse të vetmuar, shkaku se askush nuk mund të depërtojë në vetminë e huaj.

Ti nuk duhet të jesh i vetmuar nëse mund të depërtosh në vetminë time, apo nëse unë mund ta gjej rrugën deri tek vetmia jote – por kjo nuk është e mundur, ekzistencialisht nuk është e mundur. Ne mund të avitemi tepër afër, por sa më të afërt që bëhemi ne, bëhemi më të vetëdijshëm për vetminë, sepse nga ajo afërsi mund të shohim më mirë: "Tjetri për mua është i pakuptueshëm dhe, sigurisht, i pamundësi për njohje".

268

Secili prej nesh ka një lloj panciri.

Ekziston arsyeja për këtë. Si e para, fëmija lindet skajshmërish i pandihmë në botën në të cilën nuk di asgjë. Natyrshëm, ai i frikohet së panjohurës e cila ndodhet para tij.

Ai akoma nuk ka harruar nëntë muajt e mbrojtjes së plotë, të sigurisë – atje ai ka qenë pa probleme, pa përgjegjësi, pa frikë për të nesërmen. Për ne ajo është nëntë muaj, por për fëmijën ajo është përjetësi. Ai nuk di asgjë për

kalendarin; ai nuk di asgjë për minutat, orët, ditët, muajt. Ai ka jetuar në përjetësi, plotësisht i mbrojtur dhe i sigurt, pa kurrfarë përgjegjësie.

E atëherë, befas, ai gjendet në botën e panjohur, në të cilën është i varur prej secilit , prej të tjerëve. Dhe është e natyrshme se ka për të ndjerë frikë. Secili është më i madh dhe më i fuqishëm se ai, dhe ai nuk mund të jetojë pa ndihmën e huaj. Ai e di se është i varur, se e ka humbur pavarësinë e tij, lirinë e tij.

Nga kjo pikëpamje, panciri mund të jetë i domosdoshëm; sigurisht edhe është. Por kur rritesh, nëse jo vetëm je plakur, por edhe je pjekur – rritur në pjekuri – ti ke për të parë se çfarë bart me vete.

Shiko më mirë dhe ke për të parë frikë prapa saj. Krejt çfarë është në lidhje me frikën, personi i pjekur duhet vetë ta zgjidhë me vetveten. Ky është tregues se është pjekur. Vetëm shiko të gjitha veprimet e tua, të gjitha besimet e tua dhe vërej se a janë ato të bazuara mbi realitetin, mbi përvojën, apo, megjithatë, mbi frikën. E çfarëdo qoftë e themeluar mbi frikën, duhet të hidhet në këtë çast, pa u menduar gjatë. Ai është panciri yt.

269

Pancirin tënd psikik askush nuk mund ta

heqë prej teje sepse ti do të luftosh për të. Vetëm ti mund të bësh diçka për ta hedhur.

E kjo do të thotë ta hulumtosh deri në detaje. Po qe se është i themeluar mbi frikën, hidhe atë. Nëse, megjithatë, është i themeluar mbi arsyen, përvojën, kuptimin, atëherë ai është diçka që nuk duhet hedhur por diçka që do të duhej të bëhej pjesë e qenies tënde.

Por një gjë, e cila është e themeluar mbi përvojën, ti nuk ke për ta gjetur në pancirin tënd. Ajo është frika, nga A deri në ZH. E tërë jeta jonë nuk është asgjë tjetër veçse frikë; dhe kjo është arsyeja se përse helmojmë të gjitha përvojat tona tjera. Ne e dashurojmë ndokënd, por ajo dashuri është e themeluar mbi frikën. Për këtë ajo është e pasinqertë, e helmatisur. Ne gjurmojmë për të vërtetën, por nëse ajo rrjedh nga frika nuk do të mund ta gjejmë.

Çfarëdo të punosh mbaje në mend një gjë: Nëse veprimi yt rrjedh nga frika, ti kurrë nuk do të piqesh, por ke për t'u venitur dhe vdekur. Frika është shërbëtori i vdekjes.

270

Personi i pafrikueshëm ka për t'i fituar si shpërblim të gjitha dhuratat e jetës. Dhe atëherë më nuk do të ketë pengesa; ato do të thyhen nga furia e dhuratave dhe çfarëdo që të

bëjë ai do të jetë veprim i fuqisë, i pushtetit, i besimit në vetvete – një ndjesi e pafund autoriteti.

271

Atë që duhet ta kuptosh gjithsesi është ajo se ndokush mund të identifikohet me diçka që, për nga natyra e vet, nuk është. Në të vërtetë tash ti je identifikuar me mendjen tënde. Ti mendon se je ajo. E pikërisht nga ky identifikim lind frika. Nëse je identifikuar me mendjen, atëherë, natyrshëm, po qe se ajo ndalet, edhe ti ke mbaruar, nuk ekziston më. Sepse, përveç mendjes për ty nuk ekziston asgjë tjetër.

Por realiteti është pikërisht ai se ti nuk je mendja, ti je diçka jashtë mendjes; së këndejmi është absolutisht e domosdoshme që mendja të ndalet, ashtu që për herë të parë do të mund të kuptosh se ti nuk je mendja – për arsye se kur mendja ndalet, ti edhe më tutje mbetesh këtu.

Mendja ka shkuar, por ti akoma je këtu dhe atë me gëzimin më të madh, me lavdinë më të madhe, me shkëlqimin më të madh, me vetëdijen më të madhe, me origjinalitetin më të madh.

272

E vërtetë është se ne jemi të vetmuar, se jemi të huaj – dhe bota do të ishte larg më e mirë po qe se do ta pranonim këtë të vërtetë themelore: se jemi të huaj.

E çfarë ka të keqe në atë nëse dashurohesh në personin e panjohur? Çfarë nevojitet para se të dashurohesh në personin e panjohur? Ta asgjësosh të panjohurën si të tillë?

Njëra nga bukuritë jetësore është ajo se të gjithë ne jemi të panjohshëm, dhe nuk ekziston mënyrë që ta ndryshojmë këtë realitet. Bukur është ajo që personi i panjohur të të dashurojë, që personin e tillë ta kesh mik, se të panjohurit janë kudo në botë. Kështu e tërë bota bëhet fshehtësi – e ajo edhe është fshehtësi.

273

Kjo është gjë e njohur: ti dashurohesh në ndonjë njeri, por nuk dashurohesh në njeriun e vërtetë, porse dashurohesh në njeriun nga imagjinata jote. Kjo është kështu derisa nuk e kaloni njëfarë kohe së bashku. Fillimisht ti nga ballkoni yt e sheh ndonjë njeri, apo shkurtimisht e takon në plazh, apo mbaheni dorë për dore në kinema dhe atëherë zë të ndjesh:

"Ne jemi të krijuar njëri për tjetrin".

Por nuk ekziston diçka e tillë si – të krijuar njëri për tjetrin. Ti vazhdon të projektosh edhe më shumë fantazi në atë njeri – pavetëdijshëm. Ti krijon aurën e caktuar rreth atij njeriu, kurse ai atë njësoj e krijon rreth teje. Çdo gjë duket sikur do të jetë përrallore, sepse ti e ke bërë atë përrallore, e ke thurur me ëndrra, pavarësisht realitetit. Dhe të dy përpiqeni, në të gjitha mënyrat e mundshme, të mos ia rrezikoni njëri-tjetrit ëndërrimet.

E atëherë gruaja sillet ashtu siç burri i saj dëshiron, kurse burri sillet ashtu siç gruaja e tij dëshiron. Por ti nuk mund ta bësh atë më gjatë se disa minuta apo, megjithatë, disa orë.

Njëherë kur jeni kurorëzuar, ti ke dëshiruar të jetoni së bashku njëzet e katër orë në ditë. Por kjo është bërë barrë e padurueshme, sepse më nuk mund të shtiresh se je ai që nuk je.

Kur shteron imagjinata jote mbi burrin apo mbi gruan, edhe sa gjatë do të mund të shtiresh? Herët apo vonë kjo ka me t'u bë barrë, e pastaj do të fillosh të hakmerresh. Do ta shkatërrosh gjithë atë imagjinatë të cilën burri yt e ka thurur rreth teje shkaku se nuk dëshiron më të jesh e burgosur në të; ti dëshiron të jesh e lirë dhe të jesh vetëm e vetvetes.

E njëjta situatë është me burrin; ai dëshiron të jetë i lirë dhe t'i përkasë vetëm vetvetes.

Dhe në këtë pasqyrohet konflikti i pandalshëm në mesin e gjithë dashnorëve dhe në të gjitha marrëdhëniet.

274

Dashuria jep liri.

Dashuria i lejon të gjitha; atë që tjetri ndjen se do të dëshironte ta bënte, e ka të lirë ta bëjë. Çfarëdo që ai ndjen – nëse ajo e bën të lumtur – ajo është zgjedhja e tij.

Nëse e do dikë, atëherë mos u përziejë në privatësinë e tij. Lëre privatësinë e personit të dashur në qetësi. Mos përpush nëpër të vërtetën e tij.

Qëndrimi themelor i dashurisë thotë: "Unë e pranoj personin tjetër ashtu siç ai është". Dashuria kurrë nuk tenton ta ndryshojë personin e dashur sipas idesë që ai tjetri ka për të. Mos provo ta presh atë këtu e atje dhe ta fusësh në qepjen tënde – megjithëqë ai është fenomen i cili ndodh në çdo centimetër të kësaj bote...

Nëse dashuron, atëherë nuk ke për të vënë kushte.

Nëse nuk dashuron, kush je atëherë ti që të vësh kushte?

Që të dyja rastet janë të qarta, nëse dashuron, atëherë nuk bëhet fjalë për

kushtëzim. E do personin e caktuar ashtu siç është. Nëse nuk e do, kjo po ashtu nuk është problem. Ai është për ty askush dhe asgjë dhe prapë nuk bëhet fjalë për kushtëzimin. Ai mund të bëjë çfarëdo që të dojë.

Po qe se xhelozia zhduket dhe mbetet vetëm dashuria, do të kesh diçka të qëndrueshme dhe të çmueshme në jetën tënde.

275

Kur e ndan lumturinë tënde me dikë, mos krijo prej kësaj burg për të tjerët; veçse thjesht jepe. Mos prit as që dikush me t'u përkulur dhe falënderuar për atë se ti diçka po jep – mos prit kurrgjë për të, madje as falënderim. Ti jep shkaku se je i tejpasur, sepse dëshiron me dhënë.

Po qe se dikush duhet të jetë falënderues, atëherë je ti falënderues ndaj personit që dëshiron ta pranojë dashurinë tënde, i cili dëshiron ta pranojë dhuratën tënde. Ai nuk të kushtëzon, ai ta lejon të hapesh para tij.

Dhe sa më shumë që je në gjendje të ndash, sa më shumë që je në gjendje të dhurosh, aq më shumë ke. Në këtë mënyrë kurrë nuk ke për t'u varfëruar, nuk ke për të krijuar frikë të re të ngjashme me atë: "Kam mundur të hup këtë apo atë". E vërteta është,

ndërkaq, se sa më shumë që humb, aq më shumë ujë i freskët rrjedh nga burimi për të cilin më parë nuk ke qenë i vetëdijshëm.

276

Po qe se e tërë ekzistenca është një, dhe po qe se ekzistenca brengoset mbi drurin, mbi kafshët, mbi malet, mbi oqeanet – brengoset si për më të voglën tufë të barit, ashtu edhe për yllin më të madh – atëherë kjo do të brengoset edhe për ty.

Përse të jesh posesiv? Posesiviteti shpreh një gjë të thjeshtë – se ti nuk mund të besosh në ekzistencë. Ti dëshiron të rregullosh mbrojtje të veçantë për vete, siguri për veten, dhe nuk mund t'i besosh ekzistencës.

Jo-posesiviteti është besim themelor në ekzistencë.

Atëherë nuk ka nevojë për posesivitet, sepse ne jemi një me ekzistencën.

277

Largoje idenë se lidhshmëria dhe dashuria janë e njëjta gjë. Ato, në të vërtetë, janë armiq, lidhshmëria është ajo që asgjëson çdo dashuri.

Nëse e ushqen, nëse e kultivon lidhshmërinë, dashuria do të jetë e asgjësuar; nëse e

ushqen dhe e kultivon dashurinë, lidhshmëria do të zhduket vetvetiu.

Dashuria dhe lidhshmëria nuk janë e njëjta gjë; ato janë dy entitete të ndara, armiqësisht të orientuara njëra kundrejt tjetrës.

278

Mbaje mend njëherë e përgjithmonë rregullën themelore të jetës: Nëse e adhuron dikë, bëhu gati për hakmarrjen e tij një ditë.

279

Ji i vetëdijshëm dhe mos lejo që kushdo qoftë të manipulojë me ty, more sado qofshin qëllimet e tij të mira. Do të duhej ta mbrosh vetveten prej aq shumë njerëzve qëllimmirë, bamirësve, të cilët pa ndalim të japin këshilla të jesh i këtillë, të jesh i atillë. Ti vetëm dëgjo dhe falënderoji. Ata nuk mendojnë kurrgjë keq – por keq është ajo që bëjnë.

Dëgjoje vetëm zemrën tënde.

Ajo është mësuesi yt i vetëm.

280

Njerëzit të gjykojnë dhe ti i pranon gjykimet e tyre pa rezervë. Ti vuan shkaku i gjithë atyre

gjykimeve, e atëherë të njëjtën gjë e bën ndaj të tjerëve; ajo lojë është bërë aq e shfrenuar saqë i tërë njerëzimi vuan prej saj.

Po qe se dëshiron të ikësh nga çmenduria e tillë, gjëja e parë të cilën duhet ta bësh është kjo që do të them: mos e gjyko vetveten. Pranoje shtruar mospërsosmërinë tënde, mangësitë e tua, gabimet e tua, manitë e tua. Nuk ka nevojë ta aktrosh dikë tjetër. Vetëm ji ai që je, ashtu si je: "I tillë jam unë – plot frikë. Nuk guxoj të hyj në errësirë të dendur. Nuk guxoj të hyj në pyll të dendur". Çfarë ka të keqe në këtë? – është njerëzore të ndjesh frikë.

Njëherë kur ta pranosh vetveten, do të jesh në gjendje t'i pranosh të tjerët, sepse do të kesh vetë përfytyrim të qartë se ata vuajnë prej së njëjtës sëmundje. Me atë se i pranon të tillë çfarë janë, do t'u ndihmosh që ta pranojnë vetveten.

Ti mund ta vësh në lëvizje tërë procesin duke u bërë i aftë që t'i pranosh të tjerët. Dhe për atë se dikush po i pranon, ata e mësojnë bukurinë e pranimit për herë të parë – sa pajtimtare është kjo ndjesi – dhe ata zënë t'i pranojnë të tjerët.

Po qe se i tërë njerëzimi do ta arrinte atë nivel ku secili do ta pranonte vetveten ashtu siç është, gati se nëntëdhjetë për qind e mjerimit do të zhdukej - do të mbetej pa

pikëmbështetje – dhe zemra jote do të hapej për akordin e vet të veçantë, kurse dashuria jote do të gufonte prej tij.

281

E vërteta është gjithnjë e pastër, lakuriqe, unike.

Dhe kjo është diçka më së bukuri, sepse e vërteta është esenca e vërtetë e jetës, e ekzistencës, e natyrës.

Përpos njeriut, askush tjetër nuk gënjen. Gjembi i trëndafilit nuk mund të gënjejë. Ai di të lindë trëndafila; ai nuk mund të lind kumak – ai nuk mund të mashtrojë. Ai nuk është i aftë të jetë diçka tjetër përveçse ai që është. Përpos njeriut, e tërë ekzistenca jeton në të vërtetën.

E vërteta është religjioni i gjithë universit. Atë çast kur njeriu vendos të jetë pjesë e ekzistencës, e vërteta do të bëhet edhe religjion i tij.

Ky është revolucioni më i madh i cili njeriut mund t'i ndodhë. Ky është çast lavdie.

282

Ti nuk e sheh botën ashtu si ajo është – ti e sheh ashtu si ta imponon mendja jote. Gjëra të ngjashme mund të pash anembanë botës.

Njerëzit e ndryshëm janë të kushtëzuar në mënyra të ndryshme; mendja nuk është gjë tjetër përveçse kushtëzim. Njerëzit i shohin gjërat në mënyrën e cila është e kushtëzuar me vetë kushtëzimin e tyre – ai kushtëzim krijon koloritin e caktuar në gjërat.

Ne prodhojmë dallime; ne bëjmë që dikush të jetë i mbiçmuar, kurse dikush i nënçmuar; burri është më i fuqishëm, gruaja më e dobët; dikush është më i mençur, dikush më budalla. Sundimtarët kanë shpallur se ata janë njerëz të zgjedhur nga Zoti. Secili religjion shpall se librin e tij të shenjtë e ka shkruar vetë Zoti, të gjitha këto gjëra, rrena mbi rrenat, i prodhon mendja jote.

Gjithnjë derisa nuk je bërë i aftë që gjithë mendjen tënde ta veçosh anash dhe ta shikosh botën drejtpërsëdrejti, pa ndërmjetësim, nga vetëdija e pastër, nuk do të jesh kurrë i aftë ta pash të vërtetën.

Në këtë botë, nevojitet guxim i madh që mendja të shtyhet anash. Njeriu më i guximshëm është ai i cili mund të shohë botën pa pengesat e mendjes, ashtu siç ajo në të vërtetë është. Ajo është katërçipërisht ndryshe, pafundësisht e bukur. Në botën e tillë askush nuk është i mbirenditur dhe askush nuk është i nënrenditur – në botën e tillë nuk ekzistojnë dallimet.

283

Mendimi ynë i zakonshëm është se intelektualët janë njerëz inteligjentë. Kjo nuk është e vërtetë. Intelektualët jetojnë vetëm nga fjalët e vdekura. Inteligjenca nuk guxon të veprojë në të njëjtën mënyrë. Inteligjenca e hedh fjalën – se fjala është kufomë – dhe merr vetëm vibrimin e gjallë prej saj.

Rruga e njeriut inteligjent është rruga e zemrës, për arsye se zemra nuk interesohet për fjalët; ajo interesohet vetëm për lëngun që vjen nga ena e fjalës. Ajo nuk mbledh enë, por e pi vetëm lëngun, kurse enën e hedh në pleh.

284

Për mua, njeri religjioz nuk është ai që është përmbi natyrën, veçse ai që është i natyrshëm në plotësi, në tërësi, dhe i cili e hulumton natyrën në të gjitha dimensionet e saj, asgjë duke mos lënë të pahulumtuar.

285

Njeriu që jeton jetë të natyrshme arrin vdekje të natyrshme.

Vdekja e natyrshme është kulmimi i jetës e cila është jetuar natyrshëm, pa kurrfarë

pengese, pa kurrfarë depresion – pikërisht në mënyrën në të cilën jetojnë shtazët; pa kurrfarë plasaritjeje. Duhet jetuar jetën që rrjedh e pranuar natyrën e cila rrymon nëpër ty pa kurrfarë pengimi nga ana jote, sikur ti të mos ishe, sikur jeta të ketë lëvizur nga vetvetja.

Në vend se ti ta jetosh jetën lejo që jeta të të jetojë ty; ti je dytësor. Kulmimi i kësaj do të jetë vdekja e natyrshme.

Vdekja ka për të shprehur kulmimin përfundimtar, kreshendon e jetës tënde të gjithmbarshme. Në formë të kondensuar ajo është e tëra që ka qenë dashur ta jetosh.

Kështu vetëm numër i vogël njerëzish në botë vdesin me vdekje të natyrshme, shkaku se numër tejet i vogël njerëzish jetojnë në mënyrë natyrore.

286

Ne i frikësohemi vdekjes shkaku se e dimë se duhet të vdesim, e nuk e dëshirojmë atë. Ne nuk dëshirojmë t'i mbyllim sytë. Ne dëshirojmë të jetojmë në atë mënyrë që "gjithë të tjerët le të vdesin, vetëm jo ne". Kjo është psikologjia e zakonshme e të gjithë njerëzve: "Unë nuk dua të vdes".

Të shtrosh pyetje për vdekjen është tabu. Njerëzit bëhen të frikësuar për atë se ajo ua

përkujton vdekjen e tyre personale. Ata janë aq të përqendruar në imtësirat e tyre, kurse vdekja do të mbërrijë; ata dëshirojnë t'i mbajnë vogëlsirat e tyre që të jenë të punësuar me diçka. Kjo u shërben si strehimore; ata nuk dëshirojnë të vdesin, së paku jo tash, ndoshta më vonë: "Kur do të ndodhë, do të shohim e bëjmë".

Duke e pranuar vetveten në tërësi, ti e pranon edhe vdekjen; ajo është vetëm pushim. Gjithë ditën ti ke punuar, e kur ka ardhur nata, a dëshiron të pushosh apo jo? Gjumi ditor të ka rinuar, të ka bërë përsëri të aftë të punosh më mirë, më me efikasitet. E gjithë lodhja është zhdukur dhe ti je përsëri i ri.

Vdekja e bën të njëjtën gjë, vetëm se në nivel më të thellë – ajo e ndërron trupin, sepse tashmë trupi nuk mund të rinohet vetëm me anë të gjumit të zakonshëm; ai është bërë tepër i vjetër, i nevojitet ndryshimi më drastik, i nevojitet ripërtëritja e plotë. Energjia jote jetësore kërkon trajtë të re. Vdekja është thjesht vetëm gjumë me të cilin mundesh lehtësisht të kalosh në trajtë të re.

287

Njeriu i cili jeton në frikë përherë fërgëllon në zemrën e vet. Ai është përherë në kufirin

për t'u çmendur, për atë se jeta është e madhe, e nëse përherë je i frikësuar, atëherë ajo është e mbushur me të gjitha llojet e frikës.

Ti mund ta bësh listë të madhe dhe të jesh i befasuar sesa shumë frikësime bartë në vete e akoma je gjallë. Gjithkund rreth teje ekzistojnë infeksione, sëmundje, rreziqe, kidnapime, terrorizëm – kurse jeta është aq e vogël. Në fund vjen vdekja, së cilës nuk mund t'i bishtërosh. E tërë jeta jote ka për t'u bërë errësirë.

Hidhe frikën. Ajo është rrënjosur në ndërdijen tënde qysh se në fëmijërinë tënde. Tash hidhe vetëdijshëm atë frikë dhe rritu. Atëherë jeta mund të bëhet dritë e cila depërton gjithnjë e më thellë ashtu siç ti piqesh.

288

Përgjegjësia nuk është lojë. Ajo është një nga mënyrat më burimore të jetesës - por edhe më e rrezikshmja, gjithashtu.

289

Për mua, mosdëgjimi është revolucion i madh. Kjo nuk do të thotë të thuash absolutisht JO në çdo situatë. Kjo thjesht do të thotë të vendosësh se a vlen të bëhet diçka apo

jo, a është ajo e dobishme të bëhet apo nuk është. Kjo është marrje e përgjegjësisë mbi vete.

290

Gjithnjë derisa nuk e mëson të vërtetën mbi qenësinë tënde, kurrë s'ke për ta ndjerë bekimin e madh të jetesës. Kurrë nuk do të jesh në gjendje të ndjesh sesi të vërshon gëzimi i së vërtetës reale të ekzistencës.

Po qe se nuk e shijon të vërtetën, nuk do të kesh mundësi që të lidhesh me këtë gjithësi gjigante – që është shtëpia jote. Ajo ta ka dhënë jetën, dhe ajo ka pritje të mëdha prej teje - se do ta zhvillosh pikën e fundit të vetëdijesimit, sepse përmes teje ekzistenca mund të bëhet e vetëdijshme.

Nuk ka mënyrë tjetër.

291

Intelekti është mendim – kurse vetëdijesimi ka zbuluar gjendjen pa mendime, deri në atë masë e qetë saqë madje as një mendim nuk lëviz për të krijuar shqetësim. Në këso qetësie ti shpall natyrën tënde të vërtetë – ajo është e pafund si qielli. Kurse njohja e saj është vërtet njohja e diçkahi të çmueshme; çdo gjë tjetër që

ke mësuar është pleh i zakonshëm.

Dituria jote mund të jetë e dobishme, praktike, por ajo nuk ka me të ndihmuar ta transformosh qenien tënde. Ajo nuk mund me të sjellë gjer tek përmbushja, gjer tek kënaqësia, gjer tek përndritja, gjer tek ajo pikë ku do të thuash: "Kam arritur në shtëpi".

292

Dhënia e dashurisë është përvojë e vërtetë dhe e bukur, sepse ti je perandor atëherë. Marrja e dashurisë është përvojë tepër e parëndësishme, sepse ajo është përvojë lypsari.

Mos u bëj lypsar!

* * *